

L I G J PËR PARANDALIM TË LARJES SË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT¹

KAPITULLI I.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen masat, veprimet dhe procedurat të cilat subjektet dhe organet dhe trupat kompetente i marrin për shkak të zbulimit dhe parandalimit të larjes së parave, veprave të lidhura ndëshkimore dhe financimit të terrorizmit (në tekstin e mëtejshëm: larjes së parave dhe financimit të terrorizmit), si dhe puna dhe kompetencat e Drejtorisë për Zbulim Financiar (në tekstin e mëtejshëm: Drejtoria).

Përkufizime

Neni 2

Shprehjet e përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin si vijon:

1. "**Larje e parave**" janë veprimet e parapara me Kodin penal si vepër penale larje e parave dhe lloje tjera të veprës ndëshkimore;

2. "**Financim i terrorizmit**" janë veprimet e parapara me Kodin penal si vepër penale financim i terrorizmit;

3. "**Akt terrorist**" është vepra penale e përkufizuar në nenin 2 të Konventës ndërkombëtare për parandalim të financimit të terrorizmit të ratifikuar në pajtim me Ligjin për ratifikimin e Konventës ndërkombëtare për parandalim të financimit të terrorizmit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 30/2004), si vepër penale terrorizëm dhe vepra tjera penale lidhur me terrorizmin të parapara me Kodin penal;

4. "**Terrorist**" është personi fizik i cili:

a) kryen apo tenton të kryejë akt terrorist në çfarëdo mënyre, drejtpërdrejtë apo tërthorazi, në mënyrë jologjore dhe të vetëdijshme;

b) merr pjesë si bashkëpjesëmarrës në akt terrorist;

v) organizon apo i urdhëron të tjerët të kryejnë akt terrorist apo

g) kontribuon në kryerjen e aktit terrorist nga grup i personave që vepron me qëllim të përbashkët, me qëllim të realizimit të aktit terrorist dhe/apo duke e ditur për qëllimin e grupit për të kryer akt terrorist;

5. "**Organizatë terroriste**" është grup i terroristëve i cili:

a) kryen apo tenton të kryejë akt terrorist në çfarëdo mënyre, drejtpërdrejtë apo tërthorazi, në mënyrë jologjore dhe të vetëdijshme;

b) merr pjesë si bashkëpjesëmarrës në akt terrorist;

v) organizon apo i urdhëron të tjerët të kryejnë akt terrorist apo

g) kontribuon në kryerjen e aktit terrorist nga grup i personave që vepron me qëllim të përbashkët, me qëllim të realizimit të aktit terrorist dhe/apo duke e ditur për qëllimin e grupit për të kryer akt terrorist.

6. "**Kontribut i veprës penale**" është çdo pronë apo dobi e marrë apo e fituar, drejtpërdrejtë apo tërthorazi, me kryerjen e veprës penale. Kontributi i veprës penale përfshin edhe llojin e veprës penale të bërë jashtë vendit, me kusht që në kohën kur është bërë të jetë e paraparë si vepër penale edhe sipas ligjeve të shtetit në të cilin është bërë edhe sipas ligjeve të Republikës së Maqedonisë;

7. "**Vepër e lidhur penale**" është vepra penale e cila gjeneron të ardhura që mund të jenë objekt i veprimit të veprës penale larje e parave;

8. "**Pronë**" janë paratë apo instrumentet tjera për pagesë, letrat me vlerë, depozitat, pronësia tjetër e çdo lloji edhe atë materiale apo jomateriale, e tundshme apo e patundshme, pa marrë parasysh mënyrën e fitimit, si dhe të drejtat tjera mbi lëndët, kërkesat, dokumentet juridike në çfarëdo forme, duke e përfshirë edhe në formën e shkruar apo elektronike, me të cilat dëshmohet pronësia mbi pronën

¹ Ky ligj harmonizohet me Direktivën BE 2015/849 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllimet e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit nga viti 2015, për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullativës (BE) nr. 648/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe për shfuqizimin e Direktivës 2005/60/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe të Direktivës 2006/70/EC të Komisionit me CELEX numër 32015L0849

apo interesi / pjesëmarrja në pronën e tillë;

9. **"Institucionet financiare"** janë:

a) bankat dhe kursimoret të themeluara me lejen e guvernatorit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, veprimtaria kryesore e të cilës është grumbullimi i depozitave dhe burimeve tjera kthyesë të mjeteve nga opinioni dhe miratimi i kredive në emër të vet dhe për llogarinë e vet

b) personat juridikë të cilët nuk janë banka apo kursimore që kryejnë një apo më tepër nga aktivitetet si vijojnë:

- kreditimin, duke e përfshirë edhe faktoringun dhe financimin e transaksioneve komerciale,
- lëshimin dhe administrimin e mjeteve pagesore (kartelave me para, çeqeve, çekqeve të udhëtimit, kambialëve);

- lëshimin e parave elektronike;

- lizingun financiar;

- punët e këmbimit;

- shërbimet pagesore (qarkullim pagesor në vend dhe jashtë vendit, duke e përfshirë arkëtimin dhe pagesën e parave në dorë në llogari nëpërmjet të cilës kryhen transaksionet pagesore, aktivitetet lidhur me hapjen, mbajtjen / mirëmbajtjen dhe mbylljen e llogarisë, kryerjen e transaksioneve pagesore, lëshimin e instrumenteve pagesore / apo pranimin e transaksioneve pagesore; remitencat në para (transfer i shpejtë i parave); shërbimet për iniciimin e pagesave);

- lëshimin e garancive pagesore, avalive dhe formave tjera të sigurimit;

- tregtimin me instrumentet në tregun e parave;

- tregtimin me mjetet devizore, që përfshin edhe tregtimin me metalet fisnike;

- tregtimin me letrat me vlerë;

- tregtimin me derivatet financiare;

- menaxhimin me mjetet dhe portfolin e letrave me vlerë për klientët dhe/apo këshillimin investues të klientëve;

- dhënien e shërbimeve të ruajtjes së pronës së fondeve investuese dhe pensionale;

- shitblerjen, garantimin apo plasmanin e emisionit të letrave me vlerë;

ruajtjen e letrave me vlerë për klientët;

- këshillimin e personave juridikë në lidhje me strukturën e kapitalit, strategjinë afariste apo çështjet tjera të lidhura apo dhënien e shërbimeve lidhur me bashkimin apo lidhjen e personave juridikë;

- ndërmjetësimin në lidhjen e marrëveshjeve për kreditë dhe huat, dhe

- përpunimin dhe analizën e informatave për aftësinë kreditore të personave juridikë;

v) shoqëritë për sigurim, shoqëritë brokerë të sigurimit, shoqëritë për përfaqësim në sigurim, brokerët e sigurimit dhe përfaqësuesit në sigurim, kur kryejnë punë të sigurimit të jetës, përkatësisht kryejnë punë të përfaqësimit apo ndërmjetësimin në sigurim gjatë lidhjes së marrëveshjeve për sigurim të jetës;

g) shoqëritë për menaxhim me fondet investuese private dhe fondet private;

d) shoqëritë për menaxhim me fondet e hapura investuese dhe fondet e mbyllura investuese;

gj) shoqëritë për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare;

e) filialet e institucioneve të huaja financiare nga pikat

a) deri në dh) në Republikën e Maqedonisë.

zh) Posta e Maqedonisë SHA në pjesën e punës që u referohet fletëpagesave postare me para;

z) dhe personat tjerë juridikë apo fizikë të cilët në pajtim me ligjin kryejnë një apo më tepër aktivitetet në lidhje me miratimin e kredive, lëshimin e parave elektronike, lëshimin dhe administrimin e kartelave kreditore, lizingun financiar, faktoringun, forfetingun, dhënien e shërbimeve këshilltarit investues, ndërmjetësimin gjatë mikropagesës, ruajnë apo administrojnë / shpërndajnë para në dorë dhe aktivitetet tjera financiare të përcaktuara me ligj;

10. **"Marrëdhënia afariste"** është marrëdhënia afariste, profesionale apo komerciale, që lidhet me aktivitetet profesionale dhe afariste të subjektit nga neni 5 i këtij ligji dhe për të cilën pritet në momentin e vendosjes së tij të ketë element të kohëzgjatjes;

11. **"Transaksioni i përkohshëm"** është transaksioni i cili nuk kryhet në kornizat e marrëdhënies së vendosur afariste;

12. **"Klient"** është personi fizik, personi juridik, trusti i huaj dhe aranzhmani i ngjashëm juridik që vendos, ka vendosur marrëdhënie afariste me subjektin apo kryen transaksion të përkohshëm;

13. **"Transaksion"** është arkëtimi dhe/apo pagesa e parave të gatshme, arkëtimi (pranimi) dhe pagesa e depozitës, shkëmbimi i valutave, lloji i mjeteve, lidhja e marrëveshjeve, furnizimi dhe shitblerja e mallrave dhe shërbimeve, shitja apo lëshimi i investimeve themeluese, shitblerja apo lëshimi i aksioneve apo pjesëmarrjeve, regjistrimi i letrave me vlerë apo lloji i letrave me vlerë apo prona tjetër dhe aktiviteti tjetër që e kryejnë subjektet në pajtim me autorizimet ligjore;

14. **"Paratë"** janë paratë në dorë, paratë zhiralë apo paratë elektronike;

15. **"Para në dorë"** janë bankënotat dhe monedhat të cilat në bazë të ligjit janë në qarkullim në Republikën e Maqedonisë apo në shtetin e huaj.

16. **"Paratë elektronike"** janë paratë elektronike në pajtim me ligjin;

17. **"Mjetet e transferueshme fizike për pagesë"** janë çeqet e udhëtarëve, çeqet, kambialët, fletëpagesat me para dhe mjetet tjera të transferueshme fizike për pagesë që paguhen të bartësi apo janë të transferueshme pa kufizim;

18. **"Dhënësit e shërbimeve të personave juridikë apo trustet"** janë personat fizikë apo juridikë që në kornizat e veprimtarisë së vet i japin shërbimet vijuese të personave të tretë:

a) themelojnë persona juridikë;

b) veprojnë si apo angazhojnë person tjetër të veprojnë si organ i menaxhimit apo anëtar i organit të menaxhimit të personit juridik;

v) sigurojnë seli, adresë afariste, adresë për korrespondencë apo shërbime tjera të lidhura të personit juridik apo trustit të huaj;

g) veprojnë si apo angazhojnë person tjetër të veprojnë si drejtor i trustit të huaj apo angazhimin e ngjashëm juridik të themeluar me deklaratë eksplicite;

d) veprojnë si apo angazhojnë person tjetër të veprojnë si bashkëpjesëmarrës apo vepron si aksionar për personin tjetër (përveç për shoqërinë tregtare që kuoton në bursë);

19. **"Trust"** është marrëdhënia juridike e vendosur në pajtim me rregullat e shtetit tjetër ndërmjet personit- themelues, gjatë jetës (inter vivos) apo pas vdekjes, kur prona i jepet në menaxhim të autorizuarit në dobi të shfrytëzuesit / grupit të shfrytëzuesve apo për qëllim të caktuar.

20. **"Pronar i vërtetë"** është çdo person (persona) fizik që është pronar i fundit i klientit apo e kontrollon klientin dhe/apo personin (personat) fizik në emër të të cilit dhe për llogari të të cilit kryhet transaksioni. Nocioni përfshinë edhe personin (personat) fizik që kryen kontroll të fundit dhe efektiv mbi personin juridik apo aranzhmanin e huaj juridik;

21. **"Regjistër i pronarëve të vërtetë"** është sistemi informativ i cili mundëson pranimin, evidentimin, përpunimin, ruajtjen dhe shkëmbimin e të dhënave dhe/apo dokumenteve për pronarët e vërtetë në formë elektronike;

22. **"Bartës i funksioneve publike"** janë personat fizikë të cilëve u është besuar apo u besohet funksioni publik në Republikën e Maqedonisë apo në shtetin tjetër, si:

a) kryetarë të shteteve dhe qeverive, ministra dhe zëvendës apo ndihmës ministra;

b) përfaqësues të zgjedhur në pushtetin ligjvënës,

v) gjykatës të gjykatave supreme apo kushtetuese apo bartës tjerë të funksioneve të larta të jurisprudencës kundër cilitdo vendim, përveç në raste të jashtëzakonshme, nuk mund të shfrytëzohen mjetet juridike,

g) anëtarë të organeve të menaxhimit të trupave të supervisorit dhe trupave rregullatorë dhe agjencive, institucion shtetëror të revizorit dhe anëtarë të këshillit të bankës qendrore,

d) ambasadorë,

gj) oficerë të rangut të lartë në forcat e armatosura (grada më të larta se koloneli),

e) persona të zgjedhur dhe të emëruar në pajtim me ligjin dhe anëtarë të organeve të menaxhimit dhe mbikëqyrjes së personave juridikë të themeluar nga shteti,

zh) persona me funksione në partitë politike (anëtarë të organeve ekzekutive të partive politike),

z) persona të cilëve u është apo iu ka besuar funksioni i theksuar në organizatën ndërkombëtare, si: drejtorë, zëvendësdrejtorë, anëtarë të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës apo funksioneve tjera ekuivalente dhe

x) kryetarë komunash dhe kryetarë të këshillave të komunave.

Bartës të funksionit publik nga pika a) deri në x) konsiderohen personat së paku dy vjet pas pushimit të kryerjes së funksionit publik, në bazë të vlerësimit të zbatuar paraprakisht në rrezik nga subjektet.

Nocioni "bartës të funksioneve publike" përfshinë edhe:

1) Anëtarë të familjes së bartësit të funksionit publik, edhe atë:

- bashkëshorti apo personi me të cilin bartësi i funksionit publik është në bashkësi jashtëmartesore,

- fëmijët dhe bashkëshortët e tyre apo personat me të cilët fëmijët e bartësit të funksionit publik janë në bashkësi jashtëmartesore apo

- prindër të bartësit të funksionit publik.

2) Personi i cili konsiderohet bashkëpunëtor i afërt i bartësit të funksionit publik është person fizik:

- për të cilin është e njohur se ka pronësi të përbashkët juridike apo pronësi të vërtetë mbi personin juridik, ka lidhur marrëveshje apo ka vendosur lidhje tjera të afërta afariste me bartësin e funksionit publik apo

- i cili është pronari i vetëm i vërtetë i personit juridik apo aranzhmanit juridik për të cilin është e njohur se janë themeluar në dobi të bartësit të funksionit publik.

23. **"Masa të përkohshme"** janë ndalimi i përkohshëm për shfrytëzimin apo disponimin me para,

letra me vlerë, fonde apo pronë tjetër, ruajtjen e përkohshme dhe sigurimin në bazë të vendimt të lëshuar nga gjykata apo organi tjetër kompetent në procedurën e përcaktuar me ligj;

24. "**Marrëdhënie korrespondente**" është:

a) kur banka si "korrespondent" i jep shërbime bankare bankës tjetër si "respodent", duke e përfshirë edhe mbajtjen e llogarisë dhe dhënien e shërbimeve lidhur me mbajtjen e llogarisë siç janë menaxhimi me paratë në dorë, llojet ndërkombëtare të mjeteve me para, barazimin e çeqeve, pagesën që shfrytëzohet drejtpërdrejtë nga personat e tretë për shkak të kryerjes së punës në emrin e tyre personal dhe shërbime të punës devizore dhe/apo

b) marrëdhënia ndërmjet dhe në kornizat e bankave dhe institucioneve tjera financiare kur shërbime të ngjashme jepen përmes institucionit financiar korrespondent të institucionit financiar respodent, si dhe marrëdhënie të vendosura për transaksione me letra me vlerë apo lloj të mjeteve me para.

25. "**Bartja e mjeteve me para**" është çdo transaksion, duke e përfshirë edhe remitencat me para, që kinse pjesërisht bëhet në formë elektronike në emër të paguesit përmes dhënësit të shërbimit pagesor me qëllim mjetet të vihen në dispozicion të pranuesit përmes dhënësit të shërbimit pagesor, pa marrë parasysh nëse paguesi apo pranuesi janë personi i njëjtë dhe pa marrë parasysh nëse dhënësi i shërbimeve pagesore të paguesit dhe të pranuesit është i njëjti.

26. "**Program**" është akti i subjektit i cili cakton rregulla, procedura dhe udhëzime për zbatimin e masave dhe veprimeve për parandalimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit për zvogëlimin efikas dhe menaxhimin me rrezikun e identifikuar nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit;

27. "**Person i autorizuar**" është personi i punësuar në subjekt dhe i emëruar nga organi i menaxhimit të subjektit, i cili kujdeset për zbatimin e masave dhe veprimeve për parandalim të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit dhe për bashkëpunim me Drejtorinë;

28. "**Udhëheqësia e lartë e subjektit**" është personi i cili me ligj dhe aktet interne është i autorizuar të menaxhojë dhe është përgjegjës për punën e subjektit dhe i cili ka autorizime përkatëse dhe funksion të miratohet vendime të cilat mund të ndikojnë në ekspozimin e subjektit në rrezik nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit;

29. "**Shell bank**" ("**Banka guaskë**") është institucioni financiar i cili në shtet ku është regjistruar nuk ka lokale afariste, të punësuar dhe organe të menaxhimit dhe nuk është anëtare e grupacionit bankar apo llojit tjetër të grupacioni që është lëndë e supervizionit të bazës së konsoliduar;

30. "**Lojëra të fatit**" janë lojërat e fatit në pajtim me Ligjin për lojëra të fatit dhe për lojëra argëtuese;

31. "**Grup**" është grupi i shoqërive tregtare që përbëhet nga shoqëria amë, shoqëritë simotra dhe shoqëritë në të cilat shoqëria amë apo shoqëria simotër marrin pjesë, si dhe shoqëritë tregtare që janë të lidhura në mënyrë të ndërsjellë në mënyrën në të cilën është rregulluar me rregullat që i rregullojnë shoqëritë tregtare;

"**Vlerësim nacional i rrezikut**" është procesi gjithëpërfshirës i identifikimit dhe analizës së rreziqeve nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit në shtet të caktuar, për shkak të zhvillimit të masave përkatëse për parandalimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit dhe alokimin efikas të resurseve të disponueshme me qëllim të kontrollit, zvogëlimit apo eliminimit të rreziqeve të përcaktuara dhe përparimin e sistemit për parandalim të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit;

32. "**Njësia për zbulim financiar**" është organi nacional qendror kompetent për pranimin dhe analizën e raporteve për transaksione të dyshimita dhe informata tjera me rëndësi për larjen e parave dhe financimin e terrorizmit dhe dorëzimin e rezultateve të analizës dhe informatave tjera relevante shtesë tek organet kompetente kur ekzistojnë baza për dyshim për larje të parave dhe financim të terrorizmit;

33. "**Aranzhman juridik**" është trusti dhe forma tjetër e ngjashme juridike e themeluar në pajtim me rregullativën e shtetit të huaj.

34. "**Shtetet me rrezik të lartë**" janë shtetet të cilat nuk i kanë zbatuar apo në mënyrë të pamjaftueshme i kanë zbatuar standardet ndërkombëtare për parandalim të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit dhe shtetet e përcaktuara si të rrezikshme në pajtim me Vlerësimin nacional të rrezikut.

35. "**Organizata jofitimprurëse**" janë personat juridikë, aranzhmanet juridike apo organizatat që në mënyrë primare janë përfshirë në grumbullimin apo ndarjen e mjeteve për qëllime bamirëse, religjioze, kulturore, arsimore apo sociale apo lloj tjetër të aktiviteteve bamirëse.

KAPITULLI II.

VLERËSIMI NACIONAL I RREZIKUT NGA LARJA E PARAVE DHE FINANCIMI I TERRORIZMIT

Vlerësimi nacional i rrezikut nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit

Neni 3

(1) Republika e Maqedonisë zbaton vlerësim nacional të rrezikut nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit (në tekstin e mëtejshëm: vlerësimi nacional i rrezikut) për shkak të identifikimit, vlerësimit, kuptimit dhe zvogëlimit të rrezikut lidhur me larjen e parave dhe financimin e terrorizmit dhe kryen azhurnimin e tij së paku në çdo katër vjet.

(2) Këshilli për luftën kundër larjes së parave dhe financimit të terrorizmit nga neni 125 i këtij ligji është kompetent për koordinimin e aktiviteteve për zbatim të vlerësimit nacional të rrezikut në Republikën e Maqedonisë dhe hartimin e raportit për vlerësimin nacional të rrezikut nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit.

(3) Raportin për vlerësimin nacional të rrezikut nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit Këshilli për Luftën Kundër Larjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit nga neni 125 të këtij ligji e dorëzon në miratim në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë.

(4) Raporti për vlerësimin nacional të rrezikut publikohet në faqen e internetit të Drejtorisë.

Qëllimet e vlerësimit nacional të rrezikut

Neni 4

(1) Konstatimet nga raporti për vlerësim nacional të rrezikut shfrytëzohen për qëllimet në vijim:

- përmirësimi i rregullativës nacionale për parandalim të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit,

- identifikimi i mangësive të sistemit për parandalim të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit dhe masat për tejkalimin e tyre, identifikimi i sektorëve ose aktiviteteve me rrezik më të vogël ose më të madh nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit,

- identifikimi i sektorëve ose aktiviteteve në lidhje me të cilat subjektet janë të detyruar që të ndërmarrin masa të përforcuara të analizave dhe sipas nevojës përcaktim të masave tjera të cilat subjektet janë të detyruar që t'i ndërmarrin,

- definimi i prioriteteve dhe alokimi i resurseve me qëllim parandalimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit,

- përgatitja dhe miratimi i rregullave relevante për sektorë të caktuar ose aktivitete dhe zbatimi i masave në pajtim me rreziqet identifikuese nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit dhe

- informimi dhe ndihma e subjekteve gjatë realizimit të vlerësimit të tyre intern të rrezikut nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit.

(2) Këshilli për luftë kundër larjes së parave dhe financimit të terrorizmit nga neni 125 i këtij ligji në bazë të konstatimeve nga raporti për vlerësim nacional të rreziqeve përgatit Propozim-strategji nacionale për luftë kundër larjes së parave dhe financimit të terrorizmit me plan aksional të masave dhe aktiviteteve për zvogëlim dhe menaxhim me rreziqet identifikuese dhe pasojat nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit dhe e ndjek realizimin dhe përmbushjen e planit aksional.

(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë e miraton Strategjinë nacionale për luftë kundër larjes së parave dhe financimit të terrorizmit me plan aksional të masave dhe aktiviteteve nga paragrafi (2) i këtij neni, për periudhë prej katër vitesh.

KAPITULLI III.

MASA DHE VEPRIME TË CILAT I NDËRMARRIN SUBJEKTET PËR ZBULIMIN DHE PARANDALIMIN E LARJES SË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Subjekte

Neni 5

Subjekte janë personat të cilat kanë për obligim t'i ndërmarrin masat dhe veprimet për zbulim dhe parandalim të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit të paraparë me këtë ligj (në tekstin e mëtejshëm: subjekte), edhe atë:

1. Institucione financiare dhe degë, filiale dhe njësi afariste të institucioneve të huaja financiare të cilat në pajtim me ligjin kryejnë veprimtari në Republikën e Maqedonisë;

2. Personat juridikë dhe fizikë që kryejnë shërbimet në vijim:
 - a) ndërmjetësim në qarkullimin me patundshmëri;
 - b) shërbime të revizorit dhe të kontabilitetit;
 - v) dhënia e këshillave nga sfera e tatimeve;
 - g) dhënia e shërbimeve si këshilltar për investim dhe
 - d) dhënia e shërbimeve për organizim dhe realizim të ankandeve.
3. Noterë, avokatë dhe shoqëri avokatësh që kryejnë autorizim publik në pajtim me ligjin;
4. Organizues të lojërave të fatit:
 - a) lojëra lotarie të fatit;
 - b) lojëra të fatit në kazino;
 - v) lojëra të fatit në bastore;
 - g) lojëra të fatit në klub automati;
 - d) lojëra elektronike të fatit;
 - gj) tombolë të tipit të mbyllur dhe
 - e) lojëra interneti të fatit.
5. Dhënës të shërbimeve të trusteve ose personave fizikë;
6. Depozitar qendror për letra me vlerë dhe
7. Persona juridikë që kryejnë veprimtari të pranimit në peng të sendeve të tundshme dhe patundshmëri (dyqan pengjesh).

Përfundime në lidhje me personat fizikë dhe juridikë të cilët kryejnë aktivitete financiare në bazë të përkohshme ose të kufizuar

Neni 6

(1) Subjektet nga neni 5 i këtij ligji që kryejnë aktivitete financiare në bazë të përkohshme ose të kufizuar dhe për të cilat me vlerësim nacional të rrezikut është përcaktuar rrezik i ulët i larjes së parave dhe financimit të terrorizmit, nuk janë të detyruar që t'i zbatojnë masat dhe veprimet për parandalim të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit të paraparë me këtë ligj, nëse janë përmbushur kushtet në vijim:

- aktiviteti financiar është dytësor dhe i lidhur drejtpërdrejt me aktivitetin afarist kryesor,
- qarkullimi vjetor neto nga aktiviteti financiar nuk tejkalon 100.000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ose 5% nga qarkullimi i përgjithshëm vjetor i subjektit,
- aktivitet kryesor nuk është dhënia e shërbimeve të revizorit, organizimi i lojërave të fatit, shërbimet e kontabilitetit, shërbimet e këshilltarit tatimor, aktivitetet e qarkullimit me patundshmëri, dhënia e shërbimeve të trusteve ose personave juridikë ose shërbimeve të noterit dhe avokatit,
- shumat më të larta të transaksionit për klient dhe për transaksion të veçantë pa marrë parasysh nëse bëhet si një ose disa transaksione që duken të lidhura reciprokisht nuk guxon të tejkalojë 500 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë dhe
- aktiviteti financiar bëhet vetëm për persona që janë klientë shikuar në aspekt të aktivitetit afarist kryesor dhe nuk është i arritshëm përgjithësisht për opinionin.

(2) Dispozitat nga paragrafi (1) i këtij neni nuk zbatohen për persona juridikë, tregtarë individë ose persona fizikë të cilat në mënyrë të pavarur kryejnë veprimtari nëse kryejnë dërgesa monetare në pajtim me ligjin.

(3) Subjekti nga paragrafi (1) i këtij neni paraqet kërkesë që të mos i zbatohet dispozitat e këtij ligji në Drejtori. Me kërkesën dorëzohet dokumentacioni nga i cili mund të konstatohet se janë përmbushur kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni dhe dokumentacioni për vlerësim të realizuar të rrezikut nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit për çdo aktivitet financiar.

(4) Për kërkesën nga paragrafi (3) i këtij neni, Drejtoria miraton aktvendim në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative.

(5) Aktvendimi nga paragrafi (4) i këtij neni është me vlefshmëri prej dy vitesh nga miratimi i tij. Pas skadimit të vlefshmërisë së aktvendimit, për përjashtim nga zbatimi i dispozitave të këtij ligji, subjekti paraqet kërkesë të re në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni.

(6) Nëse rrethanat në bazë të të cilave lëshohet aktvendimi ndryshohen para skadimit të vlefshmërisë së aktvendimit, subjekti nga paragrafi (1) i këtij neni është i detyruar që ta njoftojë Drejtorinë për këto ndryshime në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e ndodhjes së tyre. Në bazë të këtij njoftimi ose në bazë të informatave tjera, Drejtoria me detyrë zyrtare miraton aktvendim me të cilin e anulon aktvendimin paraprak dhe vendos për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

Neni 7

(1) Noterët, avokatët dhe shoqëritë e avokatëve që kryejnë autorizime publike në pajtim me ligjin

janë të detyruar t'i zbatojnë masat dhe veprimet për parandalim të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit në rastet kur japin shërbime juridike për klientët e tyre që kanë të bëjnë me aktivitetet në vijim:

- a) shitblerje të sendeve të tundshme, të patundshme, pjesëmarrjeve të bashkëpronarëve ose aksioneve,
- b) tregtim dhe menaxhim me pronën,
- v) hapje dhe disponim me llogari bankare, kasaforta dhe aktivitete tjera financiare,
- g) themelim ose pjesëmarrje në punën ose menaxhimin e personave juridikë, trusteve ose aranzhmane juridike dhe

d) përfaqësim të klientëve në transaksione.

(2) Detyrimet që dalin nga ky ligj nuk kanë të bëjnë me avokatët dhe shoqëritë e avokatëve kur kryejnë funksion të mbrojtjes dhe përfaqësimit të klientit në procedurë gjyqësore. Në këtë rast avokatët dhe shoqëritë e avokatëve, me kërkesë të Drejtorit, në afat prej shtatë ditësh duhet të dorëzojnë arsyetim me shkrim për shkaqet për të cilat nuk kanë vepruar në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

2. MASAT DHE VEPRIMET PËR ZBULIM DHE PARANDALIM TË LARJES SË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Neni 8

Masat dhe veprimet për zbulim dhe parandalim të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit (në tekstin e mëtutjeshëm: masa dhe veprime), të cilat i ndërmarrin subjektet janë:

- përgatitja e vlerësimit të rrezikut nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit dhe azhurnimi i tij i rregullt,
- futje dhe zbatim të programeve për ulje dhe menaxhim efikas me rrezikun e identifikuar nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit,
- analiza e klientëve,
- njoftimi dhe dorëzimi i të dhënave, informatave dhe dokumentacionit në Drejtorinë në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të tij,
- ruajtja, mbrojtja dhe mbajtja e evidencës së të dhënave,
- emërimi i personit të autorizuar dhe zëvendësit të tij dhe/ose formimi i seksionit për parandalim të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit,
- zbatimi i kontrollit të brendshëm dhe
- masa tjera që dalin nga dispozitat e këtij ligji.

Neni 9

(1) Detyrimi për marrje të masave dhe veprimeve të parapara me këtë ligj, ekziston edhe në rast kur subjektet janë në procedurë falimentimi ose likuidimi.

(2) Detyrimin nga paragrafi (1) i këtij neni e kryen drejtori i falimentimit deri në përfundimin ose mbylljen e procedurës së falimentimit, përkatësisht likuiduesi deri në mbylljen e procedurës likuiduese.

Përgatitja e vlerësimit të rrezikut nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit

Neni 10

(1) Subjektet janë të detyruara që të përgatisin vlerësim të rrezikut nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit me qëllim t'i identifikojnë, vlerësojnë, kuptojnë dhe zvogëlojnë rreziqet nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit, duke i marrë parasysh faktorët e rrezikut që kanë të bëjnë me:

- a) klientin;
- b) shtetet ose zonat gjeografike;
- v) prodhimet, shërbimet ose transaksionet dhe
- g) kanalet e distribuimit.

(2) Vlerësimi i rrezikut nga paragrafi (1) i këtij neni doemos duhet të jetë i dokumentuar dhe adekuate me madhësinë e subjektit, llojin, përfshirjen dhe ndërlikimin e aktivitetit të tij afarist.

(3) Subjekti është i detyruar që rregullisht ta azhurnojë vlerësimin e rrezikut nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Subjekti është i detyruar që vlerësimin e rrezikut nga paragrafi (1) i këtij neni ta dorëzojë me kërkesë të organeve kompetente mbikëqyrëse nga neni 146 i këtij ligji.

(5) Subjekti është i detyruar që vlerësimin e rrezikut nga paragrafi (1) i këtij neni ta harmonizojë me vlerësimin nacional të rrezikut.

(6) Subjekti është i detyruar që, para se të bëjë ndryshime të konsiderueshme në aktivitetet e tij afariste dhe proceset që mund të ndikojnë në masat që merren me qëllim parandalimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe gjatë vendosjes së prodhimit, shërbimit, aktivitetit ose kanalit të ri

të shpërndarjes, si dhe gjatë vendosjes së teknologjive të reja, të realizojë vlerësim të rrezikut me qëllim përcaktimin dhe vlerësimin e asaj se si ndikojnë ndryshimet në ekspozimin e ndaj rrezikut nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit dhe është i detyruar që të ndërmarrë masa adekuate për uljen dhe për menaxhimin efikas me rrezikun.

(7) Organet e mbikëqyrjes nga neni 146 i këtij ligji janë të detyruar që të përgatisin udhëzim për kryerje të vlerësimit për rrezikun për subjektet për të cilat kryejnë mbikëqyrje.

Vendosja dhe zbatimi i Programeve për zvogëlim dhe menaxhim efikas me rrezikun e identifikuar nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit

Neni 11

(1) Subjektet janë të detyruar që të përgatisin dhe zbatojnë Program për zvogëlim dhe menaxhim efikas me rrezikun e identifikuar nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit që përmban:

- qëllimet, vëllimin dhe mënyrën e punës së sistemit për parandalim të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit të subjektit,
- strukturën organizative të subjektit, pozitën e personit të autorizuar dhe zëvendësit të tij në strukturën organizative,
- të dhënat për personin e autorizuar dhe zëvendësin e tij,

- autorizime dhe përgjegjësi të personit të autorizuar dhe zëvendësit të tij,
- autorizime dhe përgjegjësi të të gjithë të punësuarve në subjektin që marrin pjesë në zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të tij,
- konkluzione nga vlerësimi i realizuar i rrezikut dhe mënyra e menaxhimit me rrezikun nga larja e parave dhe financimit të terrorizmit,

- masat e analizës së klientit dhe pranueshmëria e klientëve,
- mënyrën e njohjes së transaksioneve të pazakonshme dhe transaksioneve me dyshim për larje parash dhe financim të terrorizmit,

- mënyrën e vendosjes së mekanizmit të brendshëm për njoftim në kohë dhe adekuat,

- mënyrën e ruajtjes së të dhënave dhe dokumenteve,

- mënyrën e dorëzimit të raporteve në Drejtorinë,

- planin për trajnim të përhershëm të të punësuarve në subjektin nga sfera e parandalimit të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit që siguron realizim të së paku dy trajnimeve gjatë vitit dhe procedura dhe plani i kryerjes së kontrollit të brendshëm të zbatimit të masave dhe veprimeve për parandalim të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit adekuate me madhësinë dhe llojin e subjektit.

(2) Udhëheqësia e lartë e subjektit është e detyruar që ta miratojë programin nga paragrafi (1) i këtij neni, rregullisht ta ndjekë dhe vlerësojë përshtatshmërinë, harmonizimin dhe efikasitetin e tij dhe nëse nevojitet, t'i përforcojë masat që i merr subjekti.

(3) Subjekti është i detyruar që programin nga paragrafi

(1) i këtij neni në afat prej shtatë ditësh ta dorëzojë me kërkesë të organeve kompetente të mbikëqyrjes nga neni 146 i këtij ligji.

Analiza e klientit

Neni 12

Subjektet janë të detyruar që të kryejnë analizë të klientit në rastet në vijim:

a) kur vendoset marrëdhënie afariste me klientin;

b) kur kryhet transaksion në shumë prej 15.000 euro ose më shumë në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, pa marrë parasysh nëse transaksioni bëhet si një operacion ose disa operacione që janë të lidhura reciprokisht në mënyrë të dukshme;

v) kur kryhet transaksioni i përkohshëm i cili paraqet transferim të mjeteve monetare në vlerë më të madhe se 1000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë;

g) tek lojërat e fatit në rast të arkëtimit dhe pagesës së fitimit, si dhe gjatë blerjes ose pagesës së çipave në shumë prej 1.000 euro ose më shumë në kundërvlerë me denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, pa marrë parasysh nëse transaksioni kryhet si një transaksion ose më shumë transaksione që janë të lidhura reciprokisht në mënyrë të dukshme dhe që arrijnë vlerë prej 1.000 euro ose më shumë në kundërvlerë me denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë;

d) kur ekziston dyshim për autenticitetin ose përshtatshmërinë e të dhënave të marra paraprakisht për identitetin e klientit ose pronarin e vërtetë dhe

gj) kur ekziston dyshim për larje parash ose financim të terrorizmit, pa marrë parasysh çfarëdo përjashtimi ose shume të mjeteve.

Raste kur nuk zbatohet analizë e klientit

Neni 13

(1) Subjektet nuk janë të detyruar që t'i zbatojnë masat nga neni 14 i këtij ligji në lidhje me paratë elektronike, nëse janë përmbushur kushtet në vijim:

1. Instrumenti për pagesë nuk mund të plotësohet sërish ose shuma e përgjithshme e transaksioneve të instrumentit për pagesë është e kufizuar në nivel mujor në shumë prej 150 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë dhe mund të shfrytëzohet vetëm në Republikën e Maqedonisë;

2. Mjetet e paguara të instrumentit për pagesë nuk guxojnë të tejkalojnë 150 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë;

3. Instrumenti për pagesë shfrytëzohet veçanërisht për furnizim të mallrave ose shërbimeve;

4. Paratë elektronike anonime nuk mund të deponohen në instrumentin për pagesë dhe

5. Lëshuesi i parave elektronike kryen monitorim/kontroll të transaksioneve ose marrëdhënies afariste, me qëllim të zbulimit të transaksioneve të ndërlukuara dhe të pazakonshme ose të dyshimta.

Përjashtimi nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk vlen në raste të grumbullimit të parave të gatshme elektronike ose tërheqjes së parave të gatshme në vlerë ekuivalente me paratë elektronike më të mëdha se 100 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë.

(2) Dispozitat nga paragrafi (1) i këtij neni nuk zbatohen në raste kur ekzistojnë shkaqe për dyshim për larje të parave ose financim të terrorizmit.

Masa të analizës së klientit

Neni 14

(1) Analiza e klientit nga neni 12 i këtij ligji përfshin:

a) identifikim të klientit dhe vërtetim të identitetit të tij me shfrytëzim të dokumenteve, të dhënave dhe informatave nga burime të sigurta dhe të pavarura;

a) identifikim të autorizuesit dhe vërtetim të identitetit të tij me shfrytëzim të dokumenteve, të dhënave dhe informatave nga burime të sigurta dhe të pavarura;

v) identifikimi i pronarit të vërtetë dhe marrja e masave përkatëse për vërtetim të identitetit të tij, me shfrytëzim të dokumenteve, të dhënave dhe informatave nga burime të sigurta dhe të pavarura me qëllim subjekti të jetë i bindur që e di se kush është pronari i vërtetë;

g) sigurimi i informatave për qëllimin dhe synimin e marrëdhënies afariste dhe

d) ndjekja e vazhdueshme e marrëdhënies afariste dhe transaksioneve që realizohen në kuadër të marrëdhënies së vendosur afariste me qëllim të sigurimit se këto transaksione janë konsistente me profilin e rrezikut dhe biznesit të klientit, e në rast kur është e nevojshme dhe përcaktim të burimeve të mjeteve, me ç'rast dokumentet dhe të dhënat me të cilat subjekti disponon doemos duhet të azhurnohen.

(2) Kur klienti është person juridik ose aranzhman juridik, subjekti është i detyruar që të marrë masa me qëllim të konstatimit të natyrës së aktivitetit afarist dhe strukturës pronësore dhe kontrolluese.

(3) Subjektet e zbatojnë çdo masë nga analiza e klientit, ndërsa vëllimi i saj varet nga vlerësimi i rrezikut të klientit.

(4) Subjektet janë të detyruar që t'ua bëjnë të arritshme organeve mbikëqyrëse nga neni 146 i këtij ligji dokumentet për vlerësim të rrezikut të klientit, që të vërtetojnë se rreziku i konstatuar nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit është adekuat dhe se vëllimi i masave të marra është në pajtim me rrezikun e klientit.

(5) Subjektet janë të detyruara që masat për klientin t'i zbatojnë edhe te klientët dhe marrëdhëniet afariste me të njëjtat në bazë të vlerësimit të rrezikut, në periudhë të caktuar kohore në pajtim me vlerësimin e përgatitur të rrezikut, duke e marrë parasysh analizën e realizuar paraprake të klientit dhe ndryshimin e rrethanave që janë me rëndësi për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

Identifikimi dhe vërtetimi i identitetit

Neni 15

(1) Identifikimi dhe vërtetimi i identitetit të klientit, autorizuesi ose pronari i vërtetë, subjektet janë të detyruar që ta kryejnë para se të vendosin marrëdhënie afariste ose para se të kryejnë transaksion të përkohshëm.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, subjektet mund ta vërtetojnë identitetin e klientit, autorizuesit ose pronarit të vërtetë gjatë vendosjes së marrëdhënies afariste, që të mos prishet udhëheqja e marrëdhënies afariste dhe kur ekziston rrezik i ulët nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit. Në punët lidhur me sigurimin e jetës, është e lejuar vërtetimi i identitetit të klientit, autorizuesit ose pronarit të vërtetë të policës, të kryhet pasi të jetë vendosur marrëdhënia e punës. Në këtë rast vërtetimi i identitetit duhet të kryhet para ose gjatë pagesës së policës ose para ose kur shfrytëzuesi ka për qëllim t'i kryejë të drejtat që dalin nga polica.

Identifikimi dhe vërtetimi i identitetit të klientit

Neni 16

(1) Kur klienti është person fizik identifikohet dhe vërtetohet identiteti i tij me parashtrim të dokumentit origjinal dhe të vlefshëm për identifikim, të lëshuar nga organi kompetent ose kopje e verifikuar në noter.

(2) Nga dokumenti nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohet emri, mbiemri, data dhe vendi i lindjes, vendi dhe adresa e vendbanimit ose vendqëndrimit, numri unik i amzës ose numri për identifikim dhe numri i dokumentit për identifikim, organi i cili e ka lëshuar dhe data e vlefshmërisë.

(3) Kur klienti është person juridik ose aranzhman juridik identifikohet dhe identiteti i tij vërtetohet me dokument për regjistrim në origjinal ose kopje të verifikuar në noter, të lëshuar nga organi kompetent i shtetit në të cilin është regjistruar personi juridik ose akt për themelimin e aranzhmanit juridik. Dokumenti për regjistrim ose themelim parashtrohet në formë në letër dhe/ose elektronike. Dokumentet për regjistrim të lëshuara nga organi kompetent i shtetit të huaj, duhet të jenë të përkthyer në gjuhën maqedonase nga ana e përkthyesit të autorizuar gjyqësor.

(4) Nga dokumenti nga paragrafi (3) i këtij neni përcaktohet emërtimi, forma juridike, selia, numri tatimor ose numri tjetër i regjistrimit i personit juridik ose aranzhmanit juridik, themeluesit/ve, i autorizuesit/sve, shfrytëzuesit ose grupit të shfrytëzuesve të trustit, përfaqësuesit ligjor, organit drejtues dhe personave të autorizuar për hyrje në marrëdhënie afariste në emër të klientit.

(5) Nga dokumentet nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni, për qëllimet e identifikimit, subjektet detyrimisht mbajnë kopje në letër dhe/ose formë elektronike me ç'rast aplikojnë masa teknike dhe organizative në pajtim me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale.

(6) Subjektet mund të kërkojnë edhe të dhëna, informata dhe dokumente tjera nga klienti dhe/ose burime të sigurta dhe të pavarura për vërtetim të identitetit të klientit.

Identifikimi dhe vërtetimi i identitetit të autorizuesit

Neni 17

(1) Subjektet janë të detyruara që të konstatojnë nëse klienti vepron në emër dhe për llogari të personit të tretë.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, subjektet janë të detyruara që ta identifikojnë dhe ta vërtetojnë identitetin e personit i cili e kryen transaksionin (autorizuesit), bartësit të së drejtës (të autorizuarit) dhe autorizimin.

Identifikimi dhe vërtetimi i identitetit të pronarit të vërtetë

Neni 18

(1) Subjektet janë të detyruar që ta identifikojnë pronarin e vërtetë.

(2) Subjektet janë të detyruar që ta vërtetojnë identitetin e pronarit të vërtetë në bazë të të dhënave dhe informatave nga burime të sigurta dhe të pavarura, në vëllim adekuat me vlerësimin e kryer të rrezikut, me atë që do të jenë të bindur se cili është pronari i vërtetë.

(3) Subjektet, të dhënat për pronarin e vërtetë i sigurojnë nga dokumentacioni origjinal ose i verifikuar nga regjistri tregtar, gjyqësor ose regjistër tjetër publik, i cili nuk guxon të jetë më i vjetër se gjashtë muaj. Subjektet, të dhënat për pronarin e vërtetë janë të detyruara që t'i kontrollojnë nga regjistri i pronarëve të vërtetë, me ç'rast nuk guxojnë të mbështeten ekskluzivisht në të dhënat e futura në regjistrin.

(4) Nëse subjektet nuk mund t'i fitojnë të gjitha të dhënat për pronarin e vërtetë të klientit nga regjistri tregtar, gjyqësor ose regjistër tjetër publik ose regjistri i pronarëve të vërtetë, të dhënat e

nevojshme duhet t'i sigurojë me kontroll të dokumenteve origjinale ose të verifikuara dhe evidencave afariste të parashtruara nga ana e përfaqësuesit ligjor të klientit ose personit të autorizuar prej tij.

(5) Nëse klienti nuk i nënshtrohet regjistrimit në regjistrin përkatës subjektet nuk mund t'i marrin të dhënat e nevojshme për pronarin e vërtetë në mënyrën e përshkruar në paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij neni, subjektet janë të detyruar që të dhënat t'i sigurojnë drejtpërdrejt me deklaratë me shkrim nën përgjegjësi të plotë morale dhe materiale të verifikuara në noter të përfaqësuesit ligjor ose personit të autorizuar prej tij.

(6) Nëse gjatë përcaktimit të pronarit të vërtetë, subjektet dyshojnë në autenticitetin e të dhënave të dorëzuara ose në autenticitetin e dokumenteve ose dokumentacionit tjetër afarist, janë të detyruar që të kërkojnë deklaratë me shkrim nga përfaqësuesi ligjor nën përgjegjësi të plotë morale dhe materiale të verifikuara në noter ose prej tij person i autorizuar para se të vendosin marrëdhënie afariste ose para se të kryejnë transaksion.

(7) Në rastet nga paragrafët (5) dhe (6) të këtij neni, subjektet janë të detyruar që të aplikojnë një ose më shumë masa për analizë të përforcuar në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(8) Drejtori i Drejtorisë me udhëzim e përcakton mënyrën e identifikimit të pronarit të vërtetë.

Pronari i vërtetë i personit juridik

Neni 19

(1) Pronari i vërtetë i personit juridik është:

1. Personi (personat) fizik i cili është pronar i personit juridik ose e kontrollon personin juridik përmes pronësisë së drejtpërdrejtë të përqindjes së mjaftueshme të pjesëmarrjeve, aksioneve, duke përfshirë edhe aksione të bartësit ose të drejtës së votës ose të drejtave tjera në personin juridik;

2. Personi (personat) fizik i cili e kontrollon personin juridik përmes pronësisë së tërthortë të përqindjes së mjaftueshme të pjesëmarrjeve, aksioneve, përfshirë edhe aksione të bartësit ose të drejtës së votës ose të drejtave tjera në personin juridik ose

3. Personi (personat) fizik i cili në mënyrë tjetër realizon kontroll të personit juridik.

(2) Indikator i pronësisë së drejtpërdrejtë nga paragrafi

(1) pika 1 e këtij neni është pronësia e mbi 25% të pjesëmarrjeve, të drejtave të votës ose të drejtave tjera në personin juridik ose pronësia e mbi 25% plus një aksion.

(3) Indikator i pronësisë së tërthortë nga paragrafi (1) pika 2 e këtij neni është pronësia ose kontrolli i personit (personave) fizik mbi një ose më shumë persona juridikë të cilat në veçanti ose bashkë kanë mbi 25% të pjesëmarrjeve ose 25% plus një aksion.

(4) Nëse me zbatimin e pikave 1 dhe 2 të paragrafit (1) të këtij neni nuk mund të përcaktohet person/a fizik/ë për pronarin/ët e vërtetë ose nëse subjekti nuk është i sigurt se personi/at fizik/ë i/të identifikuar në pajtim me pikat 1 dhe 2 të paragrafit (1) të këtij neni është/janë pronar/ë i/të vërtetë, në ato raste për pronar/ë i/të vërtetë konsiderohet/n personi/at i/e identifikuar me zbatim të pikës 3 nga paragrafi (1) i këtij neni.

Pronari i vërtetë i personave tjerë juridikë

Neni 20

Pronari i vërtetë i shoqatave vendore dhe të huaja dhe lidhjeve të tyre, fondacioneve, institucioneve, odave, sindikatave, partive politike, kooperativave, komuniteteve fetare ose organizatave tjera në të cilat pjesëmarrjen në menaxhimin në bazë të pjesëmarrjes pronësore në kapital nuk është e mundshme të përcaktohet, konsiderohet çdo person fizik i cili është i autorizuar t'i përfaqësojë ose personi fizik i cili ka pozitë kontrolluese në menaxhim me pronën e organizatës.

Pronar i vërtetë i aranzhmanit juridik

Neni 21

(1) Pronari i vërtetë i aranzhmanit juridik është çdo person fizik i cili është:

1. themelues;

2. i autorizuar;

3. drejtor/ë (nëse ka);

4. shfrytëzues ose grup i shfrytëzuesve të pronës me të cilin menaxhon me kusht që shfrytëzuesit e ardhshëm të jenë të përcaktuar ose të mund të përcaktohen;

5. personat fizikë që kryejnë funksione të njëjta ose të ngjashme të atyre nga pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij paragrafi dhe/ose

6. personi tjetër fizik i cili përmes pronësisë së drejtpërdrejtë ose të tërthortë ose në mënyrë tjetër kryen kontroll mbi aranzhmanin juridik.

Pronari i vërtetë i tregtarit individ ose i kryerësve të mëvetësishëm të veprimtarisë

Neni 22

Pronar i vërtetë i tregtarit individ ose i kryerësve të mëvetësishëm të veprimtarisë është personi fizik i regjistruar për kryerje të veprimtarisë dhe në të njëjtën kohë është përfaqësues i vetëm i autorizuar.

Pronar i vërtetë i shfrytëzuesve buxhetorë

Neni 23

Pronar i vërtetë i shfrytëzuesit buxhetor është udhëheqësi i shfrytëzuesit buxhetor.

Përfashtime në lidhje me identifikimin e pronarit të vërtetë

Neni 24

Subjekti nuk duhet doemos ta identifikojë dhe vërtetojë identitetin e pronarit të vërtetë nëse klienti është person juridik letrat me vlerë e të cilit kotojnë në bursë vendore ose të huaj të letrave me vlerë nga shtete që i përmbushin standardet ndërkombëtare për parandalim të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit ose të dhënat për pronarë të vërtetë janë transparente dhe publikisht të arritshme.

Obligimi për posedimin dhe ruajtjen e të dhënave për pronarit e vërtetë

Neni 25

(1) Obligim për posedimin dhe ruajtjen e të dhënave dhe dokumenteve për pronarin e vërtetë kanë subjektet për regjistrim në regjistrat të cilat mbahen në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: subjektet juridike), edhe atë:

1. shoqëritë tregtare, tregtari individual, kryerësit e pavarur të veprimtarive, degët dhe filialet e shoqërive të huaja tregtare dhe tregtari individual i huaj,

2. shoqëri, lidhje, fondacione, oda, sindikate, parti politike, kooperativa, bashkësi fetare ose organizata të tjera dhe

3. noterë, avokatë dhe persona të tjerë të cilët kryejnë autorizime publike.

(2) Personat juridikë nga paragrafi (1) pikat 1 dhe 2 të këtij neni obligohet që të posedojnë dhe ruajnë të dhëna adekuate të sakta dhe të azhurnuara dhe dokumente për: pronarët e vërtetë, edhe atë:

1. emrin dhe mbiemrin;

2. shteti i vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimin;

3. dita muaji dhe viti i lindjes;

4. numri unik amë ose numër tjetër identifikues dhe të dhëna për llojin, numrin, lëshuesin, shtetin dhe datën e lëshimit të dokumentit për identifikim;

5. shtetësia dhe

6. të dhëna për llojin dhe vëllimin e pronësisë së vërtetë.

b) struktura pronësore, ndërsa shoqëritë tregtare dhe të dhënat për pjesët, investimet ose formë tjetër të pjesëmarrjes në pronësinë e shoqërisë.

(3) Personat juridikë nga paragrafi (1) pika 3 të këtij neni obligohet që të posedojnë dhe ruajnë të dhëna adekuate të sakta dhe të azhurnuara nga paragrafi (2) pika a) të këtij neni.

(4) Aranzhmanet juridike të themeluara në bazë të të drejtës së shtetit të huaj të cilat kanë marrë numrin personal tatimor (NPT) në Republikën e Maqedonisë në pajtim me ligjin obligohet që të posedojnë dhe të ruajnë të dhëna adekuate, të sakta dhe të azhurnuara nga paragrafi (2) pika a) të këtij neni.

Regjistri i pronarëve të vërtetë

Neni 26

(1) Për shkak të sigurimit të transparencës së strukturës pronësore të subjekteve juridike vendoset regjistër i pronarëve të vërtetë (në tekstin e mëtejshëm: regjistër).

(2) Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: administrator i regjistrin) e vendos, mban, mirëmban dhe udhëheq me regjistrin.

(3) Subjektet juridike nga neni 25 paragrafi (1) të këtij ligji, me përjashtim të: tregtarëve individualë dhe kryerësve individualë të veprimtarisë, i vendosin të dhënat për pronarët e tyre të vërtetë në regjistër në afat prej tetë ditëve nga regjistrimi i themelimit të subjektit afarist në regjistrin përkatës ose në afat prej tetë ditëve nga ndryshimi i të dhënave për pronarin e vërtetë. Agjenti i regjistrimit ose administratori i regjistrin në procedurën për regjistrim obligohet që ta njoftojë subjektin juridik për obligimin për regjistrim të detyrueshëm të të dhënave për pronarin e vërtetë.

(4) Dispozitat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni nuk kanë të bëjnë me subjektet juridike të cilat janë kompani aksionet e të cilave kotojnë në tregun e organizuar të letrave me vlerë dhe të cilat obligohen t'i harmonizojnë me kushtin për publikimin e të dhënave për pronarët e vërtetë me çka sigurohet transparencë përkatëse e informatave për pronësi në pajtim me standardet ndërkombëtare relevante.

Parashtruesit

Neni 27

(1) Personi i autorizuar për përfaqësimin dhe prezantimin e subjektit juridik obligohet që t'i vendosë të dhënat në regjistër.

(2) Subjektet juridike nëpërmjet sistemit të administratorit të regjistrimit mund të autorizojnë person tjetër që në emër të tyre t'i vendosë të dhënat për pronarët e tyre të vërtetë, si dhe të dhënat për ndryshimet e pronarëve të vërtetë në regjistër.

(3) Subjektet juridike janë përgjegjëse për saktësinë, përshtatjen dhe azhurnimin e të dhënave të vendosura në regjistër.

Vendosja e të dhënave në regjistër

Neni 28

(1) Në regjistër regjistrohen këto të dhëna:

a) të dhënat për subjektin juridik: emri, selia, NUAS dhe numri tatimor, data e themelimit dhe shlyerjes së subjektit afarist dhe

b) të dhënat për pronarin e vërtetë: emri personal, numri personal ose numër tjetër identifikues, adresa e qëndrimit të përhershëm dhe të përkohshëm, data e lindjes, numri tatimor, shtetësia, pjesa e pronësisë ose formë tjetër ose lloji i pronësisë ose kontrollit dhe data e vendosjes dhe shlyerjes së pronarit të vërtetë nga regjistri;

(2) Administratori i regjistrimit e mban dhe udhëheq regjistrin në mënyrë që:

- krahas statusit të fundit të të dhënave për pronarët e vërtetë, gjithashtu ruhen edhe të dhëna për regjistrimet paraprake, ndryshimet e të dhënave dhe shlyerja sipas kohës dhe llojit të ngjarjes,

- të dhënat në regjistër janë të arritshme dhjetë vjet pas shlyerjes së subjektit juridik nga regjistri kompetent dhe

- me përjashtim të alinesë 2 të këtij paragrafi, të dhënat në regjistër janë të arritshme përherë për Drejtorinë, organet e ndjekjes, gjykatat dhe organet e mbikëqyrjes nga neni 146 të këtij ligji.

(3) Vendosja bëhet falas përmes ueb-portalit të administratorit të regjistrimit në formë elektronike në ç'rast zbatohen teknikat dhe masat organizuese në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.

(4) Ministri i Financave e përcakton mënyrën e vendosjes, paraqitjes, korrigjimit dhe shlyerjes së të dhënave nga regjistri, mënyrën e shfrytëzimit, mënyrën e shprehjes së shumës së pjesës (indikatori për përcaktimin e pronësisë), mënyrën për mirëmbajtje dhe administrim, kërkesat teknike (nevojat) për vendosjen e regjistrimit.

Qasje në të dhënat për pronarët e vërtetë

Neni 29

(1) Të dhënat të cilat janë regjistruar në regjistër direkt dhe në bazë të qasjes elektronike janë të arritshme për Drejtorinë, organet kompetente shtetërore të ndjekjes, gjykatat, organet të cilat kryejnë mbikëqyrje nga neni 146 i këtij ligji dhe subjektet e nenit 5 të këtij ligji.

(2) Të dhënat nga regjistri për emrin personal, muajin dhe vitin nga data e lindjes, shtetësia, vendqëndrimi, pjesa pronësore ose forma tjetër dhe lloji i pronësisë ose kontrollit janë të arritshme dhe shfrytëzohen me kompensim në pajtim me tarifën e administratorit të regjistrimit.

Kontrolli i të dhënave në regjistër

Neni 30

(1) Administratori i regjistrimit bën kontrollin e të dhënave në regjistër dhe përcakton nëse subjektet juridike nga neni 25 paragrafi (1) të këtij ligji i kanë shënuar të dhënat nga neni 28 paragrafi (1) të këtij ligji, ndryshimin e atyre të dhënave në afatin e nenit 26 paragrafit (3) të këtij ligji dhe mënyrën e përcaktuar në rregulloren e nenit 28 paragrafit (4) të këtij ligji.

(2) Administratori i regjistrimit, menjëherë e informon Drejtorinë në formë elektronike për subjektet

juridike nga neni 25 paragrafi (1) të cilët nuk i kanë shënuar të dhënat nga neni 28 paragrafi (1) i këtij ligji dhe nuk e kanë shënuar ndryshimin e atyre të dhënave në mënyrë dhe në afat të përcaktuar me rregulloren e nenit 28 paragrafit (4) të këtij ligji.

Përcjellja e përhershme e marrëdhënies afariste

Neni 31

(1) Subjekti obligohet që me kujdes t'i përcjellë aktivitetet afariste dhe transaksionet të cilat kryhen në kuadër të marrëdhënies afariste me klientin, me qëllim të përcaktimit se të njëjtat janë në pajtim me qëllimin dhe dedikimin e marrëdhënies afariste, profilin e rrezikut të klientit, gjendjen e tij financiare dhe burimet e tij të financimit.

(2) Subjekti obligohet që të kryejë kontroll dhe azhurnim të dokumenteve dhe të dhënave për klientin, pronarët e vërtetë dhe profilin e rrezikut të klientit me të cilat ka vendosur marrëdhënie afariste.

(3) Subjekti obligohet që të sigurojë se vëllimi dhe shpeshtimi i zbatimit të masave të paragrafit (2) të këtij neni janë në pajtim me analizën dhe vlerësimin e rrezikut nga neni 10 i këtij ligji dhe se të njëjtat janë të harmonizuara me rrezikun e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit të cilave u nënshtrohet subjekti gjatë realizimit të përcaktimit të aktivitetit afarist ose transaksionit, përkatësisht në kuadër të marrëdhënies afariste me klientin.

Analiza e thjeshtësuar e klientit

Neni 32

(1) Subjektet mund të zbatojnë masa më të thjeshta për analizën e klientit, kur në pajtim me dispozitat nga neni 10 të këtij ligji kanë konstatuar se ekziston rrezik i ulët i larjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

(2) Gjatë vendimmarrjes për zbatimin e masave më të thjeshta për analizë të klientit, subjektet obligohet që t'i marrin parasysh edhe rezultatet e vlerësimit nacional të rrezikut.

(3) Masa të analizës më të thjeshtë të klientit mund të jenë:

- konfirmim i identitetit të klientit ose pronarit të vërtetë sipas vendosjes së marrëdhënies afariste,
- zvogëlim i shpeshtimit të azhurnimit të dokumenteve dhe të dhënave për klientët dhe/ose
- zvogëlim i shkallës për përcjelljen e marrëdhënies afariste dhe transaksioneve të klientit.

(4) Subjektet obligohet që të sigurojnë dokumentacion përkatës në bazë të të cilit do të mund të konfirmohet se lejohet zbatimi i analizës më të thjeshtë të klientit dhe se masat e analizës së thjeshtë të klientit janë përkatëse për rrezikun, si dhe ta bëjnë të arritshëm atë dokumentacion të organeve të mbikëqyrjes nga neni 146 të këtij ligji.

(5) Analizë e thjeshtë e klientit nuk është e lejuar kur në raport me klientin, transaksionin, marrëdhënien afariste ose pronën ekziston dyshim i larjes së parave ose financimit të terrorizmit, zbatohen s skenarë specifikë të rrezikut të lartë nga larja e parave ose financimi i terrorizmit ose në raste të transaksioneve të ndërlikuara dhe të jashtëzakonshme.

(6) Ministri i Financave e përcakton mënyrën e zbatimit të masave për analizë më të thjeshtë të klientit.

Analiza e përforcuar e klientit

Neni 33

(1) Në rast kur ekziston rrezik i lartë i larjes së parave ose financimit të terrorizmit është përcaktuar në pajtim me nenin 10 të këtij ligji ose në bazë të vlerësimit nacional të rrezikut nga neni 3 i këtij ligji ose në rast të dyshimit për larje të parave ose financim të terrorizmit, subjekti përpos masave për analizë të klientit nga neni 14 i këtij ligji obligohet që të ndërmarrë një ose më shumë nga masat si vijojnë:

- sigurimi i të dhënave plotësuese për klientin,
- azhurnim i shpeshtuar i dokumenteve dhe të dhënave për klientin,
- sigurimi i të dhënave plotësuese për natyrën dhe marrëdhënien afariste dhe transaksionet e klientit,

- sigurimi i të dhënave plotësuese për burimin e mjeteve dhe burimin e pronës së klientit, sigurimi i informatave për shkaqet e transaksioneve të planifikuara dhe të realizuara,

- sigurimi i lejes nga udhëheqësia e lartë për vendosjen e marrëdhënies së re afariste ose vazhdimin e saj,

- përcjellje e përforcuar e marrëdhënies afariste dhe/ose
- kërkesë që pagesa e parë të kryhet përmes llogarisë së klientit në bankë në Republikën e Maqedonisë.

(2) Zbatimin e masave për analizë të përforcuar nga paragrafi (1) i këtij neni subjekti obligohet që t'i dokumentojë dhe ta bëjë të arritshëm dokumentacionin për organet e mbikëqyrjes nga neni 146 i këtij ligji.

Marrëdhënia korresponduese

Neni 34

Përpos në rastet e nenit 33 të këtij ligji, kur vendosen marrëdhëniet korresponduese, institucioni financiar obligohet që t'i ndërmarrë këto masa të analizës së përforcuar:

a) të grumbullojë të dhëna të mjaftueshme për institucionin korrespondues financiar që plotësisht ta konfirmojë veprimtarinë e vet dhe nga informatat publikisht të arritshme ta përcaktojë reputacionin e saj, si dhe kualitetin e supervizionit, duke përfshirë edhe nëse ka qenë lëndë e hetuesisë për larjen e parave ose financimin e terrorizmit ose masë tjetër për mbikëqyrje,

b) të kërkojë informata edhe në bazë të tyre ta ndryshojë sistemin e mbrojtjes nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit të institucionit financiar korrespondues;

v) të sigurojë leje nga udhëheqësia e lartë për vendosje të marrëdhënies së re korresponduese;

g) saktë t'i përcaktojë të drejtat e ndërsjella dhe obligimet në sferën e pengimit të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit dhe

d) të konfirmojë nëse institucioni financiar korrespondues e kryen analizën e klientit të këtij ligji për personat të cilët kanë qasje të njëjtë në llogaritë e tyre korresponduese tek institucionet financiare në Republikën e Maqedonisë në formë dhe mënyrë të përcaktuar me këtë ligj, si dhe të përcaktojnë nëse institucioni financiar korrespondues është i gatshëm të sigurojë të dhëna për identifikimin dhe konfirmimin e identitetit të klientit nga ana e bankës ose nga institucioni tjetër financiar dhe pronari i tij i vërtetë, dhe t'i dorëzojë në bankë ose në institucion tjetër financiar pas kërkesës së tij.

Klienti i cili nuk është i pranishëm fizikisht

Neni 35

Përpos në rastet e nenit 33 të këtij ligji, kur klienti, i autorizuari ose përfaqësuesi ligjor i klientit personi juridik nuk është i pranishëm fizikisht për qëllimet e identifikimit, subjekti duhet të ndërmarrë një ose më shumë nga këto masa të analizës së përforcuar:

a) identitetin e klientit ta konfirmojë me dokumente plotësuese, të dhëna ose informacione;

b) të marrë masa plotësuese me të cilat do t'i konfirmojë dokumentet e siguruar ose të kërkojë që dokumentet t'i konfirmojë institucioni financiar nga Republika e Maqedonisë, nga vendi anëtar i Bashkimit Evropian ose nga vendi në të cilin dispozitat parashohin përafërsisht kritere të njëjta dhe standarde për pengimin e larjes së parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe kërkesa të parapara me këtë ligj dhe

v) pagesa e parë të kryhet përmes llogarisë së klientit në bankë në Republikën e Maqedonisë.

Klienti bartës i funksionit publik

Neni 36

(1) Përpos në rastet e nenit 33 të këtij ligji, kur subjekti kryen transaksion ose vendos marrëdhënie afariste me klientin - bartës të funksionit publik obligohet që t'i ndërmarrë këto masa të analizës së përforcuar:

a) të përcaktojë nëse klienti - bartës i funksionit publik dhe/ose pronari i vërtetë është bartës i funksionit publik ose të sigurojë deklaratë të tij;

b) të sigurojë leje nga udhëheqësia e lartë për vendosjen e marrëdhënies afariste me klientin-bartës të funksionit publik dhe/ose të pronarit të vërtetë, si dhe të sigurojë pëlqim për vazhdimin e marrëdhënies afariste me klientin ekzistues - bartës të funksionit publik dhe/ose pronarin e vërtetë i cili është bërë bartës i funksionit publik;

v) të marrë masa përkatëse që ta konfirmojë burimin e mjeteve dhe burimin e pronës së klientit - bartës të funksionit publik dhe/ose pronarit të vërtetë i cili është bartës i funksionit publik dhe

g) të kryejë përcjellje të përforcuar të marrëdhënies afariste.

(2) Subjekti obligohet që të ndërmarrë masa me të cilat do të përcaktohet nëse shfrytëzuesi dhe/ose pronari i vërtetë i shfrytëzuesit të sigurimit të jetës dhe sigurimeve të tjera janë të lidhur me investim, është bartës i funksionit publik.

(3) Në rastet nga paragrafi (2) i këtij neni, subjekti obligohet që ta informojë udhëheqjen e lartë

para pagimit të premisë nga polica e sigurimit dhe hollësisht ta shqyrtojë dhe përcaktojë marrëdhënien e plotë afariste me klientin.

(4) Komisioni për Pengimin e Korrupsionit duhet të përgatisë dhe mbajë listë të azhurnuar të këtyre personave shtetas të Republikës së Maqedonisë.

Klientë nga shtete me rrezik të lartë

Neni 37

(1) Përpos në rastet e nenit 33 të këtij ligji, kur klienti është nga shteti me rrezik të lartë, subjekti obligohet që gjatë vendosjes së marrëdhënies afariste ose realizimit të transaksionit të ndërmarrë në veçanti këto masa:

- sigurim të të dhënave plotësuese për klientin dhe/ose pronarin e vërtetë, veprimtarinë e tij, natyrën e marrëdhënies afariste, qëllimin e transaksionit të paralajmëruar ose të kryer, burimin e mjeteve dhe burimin e pronës së klientit,

- azhurnim të shpeshtë të dokumenteve dhe të dhënave për klientin dhe pronarin e vërtetë;

- sigurim të lejes nga udhëheqësia e lartë për vendosjen e marrëdhënies së re afariste ose vazhdim të marrëdhënies afariste ekzistuese, ose

- përcjellje të përforcuar të marrëdhënies afariste dhe aktiviteteve të cilat dalin në kuadër të saj.

(2) Drejtoria rregullisht e publikon listën e shteteve me rrezik të lartë në ueb faqen e vet.

Transaksionet të ndërlikuara dhe të jashtëzakonshme

Neni 38

(1) Subjekti obligohet që tu përkushtojë vëmendje të gjitha transaksioneve të ndërlikuara dhe të jashtëzakonshme, si dhe çdo transaksioni i cili kryhet në mënyrë të jashtëzakonshme që nuk ka arsytim evident ekonomik ose qëllim juridik ose i shmanget punës së zakonshme ose të pritur afariste të klientit dhe në rastet kur lidhur me to ende nuk janë përcaktuar shkaqe për dyshim për larjen e parave ose financimin e terrorizmit.

(2) Subjektet obligohet që tu përkushtojnë kujdes të veçantë marrëdhënies afariste dhe transaksioneve me organizata jopërfutuese.

(3) Lidhur me transaksionet e paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni, subjekti në kuadër të analizës së përforcuar të klientit, obligohet që të ndërmarrë këto masa:

1. grumbullon dhe kontrollon të dhëna plotësuese për:

a) aktivitetin afarist të klientit dhe

b) natyrën e marrëdhënies afariste me klientin

2. grumbullon dhe kontrollon të dhëna për qëllimin e transaksionit të paraqitur ose kryer

3. azhurnon të dhëna nga identifikimi i klientit dhe pronarit të vërtetë dhe

4. grumbullon dhe kontrollon të dhëna për burimin e mjeteve për transaksionin.

(4) Lidhur me transaksionet e paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni subjekti obligohet që rezultatet e analizës nga paragrafi (3) i këtij neni, t'i ruajë në formë me shkrim dhe t'i bëjë të arritshme në kërkesë të organeve të mbikëqyrjes nga neni 146 i këtij ligji.

(5) Nëse pas analizës së zbatuar nga paragrafi (3) i këtij neni, subjekti përcakton se ekzistojnë baza të dyshimit për larjen e parave dhe financimin e terrorizmit, obligohet që të dorëzojë raport në Drejtori në pajtim me nenin 54 të këtij ligji.

Refuzimi i marrëdhënies afariste dhe transaksionit

Neni 39

(1) Kur nuk mund t'i zbatojë masat për analizën e klientit nga neni 14 i këtij ligji, subjekti obligohet që të refuzojë të vendosë marrëdhënie afariste ose të mos kryejë transaksion ose ta ndërpresë marrëdhënien afariste me klientin.

(2) Në rast kur pronari i vërtetë i subjektit juridik nga neni 27 i këtij ligji nuk është i vendosur ose i azhurnuar në regjistrin e pronarëve të vërtetë, subjekti obligohet që ta prolongojë vendosjen e marrëdhënies afariste ose ta prolongojë realizimin e transaksionit derisa të dhënat të vendosen në regjistrin.

(3) Në rastet nga paragrafi (2) i këtij neni, subjekti obligohet që menjëherë ta informojë Drejtorinë.

(4) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, subjekti obligohet që ta konfirmojë nevojën e dorëzimit të raportit në Drejtori në pajtim me nenin 54 të këtij ligji.

Përjashtim nga zbatimi i masave për analizë të klientit

Neni 40

Në rast kur subjekti ka dyshim për larje të parave ose financim të terrorizmit dhe ka krijuar bindje se zbatimi i masave për analizë të klientit do të sjellë në informim të klientit për marrjen e tyre, subjekti mund të mos e zbatojë procesin e plotë të analizës së klientit, por menjëherë të dorëzojë raport në Drejtori në pajtim me nenin 54 të këtij ligji.

Aplikimi i masave dhe veprimeve përparandalim të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit nga ana e degëve dhe filialeve të subjektit

Neni 41

(1) Subjekti që ka degë ose filiale të veta në shtet tjetër duhet të sigurojë zbatimin e masave për parandalimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit në degë ose filiale.

(2) Në rast kur dispozitat e shtetit në të cilin dega ose filiali nga paragrafi (1) i këtij neni ka zyrë, nuk lejojnë zbatim të masave nga paragrafi (1) i këtij neni, subjekti duhet menjëherë ta informojë organin kompetent të mbikëqyrjes nga neni 146 i këtij ligji.

Besimi i obligimeve për analizë të klientit të persona të tretë

Neni 42

(1) Në rastet kur subjektet i zbatojnë masat nga neni 14 i këtij ligji, në kushte të përcaktuara me këtë ligj mund t'ua besojnë aplikimin e masave dhe veprimeve nga neni 14 paragrafi (1) pikat a), b), c) dhe d) të këtij ligji personave të tretë.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni subjektet, nga personat e tretë duhet:

a) menjëherë t'i sigurojnë informatat e nevojshme në pajtim me nenin 14 paragrafin (1) pikat a), b), c) dhe d) të këtij ligji;

b) me kërkesë të tyre pa prolongim të marrin dokumentacionin e nevojshëm për analizën e zbatuar të klientit dhe

v) të vërtetojnë se personi i tretë është i licencuar për veprimtarinë që e kryen dhe lëndë kontrolli nga organi kompetent dhe i plotëson masat për analizë të klientit dhe ruajtjen e të dhënave në pajtim me këtë ligj.

(3) Subjektet, zbatimin e masave dhe veprimeve nga neni 14 paragrafi (1) pikat a), b), c) dhe d) të këtij ligji, mund t'ua besojnë personave të tretë një pjesë të grupit të njëjtë financiar, nëse grupi financiar i aplikon kërkesat për analizë të klientëve, ruajtjen e të dhënave dhe programeve interne për parandalimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit, analizën e përforcuar të bartësve të funksioneve publike në pajtim me standardet ndërkombëtare.

(4) Subjekti obligohet që paraprakisht të kontrollojë nëse personi i tretë nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni i plotëson kushtet nga neni 14 i këtij ligji. Në rast kur personi i tretë është nga shteti tjetër subjekti duhet ta ketë parasysh shkallën e rrezikut nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit në vend. Nuk lejohet besimi i kryerjes së masave dhe veprimeve nga neni 14 paragrafi

(1) pikat a), b), c) dhe d) të këtij ligji të personi i tretë që është prej shtetit që nuk i zbaton standardet për parandalim të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit ose në bankë guaskë.

(5) Përgjegjësia për zbatimin e masave për analizë të klientit në rastet e paragrafit (1) të këtij ligji i mbetet subjektit që ka besuar kryerjen e masave dhe veprimeve nga neni 14 paragrafi (1) pikat a), b), c) dhe d) të këtij ligji të personat e tretë.

(6) Personi i tretë mund të jetë bankë, noter, shoqëri për menaxhim me fonde investuese dhe fond për investim, shoqëri për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare dhe shoqëri për sigurim që kryen punë të sigurimit jetësor.

(7) Subjekti, në suazat e grupacionit të vet, mund ta besojë kryerjen e masave dhe veprimeve nga neni 14 paragrafi (1) pikat a), b), c) dhe d) të këtij ligji të personi i tretë që është pjesë e grupacionit me kusht që:

1. grupacioni t'i zbatojë masat dhe veprimet nga neni 14 paragrafi (1) pikat a), b), c) dhe d) të këtij ligji dhe t'i respektojë obligimet në lidhje me ruajtjen e të dhënave dhe të ketë inkorporuar dhe zbatojë program për parandalimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit që përmban elemente në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe

2. zbatimi i obligimeve në nivel të grupacionit i nënshtrohet mbikëqyrjes nga ana e organeve kompetente për mbikëqyrje nga neni 146 i këtij ligji ose nga organet kompetente për mbikëqyrje të shtetit të tretë.

(8) Si persona të tretë nuk konsiderohen dhënës të shërbimeve të subjekteve ose agjentë me të cilët subjektet kanë lidhur marrëveshje për shërbime, si dhe subjektet e themeluara në shtete me rrezik të

lartë.

Sigurimi dhe përcjellja e informatave në transferimin e mjeteve monetare

Neni 43

(1) Institucionet financiare obligohet që gjatë pagesës së shumës prej 1000 eurosh ose valutë tjetër në kundërvlerë me 1.000 euro ose më shumë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës, për shkak të transferimit të mjeteve monetare nëpërmjet qarkullimit ndërkombëtar pagesor, t'i sigurojnë të dhënat për:

- a) paguesin – nga i cili mund të vërtetohet dhe verifikohet identiteti i tij, edhe atë:
 - emri dhe mbiemri, përkatësisht emri i paguesit,
 - numri i llogarisë, me ç'rast nëse mungon ose nuk mund të vërtetohet, atëherë është e nevojshme të vërtetohet rimitenca monetare unike e identifikimit të transaksionit, që mundëson përcjelljen e saj të plotë dhe
 - adresë ose numër të dokumentit nacional për identifikim ose numër identifikimi të klientit ose datën dhe vendin e lindjes.
- b) pranuesi – nga të cilët mund të vërtetohet identiteti i tij, edhe atë:
 - emri dhe mbiemri, përkatësisht emri i paguesit dhe
 - numri i llogarisë, me ç'rast nëse mungon ose nuk mund të vërtetohet, atëherë është e nevojshme të vërtetohet rimitenca monetare unike e identifikimit të transaksionit, që mundëson përcjelljen e tij të plotë dhe

(2) Institucionet financiare obligohet që gjatë pagesës së shumës prej 1000 eurosh ose valutë tjetër në kundërvlerë me 1.000 euro ose më shumë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës, për shkak të transferimit të mjeteve monetare nëpërmjet qarkullimit ndërkombëtar pagesor, t'i sigurojnë të dhënat për paguesin nëpërmjet të cilave mund të vërtetohet dhe verifikohet identiteti i tij. Nëse për shkaqe teknike, të dhënat e siguruara nuk mund t'i përcjellin, dërgohen vetëm të dhënat për numrin e llogarisë ose rimitenca monetare unike e identifikimit të transaksionit.

(3) Institucionet financiare nga paragrafi (2) i këtij neni, me kërkesë të institucionit financiar që duhet të kryejë pagesën ose nga organet kompetente obligohet që të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni t'i vënë në dispozicion më së shumti në afat prej tre ditëve të punës nga parashtrimi i kërkesës.

(4) Institucionet financiare që paraqiten si ndërmjetësues në transferimin e mjeteve financiare për shuma prej 1.000 eurosh ose valutë tjetër në kundërvlerën e 1.000 eurove ose më shumë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ditën e transferimit, në qarkullimin ndërkombëtar pagesor obligohet që t'i përcjellin të dhënat për paguesin nga paragrafi (1) i këtij neni tek institucioni financiar që do të bëjë pagesën e mjeteve.

(5) Kur bëhen pagesa për transferim të mjeteve monetare në qarkullimin ndërkombëtar pagesor në shumë prej 1.000 eurosh ose valutë tjetër në kundërvlerë të 1000 eurove ose më tepër sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ditën e pagesës, institucionet financiare obligohet që të sigurojnë të dhëna nga institucioni financiar i paguesit për identitetin e paguesit dhe në kuadër të akteve të tyre interne të konstatojnë nëse mungojnë pjesë e të dhënave nga paragrafët (1), (2) dhe (4) të këtij neni dhe mënyrën e veprimit me transferet e atilla. Subjektet duhet t'i kërkojnë të dhënat të cilat mungojnë ose ta refuzojnë kryerjen e transferit.

(6) Institucionet financiare mund ta kufizojnë ose ndërpresin marrëdhënien afariste me institucionet financiare të cilat nuk i sigurojnë, përkatësisht nuk i dërgojnë të dhënat e parapara me paragrafët (1), (2), (4) dhe (5) të këtij neni.

- (7) Dispozitat e këtij neni nuk vlejnë për llojet e transfereve në vijim:
- përdorim të kartelave për tërheqje të mjeteve nga llogaria në bankë, bankomatet ose nëpërmjet pos terminaleve dhe për pagesë në tregti me pakicë.
 - transfere dhe barazime tek të cilat edhe paguesi edhe pranuesi janë banka tek të cilat transferin e bëjnë në emër të tyre dhe në llogari të tyre dhe
 - pagesa të tatimit, dënimeve me para dhe detyrimeve tjera publike.

Punë këmbimi

Neni 44

Subjektet kanë leje për punë këmbimi, krahas masave të përcaktuara me nenin 14 të këtij ligji, obligohet që të vërtetojnë identitetin e klientit në pajtim me nenin 16 të këtij ligji para secilit transaksion që përfshin shumë më të madhe se 500 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë.

Neni 45

(1) Subjektet nga neni 44 i këtij neni kanë për obligim që të dhënat për klientin t'i evidentojnë në mënyrë kronologjike në regjistrë numerik të nënshkruar prej personit të autorizuar ose person tjetër të autorizuar për ta nënshkruar regjistrin e dhënë nga personi udhëheqës në pajtim me aktet e subjekteve.

(2) Ministri i Financave me propozim të drejtorit të Drejtorisë i përcakton formën dhe përmbajtjen e regjistrit numerik nga paragrafi (2) i këtij neni.

Organizuesit e lojërave të fatit

Neni 46

(1) Organizuesit e lojërave të fatit në lojtore (kazino), përkrah masave të përcaktuara me nenin 14 të këtij ligji, obligohet që të vërtetojnë identitetin e klientit në pajtim me nenin 16 të këtij ligji menjëherë pasi të hyjnë në kazino dhe gjatë blerjes ose pagesës së çipeve në shumë mbi 1.000 eurosh në kundërvlerë me denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e blerjes, përkatësisht pagesës, pa marrë parasysh nëse transaksioni bëhet si i ndarë apo nëpërmjet disa transaksioneve të cilat janë dukshëm të lidhura.

(2) Organizuesit e lojërave të fatit, me përjashtim të organizuesve të lojërave të fatit në lojtore (kazino), përkrah masave të përshkruara me nenin 14 të këtij ligji, obligohet që të vërtetojnë identitetin e klientit në pajtim me nenin 16 të këtij ligji para pagesës së përfitimit, pagesës së investimit ose në dy rastet kur transaksioni është me vlerë prej 1000 eurosh ose më shumë në kundërvlerë me denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, pa marrë parasysh nëse transaksioni bëhet si i ndarë apo nëpërmjet disa transaksioneve të cilat janë dukshëm të lidhura.

Shtëpitë brokere dhe banka me leje për punë me letra me vlerë

Neni 47

(1) Shtëpitë brokere dhe bankat me leje për punë me letra me vlerë janë të obliguara të mbajnë regjistrë të numërtuar për tregti me letra me vlerë shuma e përgjithshme e të cilave është më e madhe se 15.000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, të nënshkruar nga personi i autorizuar ose personi tjetër me autorizim për ta nënshkruar regjistrin të dhënë nga personi udhëheqës në pajtim me aktet e shtëpive brokere dhe bankave me leje për punë me letra me vlerë.

(2) Ministri i Financave me propozim të drejtorit të Drejtorisë i përcakton formën dhe përmbajtjen e regjistrit të numërtuar nga paragrafi (1) të këtij neni.

Ndalime

Neni 48

(1) Ndalohet pagimi me para të gatshme të mallrave dhe shërbimeve në shumë prej 2.000 euro ose më shumë në kundërvlerë me denarë në formë të një ose më shumë transaksioneve të lidhura dukshëm, që nuk është kryer përmes bankës, kursimores ose përmes llogarive në institucion tjetër e cila jep shërbime pagesore.

(2) Subjektet që me ligj janë të autorizuar për regjistrim të letrave me vlerë, pronës tjetër ose punëve juridike, ose për paraqitjen ose kryerjen e transferit të parave, letrave me vlerë ose pronës tjetër, mund të kryejnë regjistrim të tillë ose bartje vetëm nëse klienti paraqet provë se bartja e parave mbi shumën nga paragrafi (1) të këtij neni është kryer përmes bankës, kursimores ose përmes llogarisë në institucion tjetër i cili jep shërbime pagesore.

(3) Ndalimi nga paragrafi (1) i këtij neni nuk ka të bëjë me organizuesit e lojërave të fatit.

Neni 49

(1) Ndalohet që institucionet financiare të vendosin ose ta vazhdojnë marrëdhënien afariste me Shell bank (banka guaska) dhe të fillojnë ose vazhdojnë marrëdhënie afariste korrespondente me banka për të cilën e dinë se lejon hapjen dhe punën me llogari të Shell bank (banka guaskë).

(2) Ndalohen që bankat guaska në cilëndo mënyrë të kryejnë aktivitete financiare në Republikën e Maqedonisë.

Neni 50

Ndalohet që institucionet financiare të hapin dhe ruajnë llogari anonime dhe llogari në emra fiktivë

Ruajtja e të dhënave

Neni 51

(1) Subjektet janë të obliguara që kopjet nga dokumentet me të cilat e përcaktojnë dhe verifikojnë identitetin e klientit, të autorizuarit dhe pronarit të vërtetë, për procedurat e zbatuara për analizë të klientit ose pronarit të vërtetë dhe për transaksionet e realizuara ose transaksionet në tentim, dosjen e klientit dhe korrespondencën afariste, t'i ruajnë dhjetë vite në formë elektronike ose në letër pas transaksionit të kryer, duke llogaritur nga transaksioni i fundit

(2) Subjektet janë të obliguara të ruajnë kopje në formë elektronike ose në letër nga analiza e kryer në pajtim me nenin 38 të këtij ligji dhjetë vite.

(3) Subjektet janë të obliguar që të dhënat, t'i ruajnë, në mënyrën në të cilët i kanë dorëzuar te Drejtoria, dhjetë vite nga dita e dorëzimit. Pas kalimit të këtij afati, subjektet janë të obliguara t'i shlyejnë të dhënat personale të klientit.

(4) Institucionet financiare janë të obliguara t'i ruajnë të dhënat për paguesin dhe pranuesin e bartjes pa para të gatshme të mjeteve monetare nga neni 43 të këtij ligji, dhjetë vite nga transferi i kryer.

(5) Regjistri nga nenet 44 dhe 47 të këtij ligji detyrimisht ruhen dhjetë vite nga e dhëna e fundit e regjistruar.

(6) Subjektet janë të obliguara të ruajnë kopje nga dokumentacioni nga neni 58 të këtij ligji dhjetë vite.

(7) Në rast të ndërprerjes të ekzistimit të subjektit, obligimi për ruajtjen e të dhënave në afatin e përcaktuar nga paragrafi (1) të këtij neni, bartet mbi trashëgimtarët juridikë të subjektit.

(8) Nëse nuk kanë trashëgimtar juridik të personit juridik, obligimi për ruajtjen e të dhënave nga paragrafi (1) të këtij neni bartet mbi themeluesit e tyre.

(9) Subjektet janë të obliguara që dokumentet nga paragrafi (1) të këtij neni t'i vënë në disponim me kërkesë të organit të mbikëqyrjes nga neni 146 të këtij ligji.

(10) Me kërkesë të Drejtorisë subjektet janë të obliguara t'i ruajnë të dhënat nga paragrafi (1) të këtij neni më gjatë se dhjetë vite.

Dorëzimi i të dhënave te Drejtoria

Neni 52

(1) Subjektet janë të obliguara që të dhënat, informatat dhe dokumentet e mbledhura, t'i dorëzojnë te Drejtoria në rast të transaksionit me para të gatshme në shumë prej eurosh në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ose më shumë pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për një ose më shumë transaksione të lidhura dukshëm.

(2) Subjektet të dhënat, informacionet dhe dokumentet e mbledhura për transaksionet e kryera nga paragrafi (1) të këtij neni, janë të obliguara t'i dorëzojnë te Drejtoria më së voni në afat prej tri ditësh pune nga transaksioni i kryer në formë të raportit.

(3) Ministri i Financave me propozim të drejtorit të Drejtorisë i përcakton formën dhe përmbajtjen e raportit nga paragrafi (2) të këtij neni.

Neni 53

(1) Noterët të dhënat e mbledhura për aktet noteriale të përpiluara, dokumente private të vërtetuara dhe nënshkrimeve të verifikuara të marrëveshjeve me të cilët fitohet pronë në vlerë prej 15.000 eurosh ose më shumë, në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën kur janë përpiluar aktet noteriale, dokumentet private të vërtetuara dhe nënshkrimet e vërtetuara, të theksuara në marrëveshje, i dorëzojnë te Drejtoria në fund të ditës në formë elektronike.

(2) Bankat të dhënat e mbledhura për kredi të paguara klientëve të tyre në vlerë prej 15.000 eurosh ose më shumë, në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën kur kredia është paguar, i dorëzojnë te Drejtoria deri në ditën e dhjetë në muajin vijues për muajin paraprak në formë elektronike.

(3) Bankat të dhënat e mbledhura për hua të dhëna dhe/ose të pranuar mes klientëve në vlerë prej 5.000 eurosh ose më shumë, në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, i dorëzojnë te Drejtoria deri në ditën e dhjetë në muajin vijues për muajin paraprak në formë elektronike.

(4) Dhënësit e shërbimeve të dërgesave monetare (transfer i shpejtë i parave) të dhënat për transaksione në shumë prej 1.000 eurosh ose më shumë në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e kryerjes së transaksionit, i dorëzojnë te Drejtoria në fund të ditës në formë elektronike për transaksionet e kryera në ditën parapake të punës.

(5) Shoqëritë e sigurimit të cilat kryejnë punë të sigurimit të jetës, të dhënat e mbledhura për polica të lidhura për sigurim të jetës në vlerë të sigurimit në shumë prej 15.000 eurosh ose më shumë në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në

ditën e lidhjes së policës për sigurim, i dorëzojnë te Drejtoria në fund të ditës në formë elektronike.

(6) Personat juridikë veprimtaria e të cilëve është shitblerja e automjeteve, të dhënat e mbledhura për marrëveshje të lidhura për shitblerjen e automjeteve të reja në vlerë prej 15.000 eurosh ose më shumë në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e lidhjes marrëveshjes, i dorëzon te Drejtoria në fund të ditës në formë elektronike.

(7) Organizatorët e lojërave të fatit në lojtore (kazino), të dhënat e mbledhura për blerje ose dërgimin e çipave në shumë mbi 1000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e blerjes, respektivisht pagimit, pa marrë parasysh nëse transaksioni kryhet si pagesë individuale ose përmes disa transaksioneve të cilat janë të lidhura dukshëm, i dorëzon te Drejtoria në fund të ditës në formë elektronike.

(8) Organizatorët e tjerë të lojërave të fatit, përveç organizatorëve të lojërave të fatit në lojtore (kazino), të dhënat e mbledhura për pagesë të fitimit, pagimit të bastit ose edhe në të dy rastet kur transaksioni është në vlerë prej 1000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, pa marrë parasysh nëse transaksioni kryhet si individuale ose përmes disa transaksioneve të cilat janë të lidhur në mënyrë evidente, i dorëzon te Drejtoria në fund të ditës në formë elektronike.

(9) Ministri i Financave me propozim të drejtorit të Drejtorisë, i përcakton përmbajtjen dhe llojin e të dhënave nga paragrafët (1), (2), (3), (4), (5), (6), (7) dhe (8) të këtij neni dhe mënyrën e dorëzimit elektronik te Drejtoria.

Neni 54

(1) Subjektet janë të obliguara që të dhënat, informacionet dhe dokumentet e mbledhura, t'i dorëzojnë te Drejtoria kur dyshojnë ose kur kanë bazë për dyshim se:

- ka qenë apo është kryer larje e parave dhe/ose financim i terrorizmit ose është bërë tentim ose tentohet larje e parave dhe/ose financim i terrorizmit, pa marrë parasysh shumën e transaksionit,
- prona është e ardhur nga vepër e dënueshme dhe
- prona është e lidhur me financim të aktit terrorist, organizatës terroriste ose terrorist person i cili financon terrorizëm.

(2) Subjekti për dyshimet nga paragrafi (1) të këtij neni, është i obliguar që menjëherë ta njoftojë Drejtorinë dhe ta mbajë transaksionin:

- më gjatë deri 2 orë nga njoftimi i Drejtorisë, kur bazat e dyshimit i ka kuptuar para kryerjes së transaksionit dhe
- më gjatë deri 4 orë nga njoftimi i Drejtorisë, kur bazat e dyshimit i ka kuptuar gjatë kryerjes së transaksionit.

(3) Subjekti për dyshimet nga paragrafi (1) të këtij neni është i obliguar të dorëzojë të dhëna, informata dhe dokumente te Drejtoria në formë të raportit më së voni në afat prej 24 orësh prej kur i ka kuptuar bazat e dyshimit.

(4) Nëse të dhënat e dorëzuara nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni janë të pamjaftueshme, Drejtoria mund të kërkojë informata, të dhëna dhe dokumentacion plotësues nga subjekti.

(5) Nëse Drejtoria nuk e njofton subjektin për aktivitet e mëtejshme në afatet e përcaktuara nga paragrafi (2) të këtij neni, subjekti mund ta kryejë ose refuzojë transaksionin.

(6) Subjektet janë të obliguara që në formë të shkruar ta njoftojnë organin kompetent për mbikëqyrje nga neni 146 të këtij ligji se kanë dorëzuar raport nga paragrafi (3) të këtij neni te Drejtoria, në afat prej tri ditësh pune nga dorëzimi i raportit.

(7) Ministri i Financave me propozim të drejtorit të Drejtorisë i përcakton formën dhe përmbajtjen e raportit nga paragrafi (3) të këtij neni.

(8) Drejtoria është e obliguar ta njoftojë subjektin për pranimin dhe për kontrollet e kryera të raportit nga paragrafi (3) të këtij neni.

Neni 55

Bazat e dyshimit nga neni 54 paragrafi (1) të këtij ligji, subjekti i përcakton në bazë të:

- njohurive të drejtpërdrejta,
- listës së indikatorëve për njohje të transaksioneve të dyshimta të përcaktuara nga Drejtoria, subjektet dhe organe mbikëqyrëse,
- listës së konsoliduar e cila mbahet në pajtim me dispozitat për masa restriktive,
- vlerësimit të rrezikut nga larja e parave dhe financimit të terrorizmit dhe
- Informatave tjera relevante.

Neni 56

(1) Subjektet janë të obliguara që raportet te Drejtoria t'i dorëzojnë në formë elektronike të mbrojtur. Nëse mënyra e tillë e dorëzimit është e pamundësuar nga arsye teknike, subjektet raportet i dorëzojnë në formë të shkruar.

(2) Njoftimet e dhëna në Drejtori me telefon duhet të vërtetohen në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni më së voni në afat prej 24 orësh.

(3) Drejtoria nuk guxon ta zbulojë identitetin e të punësuarit në subjekt i cili e dorëzon raportin, përveç në rastet kur ekziston dyshim se i punësuarit ose subjekti ka kryer veprë të dënueshme larje të parave dhe/ose financim të terrorizmit, me kërkesë me shkrim të gjykatës kompetente kur është e domosdoshme të përcaktohen faktet gjatë procedurës penale.

Emërimi i personit të autorizuar dhe formimi i seksionit për parandalim të larjes së parave dhe financim të terrorizmit

Neni 57

(1) Subjektet janë të obliguara të emërojnë person të autorizuar dhe zëvendës të tij.

(2) Nëse në subjekt janë punësuar më shumë se 50 persona, krahas obligimit nga paragrafi (1) të këtij neni, subjekti në suaza të punës së vet është i obliguar të formojë seksion të veçantë për parandalim të larjes së parave dhe financim të terrorizmit.

(3) Në seksionin nga paragrafi (2) të këtij neni duhet të jenë të punësuar së paku katër persona nëse në subjekt janë punësuar prej 50 deri 300 persona, e numri i të punësuarve në seksion duhet të rritet për nga një person në çdo 100 të punësuar.

(4) Subjekti mundet, në bazë të rezultetit nga vlerësimi i rrezikut, në seksionin nga paragrafi (2) të këtij neni të punësojë edhe më shumë persona nga numri i paraparë në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni.

(5) Me punën e seksionit nga paragrafi (2) të këtij neni udhëheq person i autorizuar.

(6) Personi i autorizuar, zëvendësi i tij, si dhe të punësuarit në seksion duhet t'i plotësojnë kushtet si vijojnë:

a) nuk janë dënuar për vepra penale kundër pronës, vepra penale kundër financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë, vepra penale kundër detyrës zyrtare, vepra penale kundër rendit publik dhe vepra penale kundër njerëzisë dhe të drejtës ndërkombëtare etj.;

b) kanë arsim të lartë, njohuri profesionale përkatëse dhe përvojë për kryerjen e detyrave nga sfera e parandalimit të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit dhe

v) ka njohje të mirë të aktivitetit afarist dhe procese punuese të subjektit.

(7) Personi i autorizuar, zëvendësi i tij, si dhe të gjithë të punësuarit në seksion nga paragrafi (3) të këtij neni, i nënshtrohen kontrolleve të sigurisë në pajtim me dispozitat për siguri të informatave të klasifikuara dhe janë të obliguar të posedojnë certifikatë sigurie me shkallë "sekrete". Personi i autorizuar, zëvendësi i tij dhe i punësuarit në seksionin nga paragrafi (3) të këtij neni, nuk mund të jetë person të cilit në pajtim me dispozitat për siguri të informacioneve të klasifikuara nuk mund t'i jepet certifikatë sigurie me shkallë "sekrete".

(8) Për shkak të punës efikase të personit të autorizuar, zëvendësit të tij dhe të punësuarit në seksion, subjekti është i obliguar të sigurojë plotësim të së paku kushteve në vijim:

- ndarje e aktiviteteve të personit të autorizuar, respektivisht të seksionit, nga aktivitetet tjera afariste të subjektit, të cilët nuk janë lidhur me aktivitete të parandalimit të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit dhe kontrollit të harmonizimit të punës me dispozitat,

- pavarësi e personit të autorizuar dhe të seksionit gjatë zbatimit të masave dhe veprimeve për zbulimin dhe parandalimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit në pajtim me këtë ligj, të drejtë të qasjes së drejtpërdrejtë te bazat elektronike të të dhënave dhe qasje në kohë të informatat e nevojshme për zbatim të papenguar të programit dhe dispozitave të këtij ligji dhe

- vendosje e komunikimit të drejtpërdrejtë me organet e menaxhimit të subjektit etj.

(9) Bankat dhe dhënësit e shërbimeve të dërgesave monetare (transfer i shpejtë i parave) janë të obliguar të emërojnë person të autorizuar kujdestar dhe zëvendës të tij i cili në raste urgjente (akt terrorist, kërcënime nga akt terrorist) menjëherë, e më së voni në afat prej tri orësh do të jetë i arritshëm për Drejtorinë. Personi i autorizuar kujdestar dhe zëvendësi i tij duhet ta plotësojë kushtin nga paragrafi (7) të këtij neni.

(10) Bankat dhe dhënësit e shërbimeve të dërgesave monetare (transfer i shpejtë i parave) janë të obliguara që për kryerjen e obligimeve të personit të autorizuar zyrtar dhe zëvendësit të tij nga paragrafi (9) të këtij neni t'i sigurojnë kushte të nevojshme për punë.

(11) Subjekti është i obliguar të marrë masa me të cilat do të sigurohet se të punësuarit të cilët kryejnë

detyra nga sfera e parandalimit dhe zbulimit të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit në pajtim me këtë ligj, janë të njohftuar me dispozitat e këtij ligji, duke përfshirë masa adekuate në lidhje me mbrojtjen e të dhënave. Masat doemos duhet të jenë proporcionale me llojin dhe madhësinë e subjektit dhe rrezikun e vlerësuar nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit.

(12) Subjekti është i obliguar të sigurojë trajnim profesional të rregullt nga sfera e parandalimit dhe zbulimit të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit në pajtim me këtë ligj për të gjithë të punësuarit.

(13) Subjektet janë të obliguara që te Drejtoria të dorëzojnë të dhëna për personat (emri, mbiemri dhe kontakti) nga paragrafi (1) dhe paragrafi (9) të këtij neni, si dhe ta njoftojnë Drejtorinë për çdo ndryshim.

Obligim për kontroll të brendshëm

Neni 58

Subjektet janë të obliguara të kryejnë kontroll të brendshëm mbi zbatimin e masave dhe veprimeve për parandalim të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit së paku një herë në vit dhe të përgatisin dokumentacion për të dhënat e konstatuara nga kontrolli i zbatuar.

Implementimi i softuerit për përpunim automatik të të dhënave

Neni 59

(1) Bankat janë të obliguara të implementojnë dhe rregullisht ta mbindërtojnë softuerin për përpunim automatik të të dhënave në pajtim me karakteristikat e softuerit për përpunim automatik të të dhënave.

(2) Ministri i Financave me propozim të drejtorit të Drejtorisë më afërsiaht i përcakton karakteristikat e softuerit për përpunim automatik të të dhënave.

Shfrytëzimi i të dhënave të siguruara me këtë ligj nga ana e subjekteve

Neni 60

(1) Të dhënat e siguruara në bazë të këtij ligji, duke përfshirë edhe të dhënat personale shfrytëzohen vetëm për zbulimin dhe parandalimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

(2) Nuk llogaritet për dhënie të fshehtësisë afariste ose për zbulim të të dhënave dhe informatave të klasifikuara dorëzimi i të dhënave nga paragrafi (1) të këtij neni i te Drejtoria dhe te organi përkatës i mbikëqyrjes nga neni 146 të këtij ligj gjatë kryerjes së mbikëqyrjes në pajtim me këtë ligj.

(3) Të punësuarit në subjektet dhe personat të cilët menaxhojnë me subjektet të cilët kanë obligim të ndërmarrin masa dhe veprime për zbulim dhe parandalim të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit, në pajtim me këtë ligj, nuk guxojnë t'i shfrytëzojnë të dhëna personale nga dosjet e klientëve për qëllime tjera, përveç për zbatimin e masave dhe veprimeve për zbulimin dhe parandalimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit në pajtim me qëllimet e parapara me këtë ligj.

Ndalimi për zbulimin e të dhënave dhe informatave

Neni 61

(1) Subjekti dhe të punësuarit e tij, duke përfshirë edhe anëtarët e këshillit drejtues dhe mbikëqyrës ose persona tjerë të cilëve në çfarëdo mënyre i janë të arritshme të dhënat e siguruara në pajtim me këtë ligj ose aktet nënligjore të miratuara në pajtim me këtë ligj, nuk mund ta njoftojnë klientin ose personin e tretë:

1. se vijon ose është e mundshme analiza për përcaktimin e bazës së dyshimit për larje të parave ose financim të terrorizmit nga ana e Drejtorisë;

2. se te Drejtoria është dorëzuar ose do të dorëzohet e dhënë, informatë ose dokumentacion për klientin ose personin e tretë ose transaksion;

3. se Drejtoria ka dhënë urdhër për ndjeke të marrëdhënies afariste ose urdhër me shkrim për ndalje të përkohshme të transaksionit;

4. se kundër klientit ose personit të tretë kanë filluar ose është e mundshme fillimi i veprimeve parhetimore, hetimit ose procedurës penale për larje të parave ose financim të terrorizmit.

(2) Të dhënat, informatat dhe dokumentacioni nga paragrafi (1) të këtij neni janë të dhëna të klasifikuara për të cilat është përcaktuar shkallë adekuate e klasifikimit në pajtim me dispozitat për mbrojtje të informatave të klasifikuara.

(3) Subjekti është i obliguar të ndërmarrë masa teknike, kadrovike dhe organizative për mbrojtje të

të dhënave të siguruara në pajtim me dispozitat e këtij ligji të cilat janë të nevojshme me qëllim të mbrojtjes së tyre nga humbja e rastësishme, shkatërrimi ose qasja e palejueshme, zbatimi i paautorizuar i çfarëdo keqpërdorimi tjetër dhe të përcaktojnë obligim të të punësuarve të cilët i përpunojnë të dhënat të nënshkruajnë deklaratë për fshehtësi.

(4) Ndalimi për zbulimin e të dhënave dhe informatave nga paragrafi (1) të këtij neni nuk zbatohet, përveç nëse Drejtoria nuk vendos ndryshe, kur:

a) këmbehen të dhënat dhe informatat mes institucioneve financiare të cilat janë pjesë e grupit të njëjtë me kusht që t'i zbatojnë dispozitat të cilat dalin nga dispozitat dhe standardet valide ndërkombëtare për parandalim të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit;

b) këmbehen të dhënat dhe informatat mes subjekteve nga neni 5 pika 2 të këtij ligji nga shtete në të cilat janë përcaktuar dispozitat e njëjta për zbulim dhe parandalim të larjes së parave si dispozitat e këtij ligji, e të cilat veprimtarinë e tyre profesionale e kryejnë si pjesë e personit të njëjtë juridik ose si pjesë e strukturës më të madhe pronësore ose drejtuese të cilës i takon personi juridik.

(5) Ndalimi për zbulimin e të dhënave dhe informatave nga paragrafi (1) të këtij neni nuk zbatohet për të dhënat dhe informatat të cilat kanë të bëjnë me klient të njëjtë dhe transaksion të njëjtë ku marrin pjesë dy ose më shumë subjekte me kusht që t'i zbatojnë masat për parandalim të larjes së parave dhe financim të terrorizmit, kryejnë lloj të njëjtë të veprimtarisë dhe i nënshtrohen obligimeve për mbrojtje të fshehtësisë afariste dhe mbrojtje të të dhënave personale.

Përfundimi nga përgjegjësia për njoftim dhe mbajtje

Neni 62

(1) Nuk do të ngritet procedurë për përcaktim të përgjegjësisë për dhënien e fshehtësisë afariste kundër personave ose organit udhëheqës dhe të punësuarve në subjektet të cilët kanë dorëzuar informata ose raporte në lidhje me transaksione të dyshimta te Drejtoria.

(2) Nuk mund të ngritet procedurë për përgjegjësi civile ose penale kundër personave zyrtarë ose përgjegjës, organit udhëheqës ose të punësuarve në subjektet të cilët kanë dorëzuar të dhëna, informata, dokumente ose raporte në pajtim me dispozitat e këtij ligji, bile edhe në rast kur procedura për informatat dhe raportet e dhëna nuk ka sjellë në përcaktimin e përgjegjësisë, respektivisht aktgjykim të plotfuqishëm.

(3) Nuk mundet të ngritet procedurë për përgjegjësi civile ose penale kundër personave zyrtarë ose përgjegjës, organit udhëheqës dhe të punësuarve në subjekte, për shkak të dëmit të shkaktuar material ose jomaterial, si pasojë nga mbajtja e transaksioneve në pajtim me dispozitat e këtij ligji, përveç nëse me mbajtjen e tillë janë plotësuar karakteristikat për ndonjë vepër penale.

Fshehtësi afariste

Neni 63

Thirrja për dhënien e fshehtësisë afariste nuk mund të pranohet si bazë për refuzim që të dorëzohen të dhënat, informatat, dokumentet sipas këtij ligji.

KAPITULLI IV.

DREJTORIA PËR ZBULIM FINANCIAR

Neni 64

(1) Drejtoria është njësi për zbulim financiar në Republikës së Maqedonisë, e themeluar për qëllime të mbledhjes dhe analizës së raporteve për transaksione të dyshimta dhe informatave tjera me rëndësi për parandalim dhe zbulim të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit dhe dorëzimit të rezultateve nga analiza dhe informatave tjera relevante plotësuese te organet kompetente kur ekzistojnë baza për dyshim për larje të parave dhe financim të terrorizmit.

(2) Drejtoria është organ i administratës shtetërore në përbërje të Ministrisë së Financave, në cilësi të personit juridik.

(3) Drejtoria i ka kompetencat në vijim:

- mbledh, përpunon, analizon, ruan dhe dorëzon të dhëna të mara në bazë të këtij ligji,
- mbledh të dhëna, informata dhe dokumente, të domosdoshme për kryerjen e kompetencave të veta,
- përgatit dhe dorëzon raporte te organet shtetërore kompetente, çdo herë kur ekzistojnë baza për dyshim për vepër penale të kryer larje të parave ose financim të terrorizmit,
- përgatit dhe dorëzon njoftim te organet shtetërore kompetente për ekzistimin e bazës së dyshimit për vepër tjetër penale të kryer,

- i jep urdhër me shkrim subjektit me të cilin përkohësisht e mban transaksionin;
 - parashtron kërkesë për parashtrim të propozimit për përcaktimin e masave të përkohshme të prokurori publik kompetent,
 - parashtron urdhër për ndjekjen e marrëdhënies afariste të subjekti,
 - lëshon urdhërpagesë kundërvajtëse,
 - parashtron kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse para gjykatës kompetente,
 - përgatit analiza strategjike për përcaktimin e trendeve dhe tipologjive të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit,
 - bashkëpunon me subjektet nga neni 5 të këtij ligji, me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë, Agjencinë e Zbulimit, Drejtorinë e Policisë Financiare, Drejtorinë Doganore, Drejtorinë e të Hyrave Publike, Inspektoratin Shtetëror Devizor, Komisionin për Letra me Vlerë të Republikës së Maqedonisë, Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë, Agjencinë për supervizion të sigurimit pensional me financim kapital, Agjencinë për Supervizion të Sigurimit, Agjencia për Supervizion të Sigurimit, Komisionin Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit, Entin Shtetëror të Revizionit, Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë dhe organet dhe institucionet tjera shtetërore, si dhe me organizata, institucionet tjera dhe trupa ndërkombëtarë për luftë kundër larjes së parave dhe kundër financimit të terrorizmit,
 - lidh marrëveshje për bashkëpunim dhe shkëmben të dhëna dhe informata me njësi për zbulim financiar të shteteve tjera dhe organizata ndërkombëtare, të përfshirë në luftë kundër larjes së parave dhe financimit të terrorizmit,
 - mëvetësisht ose në bashkëpunim me organet për mbikëqyrje nga ky ligj kryen mbikëqyrje mbi subjektet për zbatimin e masave dhe veprimeve të përcaktuara me këtë ligj,
 - merr pjesë në zbatimin e vlerësimit nacional të rrezikut nga larja e parave dhe financimit të terrorizmit dhe zbaton vlerësim të rrezikut mbi kategori të caktuara të subjekteve,
 - ngrit iniciativë ose jep mendim për ligjet dhe aktet nënligjore që kanë të bëjnë me parandalimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit,
 - mund të ndihmojë në përsosje profesionale të personave të autorizuar dhe të punësuarve në seksionin e parandalimit të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit në subjektet nga neni 5 i këtij ligji,
 - përcakton listë të treguesve për identifikimin e transaksioneve të dyshimta në bashkëpunim me subjektet dhe organet që kryejnë mbikëqyrje mbi punën e tyre dhe i azhurnojnë rregullisht,
 - planifikon dhe zhvillon trajnime për përsosje dhe aftësim të të punësuarve në Drejtori,
 - zbaton aktivitete drejtuar ngritjes së vetëdijes së sektorit joqeveritar për rreziqet nga keqpërdorimi i tyre i mundshëm për qëllimet e financimit të terrorizmit,
 - jep sqarim në zbatimin e dispozitave për parandalim të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit,
 - mban evidencë, si dhe statistikë gjithëpërfshirëse për qëllimet e vlerësimit të efikasitetit të sistemit për luftë kundër larjes së parave dhe financimit të terrorizmit,
 - vepron në pajtim me dispozitat e Ligji për masa restriktive dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij dhe
 - kryen punë tjera të përcaktuara me ligj.
- (4) Për kryerjen e kompetencave të veta, Drejtoria ka qasje elektronike direkte ose indirekte në kohë të duhur të të dhënave, informatat dhe dokumentacionin me të cilët disponojnë subjektet, organet shtetërore dhe institucionet dhe persona tjerë juridikë ose fizikë në pajtim me dispozitat e këtij ligji.
- (5) Drejtoria punët nga kompetenca e saj i kryen në pajtim me ligjin dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me të cilat rregullohet parandalimi i larjes së parave dhe financimit të terrorizmit.
- (6) Të dhënat e mbledhura personale për qëllimet të këtij ligji shfrytëzohen në pajtim me këtë ligj dhe dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.
- (7) Drejtoria një herë në vit përgatit raport për punë nga kompetenca e vet dhe program për punë për vitin e ardhshëm dhe i dorëzon te ministri i Financave dhe te Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Drejtoria mund të dorëzojë edhe raport tjetër me kërkesë të ministrit të Financave ose të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Neni 65

- (1) Drejtoria kompetencat e veta i zbaton në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë.
- (2) Selia e Drejtorisë është në Shkup.

Mëvetësia, pavarësia operative dhe financimi i Drejtorisë

Neni 66

(1) Drejtoria është e mëvetësishme dhe operacionalisht e pavarur në zbatimin e kompetencave të përcaktuara me këtë ligj dhe ka autorizim që plotësisht lirisht t'i kryejë kompetencat e veta duke përfshirë edhe vendimmarrjen në lidhje me analizën, kërkimin, përcjelljen dhe dorëzimin e rezultateve nga analizat dhe informatat e veta, të dhënat dhe dokumentacioni të organet kompetente dhe njësitë për zbulim financiar të shtetit tjetër.

(2) Mjetet e nevojshme financiare për financim të Drejtorisë sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 67

(1) Drejtoria dhe të punësuarit e saj nuk janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar subjekteve, klientëve të subjekteve ose personave të tretë në rastet kur veprojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji ose aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij.

(2) Republika e Maqedonisë nuk përgjigjet për dëmet të cilat mund të shkaktohen me zbatimin e dispozitave të këtij ligji ose aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij.

(3) Me përjashtim, dispozitat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni nuk zbatohen nëse dëmi është shkaktuar qëllimisht.

Neni 68

(1) Drejtorin e Drejtorisë e emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit të Financave pas shpalljes së zbatuar publike, të shpallur në tri gazeta ditore në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë nga të cilët një nga gazetat që botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

(2) Drejtori i Drejtorisë ka mandat prej pesë vitesh, me mundësi për rizgjedhje.

(3) Për drejtor mund të emërohet person i cili i plotëson kushtet në vijim:

1) të jetë shtetas vetëm i Republikës së Maqedonisë;

2) të ketë fituar 240 kredi sipas SETK ose shkallën VII/1 të arsimit;

3) të ketë së paku pesë vjet përvojë pune në sferën e parandalimit të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit

4) nuk është dënuar për vepra penale kundër pronës, vepra penale kundër financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë, vepra penale kundër detyrës zyrtare, vepra penale kundër rendit publik dhe vepra penale kundër njerëzisë dhe të drejtës ndërkombëtare dhe vepra penale tjera dhe

5) të ketë dëshmi përkatëse (certifikatë) jo më të vjetër se pesë vjet, për gjuhë të dhënë angleze:

- TOEFEL IBT së paku 74 pikë,

- IELTS (IELTS) së paku 6 pikë,

- ILEC (ILEC) (Cambridge English First) së paku nivelin B2 (B2),

- BULATS (BULATS) së paku 60 pikë ose

- APTIS (APTIS) - së paku nivelin B2 (B2).

(4) Mandati i drejtorit pushon:

- pas kalimit të pesë viteve nga dita e emërimit,

- në rast të vdekjes,

- në rast të dorëheqjes së tij,

në rast të shkarkimit,;

- në rast kur me aktgjykim të plotfuqishëm është dënuar për vepër penale me burg në kohëzgjatje prej së paku gjashtë muajsh,

- kur nga ana e gjykatës i është shqiptuar masa ndalim për kryerjen e veprimtarisë së personit udhëheqës në institucion dhe

- nëse e humb aftësinë për punë.

(5) Drejtori mund të shkarkohet, për shkak të:

- punës joligjore,

- kryerjes e detyrës së drejtorit në mënyrë jo profesionale,

- në rast të sëmundjes së gjatë dhe të rëndë e cila e pengon kryerjen e obligimeve të veta dhe

- me kërkesë të tij.

(6) Drejtori udhëheq dhe e përfaqëson Drejtorinë, organizon dhe siguron kryerjen e punëve në mënyrë ligjore, efikase dhe profesionale të Drejtorisë, miraton aktvendime, urdhra dhe urdhra interne, udhëzime, plane dhe programe, vërejtje me rekomandime dhe akte tjera.

(7) Drejtori mund të autorizojë zbulues financiar nga kategoria A nga paragrafi (1) të nenit 71 të këtij ligji, në rast të mungesës ose pengimit të tij, të nënshkruajë akte nga paragrafi (6) të këtij neni.

Neni 69

Drejtori i Drejtorisë dhe të punësuarit e saj i nënshtrohen kontrolleve të sigurisë në pajtim me

dispozitat për siguri të informatave të klasifikuara.

Neni 70

Në Drejtori vendet e punës së të punësuarve grupohen në grupe dhe nëngrupe:

- persona të autorizuar zyrtarë,
- nëpunës administrativë dhe
- persona ndihmës - teknikë.

Klasifikimi i vendeve të punës të personave të autorizuar zyrtarë në Drejtorinë

Neni 71

(1) Për personat e autorizuar zyrtarë në Drejtorinë përcaktohen kategoritë e vendeve të punës si në vijim:

- kategoria A – persona udhëheqës-zbulues financiarë

dhe - kategoria B – zbulues financiarë.

(2) Në kuadër të kategorisë A përcaktohen këto nivele të vendeve të punës:

- niveli A1 – udhëheqës i sektorit – zbulues financiar,
- niveli A2 – ndihmës udhëheqës i sektorit – zbulues financiar dhe
- niveli A3 – udhëheqës i seksionit – zbulues financiar.

(3) Në kuadër të kategorisë B përcaktohen këto nivele të vendeve të punës:

- niveli B1 – zbulues financiar i pavarur,
- niveli B2 – zbulues financiar i lartë,
- niveli B3 – zbulues financiar dhe
- niveli B4 – zbulues financiar i ri.

Neni 72

(1) Të punësuarit në Drejtori kanë legjitimacion zyrtar.

(2) Formën, përmbajtjen, mënyrën e lëshimit, marrjen dhe shfrytëzimin e legjitimacionit zyrtar me propozim të drejtorit, e përcakton ministri i Financave.

Neni 73

Për zbuluesit financiarë në Drejtorinë zbatohet ky ligj, Ligji për marrëdhëniet e punës, Ligji për të punësuarit në sektorin publik dhe rregullat nga sfera e shëndetësisë, sigurimit pensional dhe invalidor dhe Marrëveshja e përgjithshme kolektive për sektorin publik të Republikës së Maqedonisë, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

Punësimi i zbuluesit financiar

Neni 74

(1) Në Drejtorinë si zbulues financiar mund të punësohet personi i cili përveç kushteve të përgjithshme i plotëson kushtet e veçanta të parapara me këtë ligj dhe aktin për sistematizimin e vendeve të punës në Drejtorinë.

(2) Si zbulues financiar mund të punësohet personi i cili:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- 2) ka përfunduar arsimin përkatës të përcaktuar me aktin për sistematizim,
- 3) i plotëson edhe kushtet e veçanta të përcaktuara me aktin për sistematizim dhe
- 4) të ketë dëshmi adekuate (certifikatë) jo më të vjetër se pesë vjet, për gjuhën angleze të dhënë:
 - TOEFL IBT së paku 74 pikë,
 - IELTS (IELTS) së paku 6 pikë,
 - ILEC (ILEC) (Cambridge English First) së paku niveli B2 (B2),
 - BULATS (BULATS) së paku 60 pikë ose
 - APTIS (APTIS) – së paku niveli B2 (B2).

Procedura për punësimin e zbuluesit financiar

Neni 75

(1) Punësimi i zbuluesit financiar në Drejtorinë bëhet në pajtim me Planin vjetor për punësim.

(2) Planin vjetor për punësim e miraton drejtori i Drejtorisë më së voni deri më 31 mars për vitin e ardhshëm me pëlqim paraprak të Ministrisë së Financave.

(3) Zbuluesi financiar themelon marrëdhënie pune në Drejtorinë në bazë të konkursit publik, në procedurë dhe kushte të përcaktuara me këtë ligj.

(4) Procedura për themelimin e marrëdhënies së punës të zbuluesit financiar në bazë të konkursit

publik zbatohet me njoftimin e marrë paraprakisht për mjete të siguruara financiare nga Ministria e Financave.

(5) Drejtoria e shpall konkursin publik nga paragrafi

(3) i këtij neni, në internet faqen e vet dhe së paku në dy gazeta ditore nga të cilat njëren nga gazetat që botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

(6) Afati për paraqitje në konkursin publik nga paragrafi (3) i këtij neni nuk mund të jetë më i shkurtër se pesë ditë nga dita e shpalljes së tij.

Neni 76

(1) Drejtori i Drejtorisë formon Komision për seleksionim për punësimin e zbuluesit financiar (në tekstin e mëtutjeshëm: Komisioni për seleksionim) i cili e zbaton procedurën e nenit 81 paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Komisioni për seleksionim nga paragrafi (1) i këtij neni përbëhet nga zbulues financiarë të punësuar në Drejtorinë, edhe atë kryetar dhe dy anëtarë dhe zëvendës të tyre.

(3) Kryetari i Komisionit për seleksionim nga paragrafi

(1) i këtij neni është udhëheqësi i sektorit, përkatësisht i seksionit në të cilin punësohet zbuluesi financiar, ndërsa dy anëtarët tjerë të Komisionit për seleksionim janë zbulues financiar të punësuar në Drejtorinë.

Neni 77

(1) Procedura për seleksionim për punësimin e kandidatit si zbulues financiarë përbëhet nga seleksionimi administrativ, provimi me shkrim dhe intervista.

(2) Seleksionimi administrativ përbëhet nga kontrollimi i të dhënave të shënuara në fletëparaqitjen dhe dokumentacioni i dorëzuar për punësim me kushtet e përcaktuara në konkursin publik.

(3) Seleksionimi administrativ nga paragrafi (2) i këtij neni zbatohet në afat prej pesë ditësh pas përfundimit të konkursit publik dhe përfundon me shpalljen e listës së kandidatëve të cilët e kanë kaluar seleksionimin administrativ në internet faqen e Drejtorisë.

(4) Kandidatët të cilët i kanë plotësuar kushtet pas seleksionimit të zbatuar administrativ japin provim me shkrim.

(5) Data dhe koha e mbajtjes së provimit me shkrim nga paragrafi (1) i këtij neni nuk mund të jetë më e shkurtër se dhjetë ditë dhe më e gjatë se 30 ditë pas përfundimit të seleksionimit administrativ.

(6) Kandidati për zbulues financiar konsiderohet se e ka kaluar provimin me shkrim nëse përgjigjet saktë në 70% të pyetjeve të dhëna gjatë zbatimit të provimit me shkrim i cili zgjat një orë. Komisioni për seleksionim përgatit listë të kandidatëve të cilët e kanë kaluar provimin me shkrim dhe e publikon në faqen e internetit të Drejtorisë.

(7) Në afat prej pesë ditësh pas përfundimit të provimit me shkrim, ndërsa në bazë të rezultateve nga provimi me shkrim, Komisioni për seleksionim zbaton intervistë me pesë kandidatët më të suksesshëm të cilët e kanë kaluar provimin. Me përjashtim, intervistë zbatohet edhe me kandidatët të cilët kanë rezultat të njëjtë si të kandidatit të pestë në listë.

(8) Intervista duhet të përmbajë pyetje të situatës nga sfera e parandalimit të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit me të cilat vlerësohen potenciali dhe integriteti i personalitetit të kandidatit për zbulues financiar.

(9) Në afat prej tri ditësh pas përfundimit të intervistës, në bazë të rezultateve nga provimi i zbatuar me shkrim dhe intervista, Komisioni për seleksionim përpilon rang-listë të tre kandidatëve më të suksesshëm dhe e dorëzon te drejtori i Drejtorisë.

(10) Drejtori i Drejtorisë në afat prej tri ditësh pas marrjes së rang-listës nga paragrafi (9) i këtij neni miraton vendim për zgjedhje të kandidatit.

(11) Drejtoria në afat prej tri ditësh pas zgjedhjes së kryer, i njofton me shkrim kandidatët për zgjedhjen e kryer.

(12) Nëse drejtori i Drejtorisë në afatin nga paragrafi

(10) i këtij neni, nuk bën zgjedhjen e kandidatit, procedura e re për punësimin e zbuluesit financiar në vendin e njëjtë të punës nuk mund të zbatohet para kalimit të gjashtë muajve nga dita e shpalljes së konkursit publik.

(13) Kundër vendimit për zgjedhje nga paragrafi (10) i këtij neni kandidati i pakënaqur ka të drejtë për ankesë te komisioni për ankesa të Komisionit shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë, në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit me shkrim për kandidatit e zgjedhur.

(14) Ankesa e prolongon zbatimin e vendimit.

(15) Pas përfundimit të procedurës për zgjedhje, drejtori i Drejtorisë pa prolongim miraton

aktvendim për punësimin e zbuluesit financiar.

Neni 78

Në Drejtori mund të punësohet person me marrje, pa shpallje të konkursit për vendin e punës, prej njërit në organin tjetër shtetëror me pëlqim të tij, në vendin e punës që korrespondon me përgatitjen e tij profesionale, përkatësisht kualifikimet dhe kushtet e përcaktuara me aktin për sistematizim, kur këtë e imponon nevoja e Drejtorisë, me pëlqim të marrë paraprakisht nga ministri i Financave.

Pushimi i marrëdhënies së punës të zbuluesit financiar

Neni 79

(1) Zbuluesit financiar marrëdhënia e punës i pushon, nëse:

- a) vetë e kërkon atë;
- b) në mënyrë të përhershme e humb aftësinë shëndetësore për kryerjen e detyrave në Drejtorinë si pasojë e sëmundjes ose zvogëlimit të kapaciteteve fizike ose mentale;
- c) nëse përcaktohet se gjatë punësimit ka heshtur ose ka dhënë të dhëna të pavërteta në lidhje me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për punësim me ditën e përfundimit të aktvendimit ose me kalimin e afatit për vendimmarrje sipas ankesës kundër aktvendimit;
- ç) i është shqiptuar masë disiplinore pushim i marrëdhënies së punës me ditën e dorëzimit të aktvendimit përfundimtar;
- d) për shkak të vuajtjes së dënimit me burg patjetër duhet të mungojë nga puna më gjatë se gjashtë muaj – me ditën e dërgimit në vuajtjen e dënimit;
- dh) i plotëson kushtet për pension në pajtim me ligj dhe
- e) vlerësohet me notën “pamjaftueshëm” tri herë në mënyrë të njëpasnjëshme në pesë vitet e fundit së paku tri herë.

(2) Për pushimin e marrëdhënies së punës vendos ministri i Financave.

Të drejta dhe obligime të zbuluesit financiar

Neni 80

(1) Zbuluesit financiar e kanë për obligim:

- a) detyrat e punës t'i kryejnë me vetëdije, në mënyrë profesionale, efikase, me rregull dhe në kohë në pajtim me Kushtetutë, ligj dhe rregulla tjera;
- b) t'i zbatojnë urdhrat e udhëheqësit epror të drejtpërdrejtë dhe të veprojnë sipas tyre në pajtim me Kushtetutë, ligj dhe rregull tjetër;
- v) ta respektojnë kohën e caktuar të punës dhe
- g) pajisjen që u është dhënë për shfrytëzim për kryerjen e detyrave të tyre ta përdorin me kujdes të detyrueshëm dhe si nikoqir i mirë në pajtim me dedikimin e saj dhe të njëjtën të mos e shfrytëzojnë për qëllime private.

(2) Zbuluesi financiar përveç obligimeve nga paragrafi

(1) i këtij neni i ka edhe obligimet në vijim:

- a) ta kryejë punën e vet në mënyrë të paanshme dhe pa ndikim nga partitë politike, të mos udhëhiqet nga bindjet e veta politike, nga interesat financiare personale, të mos i keqpërdor autorizimet dhe statusin dhe ta mbrojë dinjitetin e Drejtorisë;
- b) në mënyrë profesionale ta përsosë diturin e vet për shkak të avancimit të kërkesave profesionale me respektimin dhe zbatimin e vazhdueshëm të rregullave për kryerjen e detyrave të veta zyrtare;
- v) të sillet në pajtim me Kodeksin e sjelljes të të punësuarve në Drejtorinë;
- g) t'i respektojë të gjitha masat e sigurisë që të mos vjen deri te rrezikimi i jetës dhe shëndetit të tij, si dhe jetës dhe shëndetit të të punësuarve tjerë në Drejtorinë dhe
- d) të mos shfrytëzojë privilegje dhe lirime, kërkesë ose pranim të dobisë materiale ose dobisë tjetër gjatë plotësimit të obligimeve të veta zyrtare.

(3) Zbuluesit financiarë janë të detyruar të menaxhojnë dhe t'i ruajnë informatat e klasifikuara në pajtim me rregullat për informata të klasifikuara.

(4) Zbuluesit financiarë janë të detyruar t'i mbledhin, përpunojnë dhe ruajnë të dhënat personale në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale.

(5) Zbuluesit financiarë për mosrespektimin e obligimeve të përcaktuara me paragrafët (1), (2), (3) dhe

(4) të këtij neni i nënshtrohen përgjegjësisë disiplinore, kundërvajtëse dhe penale në pajtim me ligj.

Neni 81

(1) Drejtorja, planifikon, organizon dhe zbaton trajnime për të punësuarit.

(2) Me të punësuarin i cili dërgohet në trajnim vlera e të cilit tejkalon dhjetë rroga mesatare të paguara në Republikën e Maqedonisë muajin e fundit para dërgimit, Drejtoria lidh marrëveshje në formë të shkruar me të cilën rregullohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

(3) I punësuar i cili nuk do t'i plotësojë obligimet nga marrëdhënia e lidhur nga paragrafi (2) i këtij neni është i detyruar t'i kompensojë shpenzimet e bëra për trajnimin e tij të zmadhuara për tre herë.

Neni 82

(1) Zbuluesit financiarë kanë të drejtë për rroga, kompensime të rrogës dhe kompensime tjera të cilat sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

(2) Zbuluesi financiar, për shkak të specifikave të punëve të cilat i kryen, ka të drejtë për rrogë të rritur për 20% nga baza e përcaktuar me aktin për pagimin e rrogës dhe kompensimeve.

(3) Zbuluesit financiar në rast të paaftësisë të përkohshme për punë, të krijuar gjatë kryerjes ose me rastin e kryerjes së punëve dhe detyrave, i takon kompensim në lartësi të rrogës rrjedhëse gjatë kohës së mungesës nga puna.

(4) Zbuluesit financiar në pajtim me dispozitat për sigurim pensional dhe invalidor, stazhi i sigurimit i llogaritet me kohëzgjatje të rritur, kështu që kufiri i pleqërisë për arritjen e të drejtës së pensionit të pleqërisë zvogëlohet varësisht nga shkalla e rritjes së stazhit edhe atë për një vit për çdo katër vjet të kaluara në vende të punës në të cilat në mënyrë efektive 12 muaj të kaluar llogariten në stazhin e sigurimit si 15 muaj.

(5) Drejtoria i siguron zbuluesit financiarë në rast të vdekjes, dëmtimit trupor ose humbjes së aftësisë për punë gjatë kryerjes së punëve në kompetencë të tyre.

Neni 83

Zbuluesit financiarë gjatë kryerjes së autorizimeve të veta kanë të drejta të posaçme të hyjnë dhe të kenë kalim të lirë në stacionet, aeroportet, portet dhe parkingjet publike vetëm duke treguar legjitimacionin zyrtar.

Neni 84

(1) Zbuluesi financiar, në varësi të rezultateve të arritura të jashtëzakonshme dhe mbi mesataren në punë, njohuritë profesionale dhe aftësitë në punë, angazhimin, kreativitetin dhe ndërgjegjen gjatë kryerjes së detyrave zyrtare mund të avancohet në një pozitë më të lartë pune me vendim të drejtorit dhe me pëlqimin paraprak të ministrit të Financave.

(2) Zbuluesi financiar mund të avancohet nëse i plotëson kushtet e mëposhtme:

- vendi i punës në të cilin avancohet është i lirë (i paplotësuar ose i liruuar),
- në tërësi i plotëson kushtet e përcaktuara në aktin për sistematizimin e vendeve të punës për vendin e punës ku kryhet avancimi,
- i ka kryer trajnimet e përcaktuara për vendin e punës për të cilin avancohet,
- është vlerësuar me vlerësime "mjaftueshëm" ose "dallohet" në mënyrën dhe në kushtet e përcaktuara me këtë ligj,
- ka kaluar të paktën një vit që nga avancimi i tij i fundit dhe
- nuk është dënuar në 12 muajt e fundit për shkak të shkeljes së rendit të punës dhe disiplinës ose mosplotësimin e detyrave të punës të përcaktuara me ligj.

Neni 85

(1) Zbuluesit financiarë gjatë punës së tyre do të vlerësohen një herë në vit nga zbuluesi financiar eprior i drejtpërdrejt udhëheqës. Në rast të mungesës së zbuluesit financiar eprior i drejtpërdrejtë udhëheqës, vlerësimi kryhet nga zbuluesi i lartë financiar eprior i drejtpërdrejtë udhëheqës. Në rast të mungesës së zbuluesit financiar eprior i drejtpërdrejtë udhëheqës në pajtim me aktin për sistematizim, vlerësimin e kryen drejtori i Drejtorisë.

(2) Zbuluesit financiarë të cilët kanë arsyetuar mungesën në punë për më shumë se gjashtë muaj gjatë vitit (pushim mjekësor, pushim pa pagesë etj.) nuk do të vlerësohen.

(3) Vlerësimi i zbuluesve financiarë kryhet në bazë të të dhënave që lidhen me kriteret në vijim:

- njohuri profesionale dhe aftësi në punë,
- angazhimi,
- rezultatet e arritura,
- kreativiteti dhe
- ndërgjegjshmëria.

(4) Kriteret nga paragrafi (3) i këtij neni vlerësohen në mënyrë individuale, të numëruara me notë prej një deri në katër dhe me përshkrim, me vlerësimet përshkruese të mëposhtme "dallohet", "mjaftueshëm", "pjesërisht mjaftueshëm" dhe "pamjaftueshëm".

(5) Zbuluesi financiar që nuk është i kënaqur me notën, brenda tetë ditësh nga dita e vlerësimit, mund të paraqesë kërkesë për rivlerësim të vlerësimit në Komision për Rishqyrtimin e Vlerësimit, të cilin e formon drejtori.

(6) Zbuluesi financiar, i cili nuk është i kënaqur me vendimin e Komisionit për Rishqyrtimin e Vlerësimit në afat prej tetë ditëve nga dita e dorëzimit të vendimit ka të drejtë të paraqesë ankesë përmes Drejtorisë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurën Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie Pune në Shkallë të Dytë.

(7) Mënyrën e vlerësimit të punës së zbuluesve financiarë, llojet e raporteve, formën dhe përmbajtjen e formularit për vlerësim dhe formularëve tjerë i përcakton ministri i Financave me propozim të drejtorit.

Neni 86

(1) Kodi i sjelljes i përcakton standardet e sjelljes që duhet të respektohen nga të gjithë të punësuarit dhe ofron udhëzime për zgjidhjen e çështjeve etike për ata që punojnë në Drejtori dhe atyre që bashkëpunojnë dhe punojnë me të punësuarit e Drejtorisë.

(2) Kodin e sjelljes e përcakton ministri i Financave me propozim të drejtorit.

Neni 87

(1) Për shkelje të rendit të punës dhe disiplinës ose mosplotësimit të detyrimeve të punës, zbuluesi financiar përgjigjet në mënyrë disiplinore.

(2) Përgjegjësia për kryerjen e veprës penale nuk e përjashton përgjegjësinë disiplinore të zbuluesit financiar.

Neni 88

(1) Zbuluesi financiar përgjigjet në mënyrë disiplinore për parregullsinë disiplinore dhe shkeljen disiplinore.

(2) Parregullsi disiplinore, në kuptim të paragrafit (1) të këtij neni, është një shkelje më e lehtë e disiplinës së punës, detyrave të punës, reputacionit të Drejtorisë dhe të punësuarve.

(3) Shkelje disiplinore, sipas paragrafit (1) të këtij neni, është shkelje më e rëndë e disiplinës së punës, detyrave të punës, reputacionit të Drejtorisë dhe të punësuarve.

Neni 89

(1) Zbuluesi financiar kryen parregullsi disiplinore, ose shkelje më të lehtë të disiplinës së punës, detyrave të punës, reputacionit të Drejtorisë dhe të punësuarve, nëse:

- 1) nuk e respekton rendin e punës dhe disiplinën;
- 2) nuk kryen ose neglizhon dhe nuk kryen në kohë detyrat e punës;
- 3) nuk u përmbahet rregullave që vlejnë për kryerjen e punëve në vendin e punës;
- 4) nuk i përmbahet orarit të caktuar të punës, orarit dhe shfrytëzimit të orarit të punës;
- 5) nuk kërkon leje ose nuk e njofton në kohë drejtorin, respektivisht udhëheqësin e drejtpërdrejtë ose punonjësin tjetër përgjegjës për mungesën në punë;
- 6) për shkak të sëmundjes ose shkaqeve të arsyeshme mungon nga puna dhe nëse nuk e informon menjëherë drejtorin respektivisht udhëheqësin e drejtpërdrejtë ose punëtorin tjetër përgjegjës më së voni në afat prej 24 orësh;
- 7) me mjetet e punës nuk vepron në mënyrë të ndërgjegjshme ose në pajtim me udhëzimet teknike për punë;
- 8) shkaktohet dëm, gabim në punë ose humbje dhe për këtë nuk e njofton menjëherë drejtorin, respektivisht udhëheqësin e njësisë organizative ose punonjësin tjetër përgjegjës;
- 9) nuk i mban mjetet dhe pajisjen për mbrojtje gjatë punës në pajtim me rregullat për mbrojtje në punë;
- 10) shkakton parregullsi dhe në mënyrë të dhunshme sillet gjatë punës;
- 11) në mënyrë të paligjshme dhe të paautorizuar i shfrytëzon mjetet e Drejtorisë dhe
- 12) shmang trajnimin.

Neni 90

(1) Zbuluesi financiar kryen parregullsi disiplinore, ose shkelje më të rëndë të disiplinës së punës, detyrave të punës, autoritetit të Drejtorisë dhe të punësuarve, nëse:

- 1) pa arsye mungon nga puna për tri ditë pune të njëpasnjëshme ose pesë ditë pune gjatë një viti;
- 2) e keqpërdor pushimin mjekësor;
- 3) nuk u përmbahet rregullave për mbrojtje shëndetësore, mbrojtjen në punë, nga zjarri, shpërthimi, veprimet e dëmshme të helmeve dhe materieve të tjera të rrezikshme dhe i shkel rregullat për mbrojtjen e mjedisit jetësor;

- 4) fut, përdor ose është nën ndikimin e alkoolit dhe narkotikëve;
- 5) kryen vjedhje ose në lidhje me punën me qëllim ose nga pakujdesia e plotë ka shkaktuar dëme në Drejtori;
- 6) nuk u përmbahet dispozitave të Ligjit për enformatat e klasifikuara;
- 7) kryen keqpërdorim të të dhënave personale;
- 8) keqtrajton ose tejkalon detyrimet ligjore dhe autorizimin;
- 9) shmang kontrollin mjekësor në mënyrë që të përcaktohet aftësia e punës;
- 10) fiton në mënyrë të paligjshme përfitime personale në lidhje me kryerjen e punëve dhe detyrave;
- 11) kryen shërbime ose ofron shërbim për një person tjetër me para ose me gjëra tjera me vlerë që i janë besuar zbuluesit financiar gjatë kryerjes së punëve dhe detyrave dhe
- 12) themelon, menaxhon, përfaqëson, paraqet parti politike, është anëtar në organet e partisë të përcaktuara me statutin e saj, përpilon dhe përfaqëson qëndrime dhe bindje partiake në kryerjen e punëve dhe detyrave, mban ose thekson simbole të partisë në lokalet ose në automjetet zyrtare të Drejtorisë dhe në mënyrë partiake organizohet ose vepron në Drejtori.

Neni 91

(1) Në rast të parregullsisë financiare zbuluesit financiar mund t'i shqiptohet me aktvendim një nga masat disiplinore në vijim:

- 1) paralajmërim me shkrim ose
- 2) dënim me para në lartësi prej 15% të pagës së fundit mujore neto të paguar zbuluesit financiar në kohëzgjatje prej një deri në tre muaj.

(2) Në rast të shkeljes disiplinore zbuluesit financiar me aktvendim mund t'i shqiptohet një nga masat disiplinore në vijim:

- 1) gjobë në para në lartësi prej 15% të rrogës së fundit mujore neto të paguar zbuluesit financiar, në kohëzgjatje prej tre deri më gjashtë muaj;
- 2) përcaktimi i vendit të punës që në përputhje me hierarkinë e vendeve të punës të përcaktuara në aktin për sistematizimin e vendeve të punës në Drejtori është një shkallë më e ulët se vendi i punës nga i cili është sistemuar zbuluesi financiar ose
- 3) prishje të marrëveshjes për punësim.

(3) Gjatë shqiptimit të masave disiplinore nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, merren parasysh shkalla e përgjegjësisë, kushtet në të cilat është kryer shkelja e disiplinës së punës, detyrat e punës, autoriteti i Drejtorisë dhe i të punësuarve, puna e mëparshme dhe sjellja e të punësuarit, pesha e shkeljes dhe pasojat e saj, rrethanat në të cilat është kryer shkelja dhe rrethana të tjera lehtësuese dhe vështirësuese.

Neni 92

Shuma e gjobave në para të zbuluesit financiar në një muaj për shkeljen e disiplinës së punës, detyrave të punës, autoritetit të Drejtorisë dhe të të punësuarve nuk mund të kalojë 20% të shumës së pagës së tij të përgjithshme neto për atë muaj.

Neni 93

(1) Masat disiplinore kundër zbuluesit financiar për parregullsi disiplinore shqiptohen me propozim të zbuluesit financiar udhëheqës i drejtpërdrejtë, zbuluesit të lartë financiar ose zbuluesit financiar udhëheqës në të njëjtin nivel, që njëkohësisht i dorëzohet drejtorit dhe zbuluesit financiar kundër të cilit paraqitet propozimi.

(2) Zbuluesi financiar kundrejt të cilit është paraqitur propozimi ka të drejtë brenda tri ditëve nga dita e pranimi të propozimit nga paragrafi (1) i këtij neni të prononcohet për propozimin, përkatësisht të japë përgjigje me shkrim.

(3) Masat disiplinore kundër zbuluesit financiar për parregullsi disiplinore do të shqiptohen nga drejtori brenda tetë ditëve nga dita e pranimi të përgjigjes me shkrim nga paragrafi (2) i këtij neni.

(4) Kundër vendimit nga paragrafi (3) i këtij neni, zbuluesi financiar i pakënaqur, ka të drejtë të paraqesë ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurat për Marrëdhënie Pune në Shkallë të Dytë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimi të vendimit.

Neni 94

Propozim për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të zbuluesit financiar për shkelje disiplinore mund të paraqitet nga zbuluesi financiar udhëheqës i drejtpërdrejtë, zbuluesi i lartë financiar udhëheqës ose zbuluesi financiar udhëheqës në të njëjtin nivel. Propozimi duhet të arsyetohet dhe të mbështetet me fakte dhe prova.

Neni 95

(1) Me qëllim të kryerjes së procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të zbuluesit

financiar për shkelje disiplinore në rastet e përcaktuara me këtë ligj, drejtori brenda tetë ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës për ngritjen e procedurës disiplinore formon komision për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore.

(2) Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni përbëhet nga zbulues financiarë edhe atë kryetar nga radhët e zbuluesve financiarë udhëheqës dhe dy anëtarë njëri prej të cilëve, nëse është e mundur, të jetë zbulues financiar me të njëjtin titull si zbuluesi financiar kundër të cilit mbahet procedura disiplinore. Kryetari dhe anëtarët kanë zëvendësit e tyre.

(3) Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore e mban në pajtim me këtë ligj.

(4) Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni, pas kryerjes së procedurës disiplinore, nëse përcakton se zbuluesi financiar është përgjegjës, i propozon drejtorit të parashtrijë masë përkatëse disiplinore.

(5) Nëse komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni përcakton që zbuluesi financiar nuk është përgjegjës, i propozon drejtorit ta hedhë poshtë propozimin ose ta ndërpresë procedurën.

(6) Drejtori, në bazë të propozimit të komisionit, miraton aktvendimin për shqiptimin e masës disiplinore, refuzimin e propozimit ose ndalimin e procedurës brenda tri ditëve nga pranimi i propozimit nga paragrafi (5) i këtij neni. Vendimi për shqiptimin e masës disiplinore përmban edhe arsyetim për bazën dhe arsyet për shqiptimin e masës disiplinore.

(7) Aktvendimi për shqiptimin e masës disiplinore i dorëzohet personalisht zbuluesit financiar, sipas rregullit, në lokalet e punës të Drejtorisë, përkatësisht në adresë të vendbanimit, respektivisht vendqëndrimit.

(8) Nëse zbuluesi financiar refuzon dorëzimin, aktvendimi publikohet në tabelën e njoftimeve në Drejtori. Pas skadimit të tri ditëve të punës nga data e publikimit në tabelën e njoftimeve konsiderohet se dorëzimi është kryer.

(9) Kundër aktvendimit për shqiptimin e masës disiplinore ose refuzimit të propozimit, respektivisht për ndërprerjen e procedurës, zbuluesi financiar ka të drejtë të ankohet nëpërmjet Drejtorisë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurën Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie Pune në Shkallë të Dytë, brenda tetë ditëve nga dita e dorëzimit të vendimit.

(10) Ankesa e prolongon përmbardimin e aktvendimit deri në miratimin e vendimit përfundimtar ose kalimin e afatit brenda të cilit është dashur të vendosë Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie Pune në Shkallë të Dytë. Drejtoria obligohet që ankesën, me shkresat shoqëruese ta dorëzojë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurën Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie Pune në Shkallë të Dytë, brenda tetë ditëve nga pranimi i ankesës.

(11) Procedura disiplinore përfundon në afat prej 60 ditëve llogaritur nga dita e miratimit të aktvendimit për formimin e komisionit nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 96

(1) Deri në miratimin e aktvendimit në procedurë disiplinore që mbahet kundër zbuluesit financiar, zbuluesi financiar me vendim-aktvendim me shkrim largohet nga vendi i punës dhe nga Drejtoria në rastet e përcaktuara me rregullat për marrëdhëniet e punës, nëse ndodh një nga situatat në vijim:

- rrezikon drejtpërsëdrejti jetën ose shëndetin e punëtorëve ose të personave të tjerë ose dëmton mjetet me vlera më të larta,

- prania e vendit të punës dhe puna e mëtejshme do të reflektohet në mënyrë të dëmshme mbi punën e Drejtorisë dhe

- kur kundër zbuluesit financiar është ngritur procedurë kundërvajtëse për vepër penale të kryer në punë ose në lidhje me punën.

(2) Gjatë largimit nga vendi i punës dhe nga Drejtoria, zbuluesit financiar i përcaktohet dhe paguhet kompensim në lartësi prej 60% të shumës së pagës neto që zbuluesi financiar e ka realizuar në muajin para largimit nga vendi i punës.

(3) Aktvendimi nga paragrafi (1) i këtij neni miratohet nga drejtori.

(4) Aktvendimi nga paragrafi (1) i këtij neni i dorëzohet personalisht zbuluesit financiar, si rregull, në lokalet e punës të Drejtorisë, përkatësisht në adresë të vendbanimit, respektivisht vendbanimit.

(5) Nëse zbuluesi financiar e refuzon dorëzimin, aktvendimi publikohet në tabelën e njoftimeve në Drejtori. Pas kalimit të tri ditëve të punës nga dita e publikimit në tabelën e njoftimeve konsiderohet se dorëzimi është kryer.

(6) Zbuluesi financiar ka të drejtë për ankesë kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie Pune në Shkallë të Dytë, në afat prej tetë ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit.

(7) Ankesa kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni nuk e prolongon përmbarimin e vendimit.

(8) Në rast të kthimit në punë dhe nëse nuk është krijuar ndonjë përgjegjësi disiplinore, zbuluesit financiar i takon kompensim në mënyrë retroaktive deri 100% të pagës neto.

Neni 97

Nëse zbuluesit financiarë për shkak të shkeljes disiplinore i shqiptohet masa ndërprerje e kontratës së punës, zbuluesi financiar ka të drejtë për afat të dorëheqjes në kohëzgjatje prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit për ndërprerjen e kontratës së punës.

Neni 98

Gjatë periudhës së afatit të dorëheqjes Drejtoria është e detyruar t'i mundësojë zbuluesit financiar mungesë nga puna me qëllim të kërkimit të punësimit të ri, gjashtë orë gjatë javës së punës.

Neni 99

Gjatë periudhës së afatit të dorëheqjes dhe mungesës nga puna me qëllim të kërkimit të një punësimi të ri, zbuluesit financiar i përcaktohet dhe i paguhet kompensim në lartësi të pagës që zbuluesi financiar e ka realizuar muajin para miratimit të aktvendimit për ndërprerjen e marrëveshjes për punësim.

Neni 100

(1) Procedura disiplinore kundër zbuluesit financiar nuk mund të ngrihet nëse ka kaluar një muaj nga dita kur zbuluesi financiar epror i drejtpërdrejt ose drejtori kanë kuptuar për shkeljen e kryer disiplinore.

(2) Procedura disiplinore kundër zbuluesit financiar nuk mund të ngrihet nëse kanë kaluar tre muaj nga dita e shkeljes së kryer disiplinore.

(3) Kur për një shkelje të kryer disiplinore është ngritur edhe procedurë penale për zbuluesin financiar, vendimi për shqiptimin e masës disiplinore do të miratohet më së voni deri në kalimin e afatit për vjetërsim për ndjekjen penale të veprës penale përkatëse.

Neni 101

(1) Zbuluesi financiar është përgjegjës për dëmin që në punë ose në lidhje me punën, me qëllim ose pakujdesi të skajshme, ia ka shkaktuar Drejtorisë.

(2) Drejtori formon komision për përcaktimin e përgjegjësisë materiale të zbuluesit financiar të përbërë nga zbuluesit financiarë të punësuar në Drejtorin dhe atë kryetari nga radhët e zbuluesve financiarë udhëheqës dhe dy anëtarë, nga të cilët nëse është e mundur, njëri të jetë zbulues financiar me të njëjtin titull si zbulues financiar kundër të cilit mbahet procedurë disiplinore. Kryetari dhe anëtarët i kanë zëvendësit e tyre.

(3) Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni e përcakton përgjegjësinë materiale për ekzistimin e dëmit material të bërë, shumën dhe mënyrën e kryerjes së tij, kush e ka shkaktuar dëmin dhe kush do ta kompensojë.

(4) Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni gjendjen faktike të përcaktuar paraqet raport në bazë të të cilit drejtori miraton aktvendimin për kompensimin e dëmit.

Neni 102

Propozim për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë materiale kundër zbuluesit financiar, parashtron zbuluesi financiar udhëheqës i drejtëpërdrejtë, zbuluesi financiar udhëheqës më i lartë zbulues financiar ose zbuluesi financiar udhëheqës i të njëjtit nivel.

Neni 103

Procedura për përcaktimin e përgjegjësisë materiale nuk mund të ngritet nëse kanë kaluar 60 ditë nga dita kur zbuluesi financiar zbuluesi financiar udhëheqës i drejtëpërdrejtë ose zbuluesi financiar udhëheqës më i lartë ka kuptuar për këtë.

Neni 104

Procedura për përcaktimin e përgjegjësisë materiale nuk mund të ngritet nëse nga dita kur është bërë dënimi material ka kaluar një vit.

Neni 105

Procedura për përcaktimin e përgjegjësisë materiale nuk mund të mbahet për më gjatë se 60 ditë, duke llogaritur nga dita e miratimit të aktvendimit për formimin e komisionit për përcaktimin e përgjegjësisë materiale të zbuluesit financiar.

Neni 106

(1) Kundër aktvendimit për kompensim të dëmit zbuluesi financiar ka të drejtë të paraqesë ankesë në Komisionin shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë nga marrëdhënia e punës në shkallë të dytë përmes Drejtorisë, në afat prej tetë ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit.

(2) Ankesa e prolongon ekzekutimin e aktvendimit deri në miratimin e vendimit përfundimtar ose skadimin e afatit në të cilin duhej të vendosë Komisioni shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë nga marrëdhënia e punës në shkallë të dytë.

Neni 107

Procedura për përcaktimin e përgjegjësisë materiale të zbuluesit financiar rregullohet me vendim që e miraton drejtori.

Neni 108

Nëse zbuluesi financiar në afat prej tre muajsh nga përfundimi i aktvendimit për kompensimin e dëmit nuk e kompenson dëmin, Drejtoria ngrit procedurë para gjykatës kompetente.

Neni 109

Drejtori mund ta lirojë plotësisht ose pjesërisht zbuluesin financiar nga kompensimi për dëmin, nëse ai nuk është kryer me dashje ose nëse me pagesë të kompensimit të dëmit rrezikohet ekzistenca e zbuluesit financiar dhe familjes së tij.

Neni 110

(1) Për punë shumëvjeçare profesionale, avancime organizative, sukses në kryerjen e detyrave punuese, përmirësimin e reputacionit të shërbimit, zbuluesve financiarë u jepen mirënjohje.

(2) Zbuluesit financiar mund të marrin edhe shumë të njëhershme të shpërblimit në para për arritje të rezultateve mbi mesataren, të jashtëzakonshme në punë.

(3) Mirënjohjet dhe shpërblime nga paragrafët (1) dhe të këtij neni, sipas rregullës, jepen në ditën e Drejtorisë.

(4) Për ndarjen e mirënjohjes dhe shpërblimeve në para vendos ministri i Financave me propozim të drejtorit.

(5) Dita e Drejtorisë është me 1 mars.

Neni 111

(1) Të punësuarit në Drejtori që kryejnë punë nga natyra administrative kanë status të nëpunësve administrativë.

(2) Për të punësuarit nga paragrafi (1) i këtij neni kategoritë, nivelet dhe titujt përcaktohen në pajtim me Ligjin për nëpunës administrativë.

(3) Për çështje që kanë të bëjnë me klasifikimin, evidencën, punësimin, përparimin, përsosjen dhe aftësimin profesional, matjen e efektit dhe çështje tjera në lidhje me marrëdhënien e punës të nëpunësve administrativë zbatohen dispozitat nga Ligji për nëpunës administrativë.

(4) Të punësuarit në Drejtori, që kryejnë punë ndihmëse-teknike kanë status të personelit ndihmës-teknik.

(5) Për çështjet që kanë të bëjnë me klasifikimin, evidencën, punësimin dhe çështje tjera në lidhje me marrëdhënien e punës, të të punësuarve nga paragrafi (4) të këtij neni, zbatohen dispozitat e këtij ligji, Ligjit për të punësuarit në sektorin publik dhe rregullat e përgjithshme për marrëdhënie pune.

Analiza e të dhënave, informata dhe dokumentacioni

Neni 112

Drejtorja është kompetente të mbledhë dhe kryejë analizë në bazë të llojeve në vijim të të dhënave, informacioneve dhe dokumentacionit:

1. për dyshimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të dorëzuar nga subjektet në bazë të nenit 54 të këtij ligji,

2. të dorëzuar nga subjektet në bazë të neneve 52 dhe 53 të këtij ligji,

3. iniciativë të organeve kompetente në pajtim me nenin 117 të këtij ligji

4. të dorëzuar nga Drejtoria Doganore në bazë të nenit 126 të këtij ligji,

5. të marra gjatë kryerjes së mbikëqyrjes në pajtim me këtë ligj dhe

6. të marra nga njësitë e zbulimit financiar të shteteve tjera

Analiza dhe përpunimi i të dhënave, informatave dhe dokumentacionit

Neni 113

Të dhënat, informatat dhe dokumentacioni që i grumbullon Drejtoria në përputhje me këtë ligj i analizon në suazat e:

- a) analizës operative që ka të bëjë me personat, transaksionet, aktivitetet, pronën të përfshira me të dhëna, informata dhe dokumentacioni nga neni 115 i këtij ligji,
- b) analizës strategjike që ka të bëjë me përcaktimin e trendeve dhe tipologjive për pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit.

Neni 114

(1) Të dhënat, informatat dhe dokumentacioni që i grumbullon, analizon, përpunon dhe dorëzon Drejtoria në pajtim me këtë ligj janë të klasifikuara për të cilat është përcaktuar shkallë përkatëse e klasifikimit në përputhje me rregullat për të dhënat e klasifikuara.

(2) Të dhënat, informatat dhe dokumentacioni që i grumbullon, analizon, përpunon dhe dorëzon Drejtoria shfrytëzohen në pajtim me këtë ligj.

Kërkesa e të dhënave, informacioneve dhe dokumentacionit nga ana e Drejtorisë

Neni 115

(1) Për kryerje të kompetencave të veta, Drejtoria mundet të kërkojë të dhëna, informata dhe dokumentacion nga organet shtetërore, subjektet ose nga persona tjerë juridikë ose fizikë në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) Organet shtetërore, subjektet ose personat tjerë juridikë dhe fizikë janë të detyruar më së voni në afat prej dhjetë ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni t'i dorëzojnë në Drejtori të dhënat e kërkuara në formë elektronike të mbrojtur. Nëse mënyra e këtillë e dorëzimit është e pamundur nga arsye teknike, të dhënat e kërkuara dorëzohen në formë të shkruar.

(3) Nëse Drejtoria urgjentisht kërkon të dhëna, organet shtetërore, subjektet ose personat tjerë juridikë dhe fizikë janë të detyruar më së voni në afat prej katër orësh t'i dorëzojnë të dhënat e kërkuara në formë elektronike të mbrojtur. Nëse mënyra e këtillë e dorëzimit është e pamundur nga arsye teknike, të dhënat e kërkuara dorëzohen në formë të shkruar.

Qasja elektronike të të dhënave, informatat dhe dokumentacioni nga ana e Drejtorisë

Neni 116

(1) Për kryerjen e kompetencave të përcaktuara me këtë ligj Drejtoria ka qasje elektronike dhe shfrytëzon të dhëna nga baza e të dhënave, pa kompensim, dhe atë nga:

- I. Ministria e Punëve të Brendshme:
- të dhënat nga evidencat e numrit amë,
 - të dhënat nga regjistri i shtetasve të Republikës së Maqedonisë,
 - të dhënat nga evidenca e shtetasve të Republikës së Maqedonisë që kanë marrë shtetësi të Republikës së Maqedonisë, përkatësisht të cilëve u ka pushuar shtetësia e Republikës së Maqedonisë,
 - të dhënat nga regjistri i letërnjoftimeve të lëshuara,
 - të dhënat nga regjistri i pasaportave të shtetasve të Republikës së Maqedonisë,
 - të dhënat nga regjistri, kartoteka dhe regjistri alfabetik i qytetarëve që kanë paraqitur shkuarjen jashtë vndit,
 - të dhënat nga regjistri i të zhdukurve, të humburve dhe dokumente udhëtimi të gabuara,
 - të dhënat nga evidenca e numrit amë të huajt,
 - të dhënat nga evidentëra e letërnjoftimeve të lëshuara për të huajt,
 - të dhëna nga evidenca për hyrje dhe dalje nga shteti,
 - të dhënat për evidencë penale,
 - të dhëna nga evidenca e lejeve të lëshuara për armë,
 - të dhëna nga evidenca e lejeve të lëshuara për bartjen e armëve,
 - të dhënat nga evidentimi miratimit të lejeve për furnizim të armëve koleksionuese,
 - të dhënat nga evidenca e kërkesave të parashtruarave për regjistrimin e armëve koleksionuese,
 - të dhëna nga evidenca e lejeve për armë koleksionuese,
 - të dhënat nga evidenca e koleksionistëve,
 - të dhënat nga evidenca e armëve dhe municionit të konfiskuar, të gjetur dhe të dorëzuar,
 - të dhënat nga evidenca e lejeve të lëshuara për qarkullim të armëve/municionit dhe pjesëve të armëve,

- të dhënat nga evidenca e detektivëve të cilëve u është lëshuar licenca për kryerjen e veprimtarisë detektiv,
 - të dhënat nga evidenca për automjetet e regjistruara motorike të regjistruara (lista e automjeteve në pronësi të personit fizik dhe juridik, lista e pronarëve të mjeteve motorike)
 - të dhënat nga evidenca për mjetet e regjistruara lundruese,
 - të dhënat nga regjistri i amvisërive dhe të tjera.
 - 2. Ministria e Drejtësisë:
 - të dhënat nga evidenca për përcjelljen e rasteve të korrupsionit,
 - të dhënat nga evidenca (nga sistemi për mbajtje elektronike të lëndëve për ndihmë juridike ndërkombëtare) të lëndëve për ndihmë juridike ndërkombëtare.
 - 3. Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor:
 - të dhënat nga evidenca personat e siguruar sipas rregullave për sigurimin dhe statusin pensional dhe invalidor,
 - të dhënat e evidenës së viteve të përvojës së punës,
 - të dhënat nga evidenca për pensionistë dhe status të pensionistit.
 - 4. Fondi i Sigurimit Shëndetësor:
 - të dhënat nga evidenca për personat e siguruar sipas rregullave të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor.
 - 5. Drejtoria e të Hyrave Publike:
 - të dhënat nga evidenca për NUAQ dhe NUT,
 - të dhënat nga evidenca nga regjistri tatimor,
 - të dhënat nga evidenca mbi të hyrat nga fletëparaqitjet tatimore vjetore për personat fizikë për tatimin personal mbi të ardhurat,
 - të dhënat nga evidenca për fletëparaqitjet tatimore mujore në lidhje me TVSH,
 - të dhënat nga evidenca për kthimin e tatimit të arkëtuar më shumë ose gabimisht,
 - të dhënat nga evidenca për kthimin e TVSH,
 - të dhënat nga evidenca për kontrollat dhe hetimet të zbatuara tatimore,
 - të dhënat nga evidencat për regjistrimin e veprimtarive që kryejnë pagesë me para në dorë,
 - të dhënat nga evidenca për kontabilistët e autorizuar të personave juridikë.
 - 6. Agjencia për Punësim:
 - të dhënat për evidencë të personave të punësuar (formulari historik M1 / M2, të punësuar në firmën e caktuar,
 - të dhënat për evidencë të personave të papunësuar dhe personave tjerë që kërkojnë punë,
 - të dhënat nga evidenca shtetas të huaj dhe persona pa shtetësi të punësuar në Republikën e Maqedonisë.
 - 7. Agjencia për Ladastër të Patundshmërive:
 - të dhënat nga regjistri i njërive hapësinore
 - të dhënat nga evidenca e listave pronësore,
 - të dhënat nga regjistri i çmimeve dhe qirave,
 - të dhënat për lëvizjen e pronësisë së pronës.
 - 8. Depozitari Qëndror për Letra me Vlerë:
 - të dhënat nga regjistri i letrave me vlerë,
 - të dhënat nga regjistri i pronarëve të letrave me vlerë,
 - të dhënat nga regjistri për barazim të transaksioneve tregtare,
 - të dhënat nga regjistri për bartje jotregtare të letrave me vlerë,
 - të dhënat nga regjistri i letrave të huazuara me vlerë,
 - 9. Të dhënat nga regjistri unik i llogarive transkacionale-Shtëpi kliringu “KIBS” SHA
- Shkup:
- të dhënat nga regjistri i llogarive transkacionale.
 - 10. Të dhënat nga Byroja Kreditore:
 - të dhënat nga portali MOJ.MKB.MK.
 - 11. Regjistri Qëndror:
 - të dhënat nga regjistri tregtar dhe regjistri i personave tjerë juridikë,
 - të dhënat nga regjistri i llogarive vjetore,
 - të dhënat nga regjistër i pengut,
 - të dhënat nga regjistër për lizing,
 - të dhëna nga regjistri i investimeve në patundshmëri,
 - të dhëna nga regjistri i të drejtave mbi patundshmëri,
 - të dhënat nga regjistri i investimeve direkte të rezidentëve jashtë vendit,
 - të dhënat nga regjistri i investimeve direkte të jorezidentëve në Republikën e Maqedonisë,
 - të dhënat nga regjistri i personave fizikë dhe juridikë të cilëve u është shqiptuar sanksion ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe ndalimi i përkohshëm i kryerjes së veprimtarisë së caktuar,

- të dhënat nga regjistri i dënime dytësore për veprat e kryera penale të personave juridikë,
- të dhënat nga regjistri për sigurim me transfer të pronësisë së sendeve dhe transfer të të drejtave (regjistri fiduciar),
- të dhënat nga regjistri për shitjen e sendeve të tundshme me mbajtjen e të drejtës së pronësisë.

12. Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë:

- të dhënat nga evidenca për deklarata doganore të personit fizik,
- të dhënat nga evidenca e deklaratave doganore të personit juridik,
- të dhënat nga evidenca për importin e kryer dhe për eksportin e kryer,
- të dhënat nga regjistri i obliguesve të akcizës,
- të dhënat nga evidenca për dokumentin unik doganor,
- të dhënat nga evidenca për para dhe letrave me vlerë të futura dhe të nxjerra nga jashtë ,
- të dhënat nga evidenca për parashtrimin e kallëzimeve penale dhe procedurave për kundërvajtje .

3. Drejtoria e Policisë Financiare:

- të dhënat nga evidenca për p kallëzime penale të parashtriara.

14. Gjykata:

- të dhënat nga evidenca për udhëhiqjen e procedurave penale kundër personit të caktuar,
- të dhënat nga evidenca ndëshkuese,
- të dhënat nga evidenca për shqiptimin e ndalimit për kryerjen e veprimtarisë të personit të caktuar,

- të dhënat nga evidenca për heqjen ose për kufizimin e aftësisë afariste të personave.

15. Ministria e Drejtësisë-Drejtoria për Mbajtjen e Librave Amë

- të dhënat nga libri amë i të lindurve,
- të dhënat nga librti amë i të kurorëzuarve,
- të dhënat nga libri amë i personave të vdekur,
- të dhëna nga evidenca për prindër/ kujdestarë të personit të caktuar,
- të dhëna nga evidenca për farefisni ndërmjet personave.

16. Ministria për Punë dhe Politikë Sociale:

- të dhëna nga evidenca për persona shfrytëzues të ndihmës sociale.

17. Enti Shtetëror për Revizion

- të dhënat nga evidenca për revizionet të kryera,
- të dhënat nga sistemi elektronik për menaxhim me revizion.

18. Berza Maqedonase e Letrave me Vlerë:

- të dhënat nga evidenca të përmbajtura në MB NET,
- të dhëna nga evidenca për transaksionet e lidhura, duke përfshirë dhe bllok transaksione.

19. Prokuroria Publike e RM-së:

- të dhënat nga evidenca për fletëparaqitje të pranuar penale,
- të dhënat nga evidenca për parashtrimin e aktakuzave,
- të dhënat nga evidenca për masa për sigurimin e pronës gjatë procedurës,
- të dhënat nga evidenca për bashkëpunimin e realizuar ndërmjet prokurorëve.

20. Ministria për ekonomi

- të dhënat nga regjistri i marrëveshjeve të lidhura për koncesione.

21. Enti Shtetëror për Statistikë:

- të dhëna statistikore nga sfera: statistikat e përgjithshme dhe rajonale, statistikat e popullsisë dhe sociale, të ardhurat, konsumi dhe çmimet, ekonomia dhe financat, industria, ndërtimtaria dhe energjia, tregtia e jashtme, transporti, turizmi, tregtia dhe shërbime tjera dhe statistika shumëdimensionale.

(2) Lloji, qasja dhe mënyra e shfrytëzimit të të dhënave nga bazat e organeve nga paragrafi (1) i këtij neni rregullohet me memorandume për bashkëpunim të lidhura ndërmjet Drejtorisë dhe organit kompetent nga paragrafi (1) I këtij neni.

Dorëzimi i iniciativës te Drejtoria

Neni 117

(1) Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave - Drejtoria e Policisë Financiare, Ministria e Financave - Drejtoria Doganore, Agjencia e Zbulimit, Ministria e Mbrojtjes - Zbulimi Ushtarak, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, organet për kryerjen e mbikëqyrjes nga neni 146 mund të dorëzojnë iniciativë në Drejtori, nëse ekzistojnë arsye për dyshimi për larjen e parave dhe financim të terrorizmit.

(2) Iniciativa për kryerjen e analizës nga paragrafi (1) i këtij neni në formë të shkruar të dorëzuar në

mënyrë të sigurtë duhet të përmbajë:

1. të dhëna për personin për të cilin ka të bëjë iniciativa, dhe atë për:
 - person fizik: emrin, mbiemrin, datëlindjen, numrin e dokumentit të identitetit, vendbanimin përkatësisht vendiqëndrimin, NUAQ dhe
 - person juridik: emrin, adresëb, seinë, NUAS , NUT, dhe të dhëna tjera;
2. të dhëna për transaksionin, mjetet, aktivitetet, periudhën kohore në lidhje me të cilën ekziston dyshimi nga pika 3 të këtij paragrafi dhe
3. shkaqet e dyshimit për larjen e parave dhe/ se financimit të terrorizmit, si dhe të dhënat për llojin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale të mëparshme, të cilat përcaktohen gjatë kryerjes të kompetencave.
 - (3) Kur iniciativa nga paragrafi (1) i këtij neni nuk është arsyetuar dhe nuk përmban të dhëna nga paragrafi (2) i këtij neni, Drejtoria e kthen iniciativën e organit që e ka parashtruar për plotësim.
 - (4) Nëse në afat prej 10 ditëve iniciativa nga paragrafi (1) i këtij neni nuk është plotësuar në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni, Drejtoria e njofton me shkrim organin që e ka parashtruar se nuk mund të veprojë sipas iniciativës së tillë të dorëzuar.
 - (5) Kur Drejtoria vepron sipas iniciativës nga paragrafi (1) i këtij neni dhe përcakton se ekzistojnë baza për dyshimin e kryerjes së veprës penale larje të parave dhe/ose financim të terrorizmit ose ndonjë veprë tjetër penale, Drejtoria vepron në përputhje me nenin 118 të këtij ligji.
 - (6) Drejtoria e njofton organin nga paragrafi (1) i këtij neni për rezultatin e veprimit për iniciativën.

Dorëzimi i të dhënave tek organet kompetente

Neni 118

- (1) Çdo herë që ekzistojnë baza për dyshimin e veprës penale të kryer për larjen e parave dhe ose financim të terrorizmit, Drejtoria menjëherë përgatit dhe dorëzon raport te organet kompetente shtetërore që vendosin për veprimet e mëtejshme.
- (2) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni përmban të dhëna, informata dhe dokumente për personin dhe veprimet për të cilat ka dyshim për lidhje me larjen e parave dhe/ose financimin e terrorizmit.
- (3) Të dhënat, informataet dhe dokumentet nga paragrafi (2) i këtij neni mund të përdoren si provë në procedurën gjyqësore për veprën penale për larjen e parave dhe/ose financimit të terrorizmit.
- (4) Kur ekzistojnë baza për dyshim për kryerjen e veprës tjetër penale, përveç larjessë parave dhe financimit të terrorizmit, Drejtoria përgatit dhe dorëzon njoftim për organet kompetente shtetërore.
- (5) Organet kompetente për raportin nga paragrafi (1) të këtij neni dhe njoftimin nga paragrafi (4) i këtij neni, të marra nga Drejtoria, janë të detyruara që rregullisht e së paku në gjashtë muaj ta informojnë Drejtorinë për rezultatet dhe përfundimin e të njëjtëve.

Urdhëresë për përcjellje të marrëdhënies afariste

Neni 119

- (1) Kur ekziston dyshimi për larjen e parave dhe/ose financim të terrorizmit, Drejtoria mund t'i paraqesë subjektit urdhëresë në formë të shkruar për përcjellje të marrëdhënies afariste të klientit.
- (2) Për transaksionet që kryhen në kuadër të marrëdhënie afariste ose duhet të kryhen, subjekti e njofton Drejtorin në përputhje me udhëzimet e dhëna në urdhëresë.
- (3) Me urdhëresë nga paragrafi (1) i këtij neni, Drejtoria i përcakton afatet në të cilat subjekti është i detyruar t'i paraqesë të dhënat për transaksionet nga paragrafi (2) i këtij neni.
- (4) Nëse subjekti për shkak të rrethanave objektive nuk mundet ta njoftojë Drejtorinë në afatet nga paragrafi (3) të këtij neni, është i detyruar që menjëherë pas heqjes së rrethanave ta njoftojë Drejtorinë dhe t'ia shpjegojë arsyen për mosdorëzimin e njoftimit në afatin e përcaktuar.
- (5) Përcjellja e marrëdhënies afariste nga paragrafi (1) i këtij neni mund të zgjasë më së shumti tre muaj, e në raste të justifikuara kohëzgjatja e masës mund të zgjatet edhe për nga një muaj, me atë që përcjellja e marrëdhënies afariste mund të zgjasë më së shumti gjashtë muaj.
- (6) Me përjashtim nga paragrafi (5) i këtij neni, për qëllime të parandalimit të financimit të terrorizmit, kohëzgjatja e masës mund të zgjatet derisa të jetë e nevojshme në varësi të qëllimit për të cilin zbatohet masa.

Masa të përkohshme

Neni 120

- (1) Në rast ekzistimi të dyshimit për veprë penale larje e parave dhe/ose financim të terrorizmit, Drejtoria mund t'i paraqesë subjektit urdhëresë me shkrim për mbajtje të përkohshme dhe/ose ndalim

të kryerjes së transaksioneve.

(2) Drejtoria pas dorëzimit të urdhëresës nga paragrafi

(1) i këtij neni parashtron te prokurori publik kompetent kërkesë për paraqitjen e propozimit për përcaktimin e masave të përkohshme.

(3) Mbajtja dhe/ose ndalimi i kryerjes së transaksioneve zgjat deri në marrjen e vendimit gjyqësor mbi propozimin, por jo më shumë se 72 orë pas dorëzimit të urdhëresës me shkrim për mbajtje të përkohshme dhe/ose ndalim të kryerjes së transaksioneve.

(4) Kur afati kohor nga paragrafi (3) i këtij neni përfshin javët diela, pushime ose ditë të tjera jopune, Drejtoria mund t'i dorëzojë urdhëresë subjektit për mbajtje të përkohshme dhe/ose ndalim për kryerjen e transaksioneve më së shumti deri në 120 orë nga lëshimi i urdhëresës.

(5) Kur për shkak të natyrës ose mënyrës së kryerjes së transaksioneve të dyshimta ose të rrethanave që e përcjellin transaksionin e dyshimtë, nuk është e mundur t'i lëshohet urdhëresë me shkrim subjektit, si dhe në raste tjera uergjente, Drejtoria mundet subjektit t'i lëshojë urdhëresë gojore për mbajtjen e përkohshme dhe/ose ndalimin e kryerjes së transaksioneve.

(6) Urdhëresën gojore nga paragrafi (5) i këtij neni, Drejtoria doemos duhet ta konfirmojë me urdhëresë me shkrim më së voni në ditën e parë të ardhshme të punës pas lëshimit të urdhrit me gojë.

(7) Personi i autorizuar është i detyruar të përpilojë procesverbal për urdhëresën gojore të marrë nga paragrafi

(5) i këtij neni, të cilin e ruan në evidencat e veta në pajtim me nenin 51 të këtij ligji.

Neni 121

Kërkesa për paraqitjen e propozimit për përcaktimin e masave të përkohshme nga neni 120 i këtij ligji përmban të dhëna për veprën penale për të cilën kërkohet masa e përkohshme, faktet dhe rrethanat që e justifikojnë nevojën për zbatimin e masës së përkohshme, të dhënat për personin fizik ose juridik për të cilin kërkohet zbatimi i masës së përkohshme dhe shumën e parave ose lloji i pronës.

Neni 122

(1) Prokurori publik kompetent e shqyrton kërkesën për parashtrimin e propozimit për caktimin e masave të përkohshme nga neni 120 i këtij ligji dhe nëse përcakton se është i bazuar, pa kurrfarë prolongimi, e më së voni në afat prej 24 orësh nga pranimi i kërkesës dorëzon propozim për caktimin e masave të përkohshme te gjykatësi i gjykatës themelore kompetente.

(2) Nëse prokurori publik kompetent konstaton se kërkesa për parashtrimin e propozimit për caktimin e masave të përkohshme nga neni 120 i këtij ligji është e pabazuar, është i detyruar pa prolongim ta njoftojë Drejtorinë se kërkesa është refuzuar. Pas pranimit të njoftimit nga prokurori publik Drejtoria pa prolongim dorëzon njoftim me shkrim te subjekti për refuzimin e kërkesës.

Neni 123

(1) Gjykatësi i gjykatës themelore kompetente është i detyruar në afat prej 24 orësh nga pranimi i propozimit nga neni 122 paragrafi (1) të këtij ligji të miratojë aktvendim për zbatimin e masës së përkohshme ose për refuzimin e propozimit të prokurorit publik.

(2) Nëse me aktvendimin janë zbatuar masa të përkohshme, në afatin e njëjtë gjykatësi është i detyruar aktvendimin ta dorëzojë te prokurori publik, subjekti dhe klienti.

(3) Nëse është miratuar aktvendim për refuzimin e propozimit të prokurorit publik, në afatin e njëjtë gjykatësi është i detyruar aktvendimin ta dorëzojë te prokurori publik.

(4) Prokurori publik kompetent është i detyruar për vendimin e marrë të gjykatësit nga paragrafi (1) i këtij neni menjëherë ta njoftojë Drejtorinë.

(5) Kundër aktvendimit të gjykatësit nga paragrafi (1) i këtij neni, prokurori publik kompetent dhe klienti kanë të drejtë për ankesë te këshilli penal i gjykatës themelore kompetente në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, e cila nuk e prolongon realizimin e aktvendimit.

Të dhëna statistikore

Neni 124

(1) Për qëllimet e përgatitjes së vlerësimit nacional të rrezikut, vlerësimit të efikasitetit të sistemit për luftë kundër larjes së parave dhe financimit të terrorizmit si dhe për mbajtjen e analizave strategjike, Drejtoria i mbledh dhe mban këto të dhëna statistikore për:

- numrin, madhësinë, llojin dhe rëndësinë e grupeve të caktuara të subjekteve,
- numrin e raporteve të pranuar për transaksione të dyshuara në pajtim me nenin 54 të këtij ligji,
- numrin e raporteve të pranuar në pajtim me nenin 52 dhe 53 të këtij ligji,
- numrin e iniciativave dhe kërkesave të pranuar nga organet kompetente në pajtim me nenin 117

të këtij ligji,

- numrin e raporteve dhe njoftimeve të dorëzuara te organet kompetente,
- numrin e raporteve të dorëzuara nga Drejtoria sipas të cilave organet kompetente kanë vepruar,
- numrin e informatave të marra dhe dorëzuara spontane nga/deri te njësitë për zbulim financiar të shteteve tjera,
- numrin e kërkesave të dorëzuara, pranuar, refuzuara dhe përgjigjura të njëjësive për zbulim financiar të shteteve tjera dhe të dhëna tjera,
- numrin e mbikëqyrjeve të kryera, edukimeve të zbatuara, urdhërpagesave të lëshuara kundërvajtëse dhe procedurave të ngritura kundërvajtëse,
- numrin e urdhrave të dorëzuara për ndjekjen e marrëdhënies afariste dhe
- numrin e rasteve dhe vlerën e pronës të përfshirë me masa të përkohshme në pajtim me nenet prej 120 deri 123 të këtij ligji.

(2) Drejtoria publikon në internet faqen e vet zyrtare informata për teknikat aktuale, metodat dhe trendet për larjen e parave dhe financim të terrorizmit, shembuj të rasteve të zbuluara të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit, kontroll vjetor për mbikëqyrje të kryera dhe për edukim të zbatuar dhe akte tjera të cilat dalin nga ky ligj ose nga anëtarësimi në trupa dhe organizata ndërkombëtare.

(3) Për qëllimet e vlerësimit të efikasitetit të sistemit për luftën kundër larjes së parave dhe financimit të terrorizmit gjykatat, Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Policisë Financiare, Drejtoria Doganore, Agjencia për menaxhim me pronë të konfiskuar dhe organet tjera kompetente mbledhin dhe mbajjnë të dhëna statistikore për:

- numrin e kallëzimeve penale dhe numrin e personave për të cilët është ngritur kallëzim penal për larjen e parave dhe/ose financimin e terrorizmit,
- numrin e aktakuzave dhe numrin e personave për të cilët është ngritur aktakuzë për larjen e parave dhe/ose financimin e terrorizmit,
- numrin e rasteve dhe numrin e personave të përfshirë në kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare për larjen e parave dhe/ose financimin e terrorizmit,
- numrin e rasteve në të cilat gjatë procedurës penale është bërë rikualifikimi i veprës penale larje e parave dhe/ose financim të terrorizmit dhe anasjelltas,
- numrin e aktgjykimeve dhe numrin e personave për të cilët është miratuar aktgjykim për larjen e parave dhe/ose financimin e terrorizmit,
- numrin dhe llojin e veprave penale të lidhura paraprake dhe
- numrin e rasteve dhe vlerën e pronës së ngrirë, të marrë dhe konfiskuar në rastet e larjes së parave dhe/ose financimit të terrorizmit në Republikën e Maqedonisë dhe shtete tjera dhe të dhëna tjera.

(4) Gjykatat, Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Policisë Financiare, Drejtoria Doganore, Agjencia për menaxhim me pronë të konfiskuar dhe organet tjera kompetente të dhënat nga paragrafi (3) i këtij neni janë të detyruara së paku njëherë në vit t'i dorëzojnë te Drejtoria edhe atë më së voni deri më 30 janar në vitin rrjedhës për vitin paraprak ose me kërkesë të Drejtorisë.

Bashkëpunimi ndërinstitucional

Neni 125

(1) Me qëllime të rregullimit më të detajuar të bashkëpunimit ndërinstitucional, Drejtoria mund të nënshkruajë Memorandume ose Protokolle për bashkëpunim me organet kompetente shtetërore për shkak të plotësimit të qëllimeve të parapara me këtë ligj.

(2) Për avancimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në pajtim me qëllimet e këtij ligji, për koordinimin e aktiviteteve për zbatimin e vlerësimit nacional të rrezikut nga nenet 3 dhe 4 të këtij ligji dhe për avancimin e sistemit për luftë kundër larjes së parave dhe financimit të terrorizmit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit të Financave formon Këshill për luftë kundër larjes së parave dhe financimit të terrorizmit (në tekstin e mëtejme: Këshilli).

(3) Punën e Këshillit nga paragrafi (2) i këtij neni e udhëheq drejtori i Drejtorisë, ndërsa anëtarë të tij janë persona udhëheqës dhe përgjegjës nga Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Prokuroria Publike Themelore për ndjekjen e krimit dhe korrupsionit të organizuar, Drejtoria për Polici Financiare, Drejtoria Doganore, Drejtoria e të Hyrave Publike, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, Komisioni për letra me vlerë, Agjencia për supervizion të sigurimit, Agjencia për supervizion të sigurimit pensional me financim kapital, Agjencia e Postave, si dhe përfaqësues të Odës së Avokatëve, Odës së Noterëve, Institutit të Revizorëve të autorizuar dhe

Instituti të kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar.

(4) Anëtarët e Këshillit kanë zëvendës të cilët caktohen nga radhët e të punësuarve në organet dhe institucionet nga paragrafi (3) i këtij neni të cilët kanë njohuri adekuate nga sfera e zbulimit dhe parandalimit të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

(5) Këshilli nga paragrafi (2) i këtij neni miraton Rregullore për mënyrën e punës së vet.

(6) Punët administrative profesionale për Këshillin i kryen Drejtoria.

Drejtoria Doganore

Neni 126

(1) Drejtoria Doganore në mënyrë të detyrueshme e evidenton secilën hyrje dhe dalje të parave dhe mjeteve bartëse fizike për pagim nëpërmjet linjës doganore të Republikës së Maqedonisë, nëse shuma e tejkalon me ligj ose rregull tjetër maksimumin e lejuar.

(2) Gjatë evidentimit nga paragrafi (1) i këtij neni Drejtoria Doganore në mënyrë të detyruar mbledh të dhëna për:

- identitetin e personit i cili për vete ose për tjetër kryen futjen ose nxjerrjen e parave dhe mjeteve bartëse fizike për pagim, të dhënat për emrin dhe mbiemrin, datën dhe vendin e lindjes, numrin e dokumentit të udhëtimit dhe shtetësinë,

- identitetin e pronarit të parave dhe mjeteve bartëse fizike për pagim,

- identitetin e pronarit të vërtetë,

- shumën dhe valutën së parave dhe mjeteve bartëse fizike për pagim e cila futet ose nxirret nëpërmjet linjës doganore,

- deklaratën për prejardhjen e parave dhe mjeteve bartëse fizike për pagim, të nënshkruar nga personi i cili kryen futjen ose nxjerrjen e tyre,

- qëllimin për futjen ose nxjerrjen e parave dhe mjeteve bartëse fizike për pagim dhe

- vendin dhe kohën e kalimit të linjës doganore.

(3) Drejtoria doganore në mënyrë të detyrueshme në formë të mbrojtur elektronike, e në rast kur kjo nuk është e mundur, në formë të shkruar e paraqet te Drejtoria futjen ose nxjerrjen e parave dhe mjeteve bartëse fizike për pagim mbi 10.000 euro në kundërvlerë me denarë, më së voni në afat prej tri ditësh pune, nga evidentimi.

(4) Drejtoria doganore në mënyrë të detyrueshme me shkrim e paraqet te Drejtoria futjen ose nxjerrjen e parave dhe mjeteve bartëse fizike për pagim pa marrë parasysh shumën, çdoherë kur ekziston bazë për dyshim për larje të parave ose financim të terrorizmit më së voni në afat prej 24 orësh nga informimi për dyshimin e futjen ose nxjerrjen së parave dhe mjeteve bartëse fizike për pagim.

(5) Drejtoria doganore është e detyruar t'i ruajë të gjitha të dhënat për futjen ose nxjerrjen e parave dhe mjeteve bartëse fizike për pagim, nëpërmjet linjës doganore dhjetë vjet nga dita e bartjes së kryer.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Neni 127

(1) Drejtoria realizon bashkëpunim ndërkombëtar me njësi për zbulim financiar të shteteve tjera përmes shkëmbimit të të dhënave relevante, informatave dhe dokumentacionit për qëllimet e parandalimit dhe zbulimit të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) Shkëmbimi ndërkombëtar të të dhënave relevante, informatave dhe dokumentacionit nga paragrafi (1) të këtij neni realizohet në bazë të:

- kërkesës për shkëmbim të të dhënave, informatave dhe dokumentacionit të cilin e dorëzon Drejtoria te njësia për zbulim financiar të shtetit tjetër,

- kërkesë për shkëmbim të të dhënave, informatave dhe dokumentacionit të cilin Drejtoria e ka marrë nga njësia për zbulim financiar të shtetit tjetër,

- dorëzim i të dhënave, informatave dhe dokumentacionit të Drejtorisë te njësia për zbulim financiar të shtetit tjetër ose

- dorëzim i të dhënave, informatave dhe dokumentacionit të njësisë për zbulim financiar të shtetit tjetër për Drejtorinë.

(3) Drejtoria realizon bashkëpunim ndërkombëtar me njësi për zbulim financiar të shteteve tjera pa marrë parasysh formën e tyre organizative.

(4) Drejtoria mund të lidh marrëveshje për bashkëpunim me njësi për zbulim financiar të shteteve tjera, si dhe me organizata ndërkombëtare të përfshira në luftën kundër larjes së parave dhe financimit të terrorizmit për qëllimet e parandalimit të parandalimit dhe zbulimit të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Nënshkrimi i marrëveshjeve për bashkëpunim nuk është parakusht Drejtoria të realizojë bashkëpunim ndërkombëtar me njësi për zbulim financiar të shteteve tjera.

Kërkesë për shkëmbim të të dhënave të cilën e dorëzon Drejtoria te njësia për zbulim financiar të shtetit tjetër

Neni 128

(1) Drejtoria për zbatimin e kompetencave të saj, në pajtim me dispozitat e këtij ligji, mund të dorëzojë kërkesë për shkëmbimin e të dhënave, informatave dhe dokumentacionit për njësinë e zbulimit financiar të shtetit tjetër.

(2) Kërkesa për shkëmbimin e të dhënave, informatave dhe dokumentacionit nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të jetë e arsyetuar me fakte përkatëse të njohura që sugjerojnë në larjen e parave dhe/ose financimin e terrorizmit dhe qëllimin për të cilin do të përdoren të dhënat dhe informatat e kërkuara .

(3) Të dhënat, informatat dhe dokumentacioni të siguruara në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni Drejtoria është e detyruar t'i përdorë për zbatimin e kompetencave e saj në pajtim me dispozitat e këtij ligji, në përputhje me kufizimet dhe kushtet e përcaktuara nga ana e njësisë për zbulim financiar të shtetit e cila i ka siguruar.

(4) Të dhënat, informatat dhe dokumentacionin të siguruara në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni Drejtoria mund t'i shkëmbejë me organe kompetente, pasi do të sigurojë pëlqim paraprak nga ana e njësisë për zbulim financiar të shtetit që i ka siguruar.

(5) Të dhënat, informatat dhe dokumentacioni të siguruara në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni janë të klasifikuara dhe shënohen me së paku shkallën e njëjtë të klasifikimit të përcaktuar nga ana e njësisë për zbulim financiar të shtetit që i ka siguruar.

Kërkesë për shkëmbim të të dhënave, informatave dhe dokumentacionit të cilat Drejtoria e ka marrë nga njësia për zbulim financiar të shtetit tjetër

Neni 129

(1) Me kërkesë për shkëmbimin e të dhënave, informatave dhe dokumentacionit të njësisë për zbulim financiar të shtetit tjetër të dorëzuar në formë të shkruar, Drejtoria dorëzon të dhëna, informata dhe dokumentacion të cilat i siguron në pajtim me kompetencat e përcaktuara me këtë ligj.

(2) Kërkesa për shkëmbimin e të dhënave, informatave dhe dokumentacionit nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të jetë e arsyetuar me faktet përkatëse të njohura që sugjerojnë larjen e parave dhe / ose financimin e terrorizmit dhe qëllimin për të cilin do të shfrytëzohen të dhënat dhe informatat e kërkuara .

(3) Drejtoria mund ta refuzojë kërkesën për shkëmbimin e të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse ajo është në kundërshtim me këtë ligj ose do ta pengojë hetimin e organit tjetër shtetëror kompetent ose procedurë penale kundër personit për të cilin kërkohen të dhëna. Drejtoria është e obliguar që t'i arsyetojë shkaqet për të cilat e ka refuzuar kërkesën.

(4) Të dhënat, informatat dhe dokumentacioni të siguruara në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni janë të klasifikuara dhe shënohen me së paku shkallën e njëjtë të klasifikimit të përcaktuar nga ana e njësisë për zbulim financiar të shtetit që i ka dorëzuar .

(5) Me kërkesë të njësisë për zbulim financiar të shtetit tjetër nga paragrafi (1) i këtij neni, Drejtoria pa prolongim dorëzon pëlqim për përcjelljen e të dhënave, informatave dhe dokumentacionit të siguruara në pajtim me paragrafin

(1) të këtij neni për organet kompetente të shtetit.

(6) Drejtoria mund të refuzojë të japë pëlqim për përcjelljen e të dhënave, informatave dhe dokumentacionit me arsyetim me shkrim për njësinë për zbulim financiar nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse kërkesa për pëlqim është në kundërshtim me këtë ligj ose e pengon hetimin në procedurën penale.

Dorëzimi i të dhënave, informatave dhe dokumentacionit të Drejtorisë në njësinë për zbulim financiar të shtetit tjetër

Neni 130

(1) Drejtoria mund të dhënat, informatat dhe dokumentacionin të cilat i siguron në pajtim me kompetencat e përcaktuara me këtë ligj, kur ekziston dyshim për larje parash ose financim të terrorizmit dhe pa kërkesë nga njësia për zbulim financiar të shtetit tjetër, t'ia dorëzojë të njëjtës.

(2)Për të dhënat, informatat dhe dokumentacionin të cilat Drejtoria i dorëzon në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni zbatohen dispozitat nga ky ligj.

Masa të përkohshme në korniza të bashkëpunimit ndërkombëtar

Neni 131

(1) Dispozitat e neneve 120, 121, 122 dhe 123 të këtij ligji do të zbatohen kur njësia për zbulim financiar të shtetit tjetër do të kërkojë refuzim ose prolongim të transaksionit.

(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të arsyetohet dhe të ketë të bëjë për transaksion të lidhur me larjen e parave dhe / ose financimin e terrorizmit dhe refuzimi ose prolongimi do të realizohet nëse transaksioni është lëndë e raportit vendor për transaksion të dyshimtë.

(3) Drejtoria mund të dorëzojë kërkesë për njësinë e zbulimit financiar të shtetit tjetër për refuzimin ose prolongimin e transaksionit gjatë ekzistimit të dyshimit për larje të parave dhe / ose financim të terrorizmit.

Informata kthyesë

Neni 132

(1) Drejtoria me kërkesë të njësisë për zbulim financiar të shtetit tjetër siguron informata kthyesë për përdorimin e të dhënave të dorëzuara, informatave dhe dokumentacionit.

(2) Drejtoria mund të kërkojë nga njësia e zbulimit financiar të shtetit tjetër informata kthyesë për përdorimin e të dhënave, informatave dhe dokumentacionit të dorëzuar.

Mënyra të sigurta për realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar

Neni 133

Shkëmbimi i të dhënave, informatave dhe dokumentacionit ndërmjet Drejtorisë dhe njërive për zbulim financiar të shteteve tjera në pajtim me këtë ligj, do të zhvillohet përmes sistemeve të sigurta elektronike ndërkombëtare të komunikimit.

Neni 134

(1) Drejtoria mund të shkëmbejë të dhëna, informata dhe dokumentacione në mënyrë indirekte me organe kompetente për zbulimin dhe parandalimin e larjes së parave dhe financimin e terrorizmit të shteteve tjera, por shkëmbimi i tillë duhet të zbatohet nëpërmjet njësisë për zbulim financiar të shtetit nëpërmjet sistemeve të sigurta elektronike ndërkombëtare të komunikimit.

(2) Gjatë shkëmbimit të të dhënave, informatave dhe dokumentacionit në pajtim me nenin (1) nga ky nen, zbatohen dispozitat nga ky ligj të cilat e rregullojnë bashkëpunimin ndërkombëtarë.

Ruajtja e të dhënave, informatave dhe dokumentacionit nga ana e Drejtorisë

Neni 135

Drejtorja është e detyruar të dhënat, informatat dhe dokumentacionin të siguruar në pajtim me këtë ligj t'i ruajë dhjetë vjet nga pranimi i tyre dhe pas skadimit të kësaj periudhe mund t'i asgjësojë.

KAPITULLI V.

GRUMBULLIMI, PËRPUNIMI, ANALIZIMI, VLERËSIMI, SHFRYTËZIMI, BARTJA, RUAJTJA DHE SHLYERJA E TË DHËNAVE DHE PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 136

(1) Drejtoria mbledh, përpunon, analizon, vlerëson, shfrytëzon, bart, ruan dhe shlyen të dhëna, përpunon të dhënat personale në kushte dhe në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj dhe ligj të veçantë dhe mban evidenca për të dhënat personale dhe të dhëna tjera për grumbullimin e të cilave është autorizuar me këtë ligj, me qëllim të parandalimit të larjes së parave dhe / ose financimit të terrorizmit.

(2) Drejtoria përpunon të dhëna personale kur për personin ekziston dyshim për larje të parave dhe/ose financim të terrorizmit.

(3) Të dhënat për personin juridik grumbullohen kur ekzistojnë baza për dyshim për larje të parave dhe/ose financim të terrorizmit.

Neni 137

Të dhëna personale, në kuptim të këtij ligji, janë: emri personal, të dhënat për lindjen (dita, muaji, viti

dhe vendi), vendbanimi ose vendqëndrimi, numri unik i amzës, adresa e banimit dhe shtetësia, si dhe të dhëna të tjera përmes të cilave në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi mund të identifikohet person i caktuar.

Neni 138

Drejtoria grumbullon të dhëna personale dhe të dhëna tjera nga subjekte, organe shtetërore kompetente, institucione publike, institucione, organizata ndërkombëtare dhe persona tjerë juridikë dhe fizikë.

Neni 139

- (1) Drejtoria mban evidenca për:
- 1) persona për të cilët është dorëzuar raport për aktivitet të dyshimtë;
 - 2) persona për të cilët është dorëzuar raport për transaksion me para në dorë, në shumë prej 15.000 euro në kundërvlerë me denarë ose më shumë, pavarësisht nëse bëhet fjalë për një transaksion ose më shumë transaksione të lidhura dukshëm;
 - 3) persona për të cilët është dorëzuar raport nga noteri për akt të përpiluar të noterit, dokument privat të vërtetuar dhe nënshkrim të verifikuar të marrëveshjes;
 - 4) persona për të cilët është dorëzuar raport për kredi të paguar;
 - 5) persona për të cilët është dorëzuar raport për hua të dhënë dhe/ose të pranuar;
 - 6) persona për të cilët është dorëzuar raport për transaksion të realizuar përmes transferit të shpejtë të parave;
 - 7) persona për të cilët është dorëzuar raport për lidhje të policës për sigurim të jetës; 8) persona për të cilët është dorëzuar raport për shitblerje të automjeteve;
 - 9) persona për të cilët është dorëzuar raport për blerje ose pagesën e çipave në lojëtoje (kazino);
 - 10) personat për të cilët është dorëzuar raport për pagesën e fitimit, pagesë ose pengim të investimit ose/ dhe në të gjitha rastet tek organizatorët e tjerë të lojërave të fatit;
 - 11) personat për të cilët është dorëzuar raport për dyshim për larje të parave dhe financim të terrorizmit te organet kompetente;
 - 12) persona për të cilët është dorëzuar njoftim për dyshim për veprë tjetër penale për organet kompetente;
 - 13) persona për të cilët është lëshuar urdhëresë për ndjekje të marrëdhënies afariste;
 - 14) persona për të cilët është lëshuar urdhëresë për zbatim të masave të përkohshme;
 - 15) persona për të cilët është dorëzuar iniciativë dhe kërkesë nga organet kompetente në Republikën e Maqedonisë;
 - 16) persona për të cilët janë shkëmbyer të dhënat me njësitë për zbulim financiar të shteteve tjera;
 - 17) persona të cilët kanë bartur para ose mjete fizike bartëse për pagesë përmes linjës doganore të Republikës së Maqedonisë;
 - 18) persona për të cilët janë lëshuar fletëpagesa kundërvajtëse;
 - 19) persona për të cilët është zbatuar edukim dhe
 - 20) persona për të cilët janë shkëmbyer të dhëna nëpërmjet organeve të mbikëqyrjes.
- (2) Evidencat nga paragrafi (1) të këtij neni përmbajnë të dhëna personale në pajtim me këtë ligj dhe të dhëna të tjera dhe informata për bartësin e të dhënave personale dhe për personin e tretë.

Neni 140

Evidenca nga neni 139 i këtij ligji mund të jetë e strukturuar dhe të mbahet si:

- 1) evidenca për raport të dorëzuar për aktivitet të dyshimtë;
- 2) evidenca për raport të dorëzuar për transaksion me para në dorë në shumë prej 15.000 euro në kundërvlerë me denarë ose më shumë, pavarësisht nëse bëhet fjalë për një transaksion ose më shumë transaksione të lidhura dukshëm;
- 3) evidenca për raport të dorëzuar nga noteri për akt të përpiluar të noterit, dokument privat të vërtetuar dhe nënshkrim të verifikuar të marrëveshjes;
- 4) evidenca për raport të dorëzuar për kredi të paguar;
- 5) evidenca për raport të dorëzuar për hua të dhënë dhe/ose të pranuar;
- 6) evidenca për raport të dorëzuar për transaksion të realizuar përmes transferit të shpejtë të parave;
- 7) evidenca për raport të dorëzuar për lidhje të policës për sigurim të jetës;
- 8) evidenca për raport të dorëzuar për shitblerje të automjeteve;
- 9) evidenca për raport të dorëzuar për blerje ose pagesën e çipave në lojtore (kazino);
- 10) evidenca për raport të dorëzuar për pagesën e fitimit, pagesë ose stornim të investimit ose/ dhe në të gjitha rastet tek organizatorët e tjerë të lojërave të fatit;
- 11) evidenca për raport të dorëzuar për dyshim për larje të parave dhe financim të terrorizmit për

organet kompetente;

- 12) evidenca për njoftim të dorëzuar për dyshim për veprë tjetër penale te organet kompetente;
- 13) evidenca për urdhëresë të lëshuar për ndjekje të marrëdhënies afariste;
- 14) evidenca për urdhëresë të lëshuar për zbatim të masave të përkohshme;
- 15) evidenca për iniciativë të dorëzuar dhe kërkesë nga organet kompetente në Republikën e Maqedonisë;
- 16) evidenca për shkëmbim të të dhënave me njësitë për zbulim financiar të shteteve tjera;
- 17) evidenca për raport të dorëzuar për para të transferuara ose mjete fizike të bartshme për pagesë përmes linjës doganore të Republikës së Maqedonisë;
- 18) evidenca për kryerje të mbikëqyrjes ndaj subjekteve nga neni 5 të këtij ligji;
- 19) evidenca për mbikëqyrje të kryer ndaj subjekteve juridike të nenit 25 të këtij ligji;
- 20) evidenca për urdhërpagesa kundërvajtëse të lëshuara;
- 21) evidenca për edukim të zbatuar dhe
- 22) evidenca për të dhëna të shkëmbyera ndërmjet organeve të mbikëqyrjes.

Neni 141

(1) Të dhënat për të cilat Drejtoria mban evidenca në pajtim me nenin 139 dhe nenin 140 të këtij ligji shfrytëzohen për qëllime statistikore dhe analitike të Drejtorisë, si dhe për qëllimet e zbatimit të vlerësimit nacional të rrezikut dhe vlerësimit të efikasitetit të sistemit për parandalimin e larjes së parave dhe financimin e terrorizmit

(2) Të dhëna personale mund t'u dorëzohen subjekteve, organeve shtetërore kompetente, institucioneve publike, institucioneve, njësiteve për zbulim financiar të shteteve të tjera dhe personave të tjerë juridikë dhe fizikë në pajtim me ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara.

Neni 142

Të dhënat personale mund të shfrytëzohen në pajtim me qëllimet të përcaktuara me këtë ligj dhe në pajtim me dispozitat me të cilat rregullohet mbrojtja e të dhënave personale.

Neni 143

Të dhënat personale të futura në evidencat nga nenet 139 dhe 140 të këtij ligji, fshihen menjëherë në rastet kur do të konstatohet se nuk janë të sakta ose kanë pushuar arsyet, përkatësisht kushtet për të cilat e dhëna personale është futur në evidencë.

Neni 144

Të dhënat të përmbajtura në evidencat nga nenet 139 dhe 140 të këtij ligji, nga futja e tyre, deri në shlyerjen e tyre mund të shkëmbehen sipas kushteve dhe mënyrës të parapara me këtë ligj.

Neni 145

Të dhënat nga evidencat nga nenet 139 dhe 140 të këtij ligji ruhen në afat prej dhjetë vjetësh nga dita e pranimit të tyre.

KAPITULLI VI.

MBIKËQYRJA

Neni 146

(1) Mbikëqyrjen mbi zbatimin e masave dhe veprimet e përcaktuara me këtë ligj e kryejnë organet për mbikëqyrje në kuptim të këtij ligji, si vijon:

- Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë ndaj bankave, kursimoreve, këmbimoreve dhe dhënësve të shërbimeve të dërgesave monetare (transferim të shpejtë të parave) dhe institucionet financiare të tjera që ofrojnë shërbime pagesore,
- Agjencia për supervizion të sigurimit ndaj shoqërive për sigurim, shoqërive brokere të sigurimit, shoqërive për përfaqësim në sigurim, brokerët e sigurimit dhe përfaqësuesit në sigurim,
- Komisioni për Letra me Vlerë i Republikës së Maqedonisë ndaj shtëpive brokere, personave që ofrojnë shërbime të këshilltarëve investues, shoqërive për menaxhimin e fondeve investuese të hapura, të mbyllura dhe private dhe fondeve investuese të hapura, të mbyllura dhe private,
- Agjencia për supervizion të sigurimit pensional me financim kapital ndaj shoqërive që menaxhojnë me fonde pensionale vullnetare,
- Drejtoria e të hyrave publike ndaj organizatorëve të lojërave të fatit, personave juridikë dhe fizikë i kryejnë këto shërbime: ndërmjetësim në qarkullim me patundshmëritë, dhënie e këshillave nga sfera e

tatimeve dhe personave juridikë që kryejnë veprimtari të marrjes peng të sendeve të tundshme dhe patundshmërive,

- Agjencia për Posta ndaj Postës së Maqedonisë SHA,

- Komisioni i noterëve në korniza të Odës së Noterëve të Republikës së Maqedonisë ndaj noterëve dhe

-Komisioni i avokatëve në korniza të Odës së Avokatëve të Republikës së Maqedonisë ndaj avokatëve dhe shoqërive të avokatëve.

(2) Drejtoria kryen mbikëqyrje ndaj zbatimit të masave dhe veprimtarive të përcaktuara me këtë ligj ndaj subjekteve që nuk janë përfshirë në paragrafin (1) të këtij neni.

(3) Drejtoria në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me organet nga paragrafi (1) i këtij neni, kryen mbikëqyrje ndaj zbatimit të masave dhe veprimeve të përcaktuara me këtë ligj ndaj subjekteve.

(4) Drejtoria pas njoftimit të marrë nga administratori i regjistrit zbaton mbikëqyrje në pajtim me këtë ligj ndaj subjekteve juridike nga paragrafi (1) i nenit 30 të këtij ligji.

(5) Drejtoria kryen mbikëqyrje ndaj subjekteve juridike nga neni 25 paragrafi (1) i këtij ligji dhe përcakton nëse posedojnë, ruajnë dhe regjistrojnë në regjistër të dhëna adekuate, të sakta dhe të plota për pronarin e vërtetë.

(6) Drejtoria me organet nga paragrafi (1) i këtij neni është e detyruar të koordinojë në mënyrë të ndërsjellë aktivitetet gjatë kryerjes së mbikëqyrjes ndaj subjekteve nga neni 5 të këtij ligji.

(7) Drejtoria dhe organet nga paragrafi (1) i këtij neni janë të detyruara të përgatisin program ose plan vjetor për kryerje të mbikëqyrjes për zbatimin e masave dhe veprimtarive të përcaktuara me këtë ligj dhe t'i harmonizojnë në mënyrë të ndërsjellë.

(8) Drejtoria dhe organet nga paragrafi (1) i këtij neni mund të përcaktojnë mënyrë të zbatimit adekuat të masave për parandalimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit për subjektet për mbikëqyrjen e të cilave janë përgjegjëse.

(9) Organi nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes, përcaktojnë dyshim për larjen e parave dhe/ose financim të terrorizmit, për këtë dorëzojnë raport me shkrim te Drejtoria.

(10) Zbuluesit financiarë që kryejnë mbikëqyrje në pajtim me dispozitat e këtij ligji, nëse konstatojnë dyshime për larje parash dhe/ose financim të terrorizmit, dorëzojnë raport me shkrim për drejtorin e Drejtorisë dhe për njësisë organizative të Drejtorisë kompetente të zbatojë analizë operative.

(11) Drejtoria dhe organet nga paragrafi (1) i këtij neni bashkëpunojnë gjatë kryerjes së detyrave dhe autorizimeve të tyre gjatë kryerjes së mbikëqyrjes me qëllim të sigurimit të efikasitetit të masave dhe mbikëqyrjes në luftën kundër larjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

(12) Drejtoria mund të dorëzojë propozim për organet nga paragrafi (1) i këtij neni të kryejnë mbikëqyrje ndaj subjektit të caktuar në bazë të njohurive që dalin nga të dhënat dhe informatat me të cilat disponojnë, si dhe në bazë të analizave strategjike dhe operative të kryera.

(13) Drejtoria dhe organet nga paragrafi (1) i këtij neni ndërmarrin aktivitete në drejtim të harmonizimit të qasjes metodologjike gjatë zbatimit të mbikëqyrjes.

(14) Drejtoria e të hyrave publike, në pajtim me kompetencat e veta kryen mbikëqyrje ndaj personave juridikë dhe fizikë në lidhje me zbatimin e ndalesës për pagesa me para në dorë në shumë prej 2.000 eurosh ose më shumë në kundërvlerë të denarit nga neni 48 të këtij ligji.

Neni 147

(1) Mbikëqyrja që e kryen Drejtoria mund të zgjasë më së gjati 45 ditë pune, me mundësi të vazhdohet, por jo më gjatë se 60 ditë pune.

(2) Ministri i Financave e përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhëresës për kryerje të mbikëqyrjes nga ana e Drejtorisë.

(3) Drejtori i Drejtorisë miraton program vjetor për kryerje të mbikëqyrjes më së voni deri më 31 janar për vitin rrejtës.

Neni 148

(1) Mbikëqyrjen të cilën në mënyrë të pavarur e zbaton Drejtoria mund të jetë mbikëqyrje në terren dhe jashtë terrenit, e rregullt, e jashtëzakonshme dhe mbikëqyrje kontrolluese.

(2) Mbikëqyrjen nga paragrafi (1) e kryejnë zbuluesit financiarë, të punësuar në Drejtori të cilët i plotësojnë kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik dhe kushtet e përcaktuara me aktin për sistematizimin e vendeve të punës në Drejtori.

(3) Në bazë të mbikëqyrjes nga paragrafi (1) Drejtoria mund të:

- zbatojë procedurë për edukim,

- lëshojë fletëpagesë kundërvajtëse dhe

- parashtrijë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse.

Neni 149

- (1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes të cilën e zbaton Drejtoria, zbuluesi financiar ka për detyrë:
 - 1) të veprorë sipas urdhëresës për kryerje të mbikëqyrjes;
 - 2) të marrë aktivitetet përgatitore për kryerje të mbikëqyrjes;
 - 3) t'i njoftojë personat përgjegjës dhe të autorizuar të subjektit për fillimin e kryerjes së mbikëqyrjes, bazën ligjore, qëllimin dhe vëllimin e mbikëqyrjes, përveç në rast të mbikëqyrjes së jashtëzakonshme dhe kontrolluese;
 - 4) të legjitimohet para subjektit, përkatësisht para personit të autorizuar të subjektit;
 - 5) ta ruajë fshehtësinë e të dhënave;
 - 6) të veprorë në mënyrë të ligjshme, në kohë dhe në pajtim me Kodin etik të Drejtorisë;
 - 7) të përpilojë procesverbal për mbikëqyrjen e kryer;
 - 8) të propozojë procedurë për barazim dhe të lëshojë urdhërpagesë kundërvajtëse;
 - 9) të miratojë aktvendim në pajtim me nenin 155 të këtij ligji;
 - 10) të miratojë konkluzion;
 - 11) të parashtrijë kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse dhe
 - 12) t'i grumbullojë, përpunojë dhe ruajë të dhënat personale në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat për mbrojtje të të dhënave personale.
- (2) Përveç detyrimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, zbuluesi financiar për mbikëqyrjen e kryer është i obliguar dokumentacionin e përgatitur ta vendosë në dosje sipas rendit në vijim:
 - 1) dokumentet e grumbulluara në përgatitjen e mbikëqyrjes;
 - 2) kërkesë nga seksionet në Drejtori, organ apo institucion tjetër nëse mbikëqyrja është kryer me kërkesën e tyre;
 - 3) urdhëresë për mbikëqyrje;
 - 4) procesverbal për mbikëqyrje të kryer;
 - 5) aktvendim;
 - 6) konkluzion;
 - 7) procesverbal nga barazimi i kryer;
 - 8) urdhërpagesë kundërvajtëse;
 - 9) kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse dhe
 - 10) aktvendime të plotfuqishme dhe përmbaruese nga procedura gjyqësore.

Neni 150

- (1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes të cilën e zbaton Drejtoria, zbuluesi financiar është i autorizuar:
 - 1) të kontrollojë akte të përgjithshme dhe individuale, fajlle, dokumente, dëshmi dhe informata në vëllim sipas lëndës së mbikëqyrjes, si dhe të kërkojë të përgatitin kopjet dhe dokumentet e nevojshme;
 - 2) të kërkojë nga subjekti t'i sigurohen kushte të zyrës për punë në hapësira afariste të subjektit dhe person i cili do të marrë pjesë gjatë mbikëqyrjes me qëllim të sigurimit me kohë të dokumentacionit dhe informatave në lidhje me lëndën e mbikëqyrjes;
 - 3) të futet dhe kryejë kontroll në hapësirat afariste të subjektit dhe të njërive afariste të tij;
 - 4) të kërkojë ndihmë nga organi kompetent i administratës shtetërore për mënjanimin e personit i cili e pengon kryerjen e mbikëqyrjes në kushte dhe në procedurë të përcaktuara me ligj;
 - 5) të kontrollojë dokumente identifikuese të personave për shkak të vërtetimit të identitetit të tyre në pajtim me ligjin;
 - 6) të kërkojë nga subjekti ose nga të punësuarit e tij sqarim me shkrim ose me gojë në lidhje me çështje nga fushëveprimi i mbikëqyrjes;
 - 7) të kërkojë mendim profesional nga persona ekspertë kur ajo është e nevojshme për mbikëqyrjen;
 - 8) të kryejë regjistrim të dokumenteve të hasura në objektin afarist dhe
 - 9) të sigurojë dëshmi tjera të nevojshme.
- (2) Kopja me origjinalin e fajlleve, dokumenteve, dëshmime dhe informatave nga paragrafi (1) i këtij neni subjekti e vërteton me nënshkrimin e personit të autorizuar.
- (3) Zbuluesi financiar është i autorizuar të ngrit procedurë për lëshimin e urdhërpagesës kundërvajtëse dhe procedurës kundërvajtëse në pajtim me ligjin.

Neni 151

- (1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes të cilën e zbaton Drejtoria, zbuluesi financiar për shkak të mënjanimin të kundërvajtjeve të përcaktuara, ka të drejtë dhe detyrim që subjektit:
 - 1) t'i sugjerojë për kundërvajtjet e konstatuara dhe të përcaktojë afat për mënjanimin e tyre dhe të paraqesë ftesë për zbatimin e edukimit në pajtim me nenin 155 të këtij ligji;
 - 2) t'i lëshojë urdhërpagesë kundërvajtëse ose
 - 3) t'i parashtrijë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse ose të ngriejë procedurë tjetër

përkatëse.

Neni 152

Për ankesë kundër aktvendimit të zbuluesit financiar në Drejtori vendos komision i posaçëm prej tre anëtarësh të emëruar nga ministri i Financave, me ç'rast kryetari i komisionit caktohet nga radhët e personave udhëheqës në Drejtori të cilët nuk janë të përfshirë në mbikëqyrje.

Neni 153

(1) Odat e avokatëve dhe odat e noterëve në korniza të kompetencave të tyre formojnë komisione për mbikëqyrjen ndaj zbatimit të dispozitave të këtij ligji ndaj punës së anëtarëve të tyre.

(2) Anëtarët e komisioneve nga paragrafi (1) të këtij neni emërohen me mandat prej katër vjetësh.

(3) Për emërimin dhe përbërjen e komisioneve nga paragrafi (1) i këtij neni e njoftojnë Drejtorinë në afat prej shtatë ditësh.

Neni 154

(1) Organet e mbikëqyrjes nga neni 146 të këtij ligji janë të detyruar ta njoftojnë Drejtorinë për:
- konstatimet nga mbikëqyrja e kryer mbi zbatimin e masave dhe veprimeve të përcaktuara me këtë ligj,

- edukimin e zbatuar ose masa tjera të shqiptuara,
- urdhërpagesa të lëshuara dhe të arkëtuara kundërvajtëse,
- kërkesë të parashtruar për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtjen e kryer nga ana e subjekteve ndaj të cilave kryejnë mbikëqyrje dhe për rezultatit e këtyre procedurave
- kryerësin e kundërvajtjes, si vijon: emërtimin dhe vendqëndrimin e personit juridik, emrin dhe mbiemrin e personit përgjegjës në personin juridik, emrin dhe mbiemrin e personit fizik, personit që kryen autorizim publik dhe personit zyrtar të autorizuar,
- kundërvajtjen: përshkrimin e veprimtarisë që paraqet kundërvajtje dhe gjobën e shqiptuar.

(2) Organet e mbikëqyrjes nga neni 146 të këtij ligji janë të detyruar së paku dy herë në vit ta njoftojnë Drejtorinë për të dhënat e lidhura me mbikëqyrjen e kryer nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Drejtoria për mbikëqyrjen e kryer ndaj subjekteve dhe për konstatimet nga mbikëqyrja e kryer dy herë në vit e njofton organin përkatës të mbikëqyrës nga neni 146 i këtij ligji.

Procedura për edukim

Neni 155

(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes të cilën e zbatojnë organet e mbikëqyrjes nga neni 146 i këtij ligji, është konstatuar parregullsi për herë të parë nga ana e subjektit, nga nenet 163 dhe 166 të këtij ligji, përpilohet procesverbal në të cilin përcaktohet parregullsia e konstatuar dhe miratohet aktvendim me sugjerim për mënjanimin e parregullsisë së konstatuar në afat prej tetë ditësh pune dhe njëkohësisht dorëzohet ftesë për edukimin e kryerësit të kundërvajtjes.

(2) Formën dhe përmbajtjen e ftesës për edukim, si dhe mënyrën e zbatimit të edukimit, e përcakton ministri i financave, me propozim të drejtorit të Drejtorisë.

(3) Edukimi organizohet dhe zbatohet në afat jo më të gjatë se tetë ditë pune nga dita e zbatimit të mbikëqyrjes.

(4) Nëse në terminin e caktuar kryesi i kundërvajtjes nga paragrafi (1) i këtij neni, ndaj të cilit zbatohet edukimi, nuk paraqitet në edukim, do të llogaritet se edukimi është zbatuar.

(5) Nëse kryerësi i kundërvajtjes nga paragrafi (1) i këtij neni paraqitet në edukimin e caktuar dhe të njëjtën e përfundon, do të konsiderohet se është edukuar në lidhje me kundërvajtjen e përcaktuar.

(6) Nëse gjatë kontrollit mbikëqyrës përcaktohet se janë mënjeluar kundërvajtjet e përcaktuara nga paragrafi

(1) i këtij neni, miratohet konkluzion me të cilin ndërpritet procedura e mbikëqyrjes.

(7) Nëse gjatë zbatimit të mbikëqyrjes kontrolluese janë përcaktuar se nuk janë mënjeluar kundërvajtjet e përcaktuara nga paragrafi (1) nga ky nen, jepet urdhërpagesë kundërvajtëse.

(8) Organet e mbikëqyrjes nga neni 146 të këtij ligji mbajnë evidencë për edukimin e kryer në mënyrën dhe formën e përcaktuar nga ministri i Financave, me propozim të drejtorit të Drejtorisë.

Mbikëqyrje në pajtim me vlerësim të rrezikut

Neni 156

(1) Gjatë zbatimit të mbikëqyrjes së subjekteve, organet e mbikëqyrjes nga neni 146 të këtij ligji janë të obliguar ta zbatojnë qasjen të bazuar në vlerësim të rrezikut nga larja e parave dhe financimi i

terrorizimit.

(2) Gjatë përgatitjes dhe zbatimit të programit ose planit për mbikëqyrje, organet e mbikëqyrjes nga neni 146 të këtij ligji janë të obliguar së paku t'i marrin parasysh:

- të dhënat për rreziqet e identifikuar nga larja e parave ose financim të terrorizmit në pajtim me konstatimet nga raporti për vlerësim kombëtar të rrezikut nga neni 4 të këtij ligji,
- të dhënat për rreziqe specifike kombëtare ose ndërkombëtare të lidhura me klientë, prodhime dhe shërbime,
- të dhënat për rrezikun e kategorive të caktuara të subjekteve, subjekte të veçanta dhe të dhëna tjera të kapshme për subjektet dhe ngjarje të rëndësishme ose ndryshime të lidhura me menaxhimin e subjektit dhe çdo ndryshim i aktiviteteve të tij afariste.

Procedura për paraqitje për kundërvajtje të kryer

Neni 157

(1) Subjekti është i obliguar të vendosë procedurë për paraqitje për kundërvajtje të kryer nëpërmjet kanalit të pavarur dhe anonim për paraqitje, i cili do të mundësojë të punësuarve të paraqesin shkelje të dispozitave të këtij ligji.

(2) Procedura për paraqitje për kundërvajtje të kryer nga paragrafi (1) të këtij neni duhet të përmbajë rregulla të qarta për pranim dhe përpunim të fletëparaqitjeve për kundërvajtje të kryer, proporcionalisht me natyrën dhe madhësinë e subjektit.

(3) Subjekti nuk guxon ta zbulojë identitetin e personit i cili ka dorëzuar fletëparaqitje për kundërvajtje të kryer pa siguruar pajtim të tij paraprak, përveç për rastet kur kjo është e nevojshme për qëllimet e zbatimit të procedurës parahetuese ose penale.

Neni 158

(1) Organet për mbikëqyrje nga neni 146 të këtij ligji janë të obliguar të vendosin procedura efikase për paraqitje për kundërvajtje të kryer i cili do të mundësojë të punësuarit në subjekte të paraqesin shkelje të dispozitave të këtij ligji i cili do të sigurojë:

- metodë të thjeshtë dhe lehtësisht të kapshme të parashtrimit të njoftimeve për kundërvajtje të kryer,
- rregulla të brendshme për pranim dhe përpunim të njoftimeve për kundërvajtje të kryer dhe
- mbrojtje të të dhënave personale të personit i cili ka dorëzuar njoftim për kundërvajtje të kryer në pajtim me rregullat për mbrojtje të të dhënave personale.

(2) Organet e mbikëqyrjes nga neni 146 të këtij ligji nuk guxojnë ta zbulojnë identitetin e personit i cili ka dorëzuar njoftim për kundërvajtje të kryer pa siguruar pajtim të tij paraprak.

Shpallja e informatave në lidhje me mbikëqyrjen

Neni 159

(1) Për qëllimet e parandalimit dhe kthimit të zbatimit të aktiviteteve të cilat konsiderohen për kundërvajtje në pajtim me këtë ligj, Drejtoria është e obliguar, në bazë të të dhënave të marra në pajtim me nenin 154 të këtij ligji, publikisht t'i shpallë informatat për gjopa të shqiptuara në bazë të vendimit të plotfuqishëm.

(2) Informatat nga paragrafi (1) të këtij neni përmbajnë të dhëna për:

- kryerësin e kundërvajtjes, edhe atë: emërtimin dhe selinë e personit juridik, emrin dhe mbiemrin e personit përgjegjës në personin juridik, emrin dhe mbiemrin e personit fizik, personin i cili kryen autorizim publik dhe personin e autorizuar zyrtar,
- kundërvajtjen: përshkrimi i veprimtërisë që paraqet kundërvajtje dhe
- gjobën e shqiptuar.

(3) Informatat nga paragrafi (2) të këtij neni shpallen në internet faqen e Drejtorisë dhe të njëjtat janë të kapshme në afat prej tre vjetësh nga dita e botimit.

(4) Me përjashtim të paragrafi (1) të këtij neni, Drejtoria nuk e shpall informatën për identitetin e kryerësit të kundërvajtjes nëse:

- gjopa është shqiptuar për kundërvajtje për të cilën mund të caktohet masë edukim në pajtim me nenin 155 të këtij ligji ose
- shpallja e informatës mund të parandalojë zbatimin e procedurës parahetuese ose penale.

KAPITULLI VII. DISPOZITA PËR KUNDËRAVJTJE

Neni 160

(1) Gjorbë në shumë prej 80.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, përkatësisht tregtarit individ nëse:

- nuk zbaton procedurë të analizës së klientit në pajtim me nenin 12 të këtij ligji,

- nuk zbaton analizë të përforcuar gjatë vendosjes të marrëdhënies korrespondente përkatësisht në pajtim me nenin 34 të këtij ligji,
 - nuk refuzon vendosje të marrëdhënies afariste ose realizon transaksion ose nuk e ndërpret marrëdhënien afariste me klientin në pajtim me nenin 39 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji,
 - vendosin ose vazhdojnë marrëdhëniet afariste me shell bank (banka guaca) dhe të fillojnë ose vazhdojnë marrëdhënie korrespondente afariste me bankë për të cilën e dinë se lejon hapje dhe punë me llogari të bankave guaca në kundërshtim me nenin 49 paragrafi (1) të këtij ligji,
 - shell bank (bankat guaca) kryejnë aktivitete financiare në Republikën e Maqedonisë në kundërshtim me nenin 49 paragrafi (2) të këtij ligji,
 - hapin ose ruajnë llogari anonime ose llogari në emra fiktivë në kundërshtim të nenit 50 të këtij ligji,
 - nuk dorëzojnë te Drejtoria të dhëna, informata dhe dokumente në pajtim me nenin 54 paragrafi (1) të këtij ligji,
 - nuk realizon kontroll të brendshëm në pajtim me nenin 58 të këtij ligji të këtij ligji,
 - thirret në sekretin afarist gjatë dorëzimit të informatës në kundërshtim me nenin 63 të këtij ligji,
 - nuk i dorëzon të dhënat e kërkuara, në mënyrë të pasaktë u përgjigjet të dhënave të kërkuara ose nuk u përgjigjet në afatin në pajtim me nenin 115 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji;
 - nuk vepron në pajtim me urdhëresën për përcjellje të marrëdhënies afariste nga nenin 119 të këtij ligji,
 - nuk e mban transaksionin në bazë të urdhëresës të lëshuar në pajtim me nenin 120 të këtij ligji.
- (2) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e përcaktuar të personit juridik përkatësisht tregtarit individ do t'i shqiptohet për kundërvajtje edhe personit përgjegjës në personin juridik, përkatësisht tregtarit individ për veprimet nga paragrafi (1) të këtij neni.
- (3) Personit përgjegjës për veprimet nga paragrafi (1) të këtij neni krahas gjobës mund t'i shqiptohet edhe sanksion për kundërvajtje ndalim për ushtrim të detyrës deri në një vit në pajtim me ligj.
- (4) Për veprimet nga paragrafi (1) të këtij neni të bëra me qëllim, në mënyrë të organizuar, të cilat përsëriten, me të cilat është shkaktuar dëm i konsiderueshëm ose fiton dobi të konsiderueshme pronësore, personit juridik i shqiptohet gjobë në shumë prej 1.000.000 euro deri në 5.000.000 euro në kundërvlerë me denarë dhe sanksion kundërvajtës ndalesë për ushtrim të veprimtarisë së caktuar prej tre muaj deri në tre vjet në pajtim me ligj.
- (5) Për veprime të kryera nga paragrafi (1) të këtij neni, Drejtoria mund të dorëzojë propozim të arsyetuar për heqje të përkohshme ose të përhershme të licencës, përkatësisht lejes për punë të personit juridik nga organet kompetente për dhënien e tyre në pajtim me ligj.

Neni 161

- (1) Gjobë në shumë prej 80.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje bankës nëse nuk vë në përdorim ose nuk e përsos softuerin për përpunim automatik të të dhënave në pajtim me nenin 59 të këtij ligji.
- (2) Gjobë në shumë prej 30% të gjobës së përcaktuar të bankës do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) të këtij neni edhe personit përgjegjës të bankës.

Neni 162

- (1) Gjobë në shumë prej 30.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, ose tregtarit individ nëse:
- nuk zbaton vlerësim të rrezikut në pajtim me nenin 10 të këtij ligji,
 - nuk përpilon dhe zbaton program në pajtim me nenin 11 paragrafi (1) të këtij ligji,
 - nuk miraton, rregullisht nuk e përcjell dhe vlerëson përshtatshmërinë e saj, harmonizimin dhe efikasitetin në pajtim me nenin 11 paragrafi (2) të këtij ligji,
 - vepron në kundërshtim me përjashtimet për analizë të klientit në lidhje me paratë elektronike nga neni 13 të këtij ligji,
 - nuk i zbaton masat për analizë të klientit nga neni 14 të këtij ligji të këtij ligji,
 - nuk e identifikon dhe vërteton identitetin e klientit, të autorizuesit ose pronarit të vërtetë në pajtim me nenin 15 të këtij ligji,
 - nuk e identifikon dhe vërteton identitetin e klientit në pajtim me nenin 16 të këtij ligji,
 - nuk e identifikon dhe vërteton identitetin e klientit, të autorizuesit ose pronarit të vërtetë në pajtim me nenin 17 të këtij ligji,
 - nuk e identifikon dhe vërteton identitetin e pronarit të vërtetë në pajtim me nenin 18 të këtij ligji,
 - nuk e përcjell marrëdhënien afariste në pajtim me nenin 31 të këtij ligji,
 - nuk zbaton analizë të thjeshtësuar të klientit në pajtim me nenin 32 të këtij ligji,
 - nuk zbaton analizë të përforcuar të klientit në pajtim me nenin 33 të këtij ligji,

- nuk zbaton analizë të përforcuar të klientit i cili nuk është fizikisht i pranishëm në pajtim me nenin 35 të këtij ligji,-nuk zbaton analizë të përforcuar të klientit - bartësit të funksionit publik në pajtim me nenin 36;
 - nuk zbaton analize të përforcuar të klientit nga shtetet me rezik të madh në pajtim me nenin 37 të këtij ligji,
 - nuk zbaton analizë të përforcuar ndaj transaksioneve të ndërlikuara dhe të pazakonta në pajtim me nenin 38 të këtij ligji,
 - nuk i ruan të dhënat, informatat ose dokumentet në pajtim me nenin 51 të këtij ligji,
 - nuk e njofton Drejtorinë dhe nuk e mban transaksionin në pajtim me nenin 54 paragrafi (2) të këtij ligji,
 - nuk dorëzon te Drejtoria të dhëna, informata dhe dokumente në formë të raportit në pajtim me nenin 54 paragrafi (3) të këtij ligji,
 - nuk siguron zbatimin e masave dhe veprimeve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit në pajtim me nenin 41 të këtij ligji,
 - ia beson detyrimet për analizë të klientit personave të tretë në kundërshtim me nenin 42 të këtij ligji,
 - nuk siguron dhe përcjell informatat te bartja pa para të gatshme të mjeteve në para në pajtim me nenin 43 të këtij ligji,
 - nuk përcakton identitet të klientit në pajtim me nenin 44 paragrafi (1) të këtij ligji,
 - nuk përcakton identitet të klientit në pajtim me nenin 46 të këtij ligji,
 - nuk përcakton identitet të klientit në pajtim me nenin 47 paragrafi (1) të këtij ligji,
 - pranon para të gatshme në kundërshtim me nenin 48 të këtij ligji,
 - kryejnë regjistrim të letrave me vlerë, pronë tjetër ose punë juridike, ose për paraqitje ose kryerje të bartjes së parave, letrave me vlerë ose pronës tjetër, mund të kryejnë regjistrim të tillë ose bartje në kundërshtim me nenin 48 paragrafi (2) të këtij ligji,
 - nuk i dorëzon te Drejtoria të dhënat e grumbulluara, informatat dhe dokumentet në rast të transaksionit me para të gatshme në shumë prej 15.000 euro në kundërvlerë me denarë ose më shumë pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për një transaksion ose dukshëm më shumë transaksione të ndërlidhura në pajtim me nenin 52 të këtij ligji, nuk dorëzon të dhëna te Drejtoria në pajtim me nenin 53 të këtij ligji,
 - nuk i dorëzon raportet te Drejtoria në pajtim me nenin 56 të këtij ligji,
 - nuk emërojnë person të autorizuar dhe zëvendës të tij në pajtim me nenin 57 paragrafi (1) të këtij ligji,
 - nuk formon seksion të veçantë për parandalimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizimit në pajtim me nenin 57 paragrafi (2) të këtij ligji,
 - nuk formon seksion të veçantë për parandalimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizimit seksion në pajtim me nenin 57 paragrafi (3) të këtij ligji,
 - nuk siguron plotësimin e kushteve në pajtim me nenin 57 paragrafi (8) të këtij ligji,
 - shfrytëzimin e të dhënave të siguruara me këtë ligj në kundërshtim me nenin 60 të këtij ligji,
 - e njoftojnë klientin ose personin e tretë në pajtim me nenin 61 paragrafi (1) të këtij ligji,
 - nuk ndërmer masa të nevojshme për mbrojtje të të dhënave në pajtim me nenin 61 paragrafi (3) të këtij ligji.
- (2)Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e përcaktuar të personit juridik përkatësisht tregtarit individ do t'i shqiptohet për kundërvajtje edhe personit përgjegjës të personit juridik përkatësisht tregtarit individ për veprimet nga paragrafi (1) të këtij neni.

Neni 163

- (1)Gjobë në shumë prej 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, ose tregtarit individual nëse:
- nuk e njofton Drejtorinë në pajtim me nenin 7 paragrafi (2) të këtij ligji,
 - nuk e dorëzon programin me kërkesë të organeve kompetente të mbikëqyrjes nga nenin 146 të këtij ligji në pajtim me nenin 11 paragrafi (3) të këtij ligji,
 - nuk i shënon të dhënat sipas renditjes kronologjike në regjistër të numërtuar te punë këmbimi në pajtim me nenin 45 të këtij ligji,
 - nuk mban regjistër të numërtuar për tregtim të letrave me vlerë shuma e përgjithshme e të cilave është më e madhe se 15.000 euro në kundërvlerë me denarë në pajtim me nenin 47 paragrafi (1) të këtij ligji,
 - nuk e njoftojnë organin kompetent për mbikëqyrje nga nenin 146 të këtij ligji se kanë dorëzuar raport te Drejtoria në pajtim me nenin 54 paragrafi (6) të këtij ligji,
 - punëson te seksioni persona të cilët nuk i plotësojnë kushtet nga neni 57 paragrafët (6), (7) dhe (11) të këtij ligji,

- nuk siguron trajnim të rregullt profesional në pajtim me nenin 57 paragrafi (12) të këtij ligji,
 - nuk dorëzon të dhëna te Drejtoria në pajtim me nenin 57 paragrafi (13) të këtij ligji.
- (2) Gjobë në shume prej 30% nga gjoba e matur të personit juridik përkatësisht tregtarit individuale do t'i shqiptohet për kundërvajtje edhe personit përgjegjës të personit juridik përkatësisht tregtarit individual për veprimet nga paragrafi (1) të këtij neni.

Neni 164

(1) Gjobë në shumë prej 30.000 deri në 40.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit i cili kryen autorizim publik ose personit fizik, nëse:

- nuk zbaton procedurë të analizës të klientit në pajtim me nenin 12 të këtij ligji,
- nuk i ruan të dhënat, informatat ose dokumentet në pajtim me nenin 51 të këtij ligji,
- nuk dorëzojnë te Drejtoria të dhëna, informata dhe dokumente në pajtim me nenin 54 paragrafi (1) të këtij ligji,

nuk realizon kontroll të brendshëm në pajtim me nenin 58 të këtij ligji,

- thirret në sekretin afarist gjatë dorëzimit të informatës në kundërshtim me nenin 63 të këtij ligji,
- nuk i dorëzon të dhënat e kërkuara, në mënyrë të pasaktë u përgjigjet të dhënave të kërkuara ose nuk u përgjigjet në afat në pajtim me nenin 115 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji të këtij ligji,
- nuk vepron në pajtim me urdhëresën për përcjellje të marrëdhënies afariste nga nenin 119 të këtij ligji,

- nuk e mban transaksionin në bazë të urdhëresës të lëshuar në pajtim me nenin 120 të këtij ligji.

(2) Personit i cili kryen autorizim publik ose personit fizik për veprimet nga paragrafi (1) të këtij neni krahas gjobës i shqiptohet edhe sanksion për kundërvajtje ndalesë për ushtrim të veprimtarisë deri në tre vjet.

Neni 165

(1) Gjobë në shumë prej 12.000 deri në 15.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit i cili kryen autorizim publik ose personit fizik, nëse:

- avokatët dhe shoqëritë e avokatëve me kërkesë të Drejtorisë nuk dorëzojnë arsyetim me shkrim në pajtim me nenin 7 paragrafi (2) të këtij ligji,

- nuk zbaton vlerësim të rreziku në pajtim me nenin 10 të këtij ligji,

- nuk përpilon dhe zbaton program në pajtim me nenin 11 paragrafi (1) të këtij ligji,

- nuk miraton program, rregullisht nuk e përcjell dhe vlerëson gjendjen adekuate të saj, harmonizimin dhe efikasitetin në pajtim me nenin 11 paragrafi (2) të këtij ligji,

- nuk i zbaton masat për analizë të klientit nga neni 14 të këtij ligji të këtij ligji,

- nuk e identifikon dhe vërteton identitetin e klientit, të autorizuesit ose pronarit të vërtetë në pajtim me nenin 15 të këtij ligji,

- nuk e identifikon dhe vërteton identitetin e klientit në pajtim me nenin 16 të këtij ligji,

- nuk e identifikon dhe vërteton identitetin e klientit, të autorizuesit ose pronarit të vërtetë në pajtim me nenin 17 të këtij ligji,

- nuk e identifikon dhe vërteton identitetin e pronarit të vërtetë në pajtim me nenin 18 të këtij ligji,

- nuk e përcjell marrëdhënien afariste në pajtim me nenin 31 të këtij ligji,

- nuk zbaton analizë të thjeshtësuar të klientit në pajtim me nenin 32 të këtij ligji,

- nuk zbaton analizë të përforcuar të klientit në pajtim me nenin 33 të këtij ligji,

- nuk zbaton analizë të përforcuar të klientit i cili nuk është fizikisht i pranishëm në pajtim me nenin 35 të këtij ligji,

- nuk zbaton analizë të përforcuar të klientit - bartësit të funksionit publik në pajtim me nenin 36 të këtij ligji,

- nuk zbaton analizë të përforcuar të klientit nga shtetet me rrezik të madh në pajtim me nenin 37 të këtij ligji,

- nuk zbaton analizë të përforcuar ndaj transaksioneve të ndërlikuara dhe të pazakonta në pajtim me nenin 38 të këtij ligji,

- nuk refuzon vendosje të marrëdhënies afariste ose realizon transaksion ose nuk e ndërpret marrëdhënien afariste me klientin në pajtim me nenin 39 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji,

- nuk siguron zbatimin e masave dhe veprimeve për parandalimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizimit në pajtim me nenin 41 të këtij ligji,

- ia beson detyrimet për analizë të klientit personave të tretë në kundërshtim me nenin 42 të këtij ligji,

- nuk e përcakton identitetin e klientit në pajtim me nenin 43 paragrafi (1) të këtij ligji,

nuk e përcakton identitetin e klientit në pajtim me nenin 45 të këtij ligji,

- nuk e përcakton identitetin e klientit në pajtim me nenin 46 të këtij ligji,
- nuk e përcakton identitetin e klientit në pajtim me nenin 47 paragrafi (1) të këtij ligji,
- pranon para të gatshme në kundërshtim me nenin 48 të këtij ligji,
- kryen regjistrim të letrave me vlerë, pronë tjetër ose punë juridike, ose për paraqitje ose realizim të bartjes së parave, letrave me vlerë ose pronës tjetër, mund të kryejnë regjistrim të tillë ose bartje në kundërshtim me nenin 48 paragrafi (2) të këtij ligji,
- nuk dorëzon të dhëna te Drejtoria në pajtim me nenin 53 të këtij ligji,
- nuk e njofton Drejtorinë dhe nuk e mban transaksionin në pajtim me nenin 54 paragrafi (2) të këtij ligji,
- nuk dorëzojnë te Drejtoria të dhëna, informata dhe dokumente në formë të raportit në pajtim me nenin 54 paragrafi (3) të këtij ligji,
- nuk i dorëzon raportet te Drejtoria në pajtim me nenin 56 të këtij ligji,
- nuk emërojnë person të autorizuar dhe zëvendës të tij në pajtim me nenin 57 paragrafi (1) të këtij ligji,
- shfrytëzimin e të dhënave të siguruara me këtë ligj në kundërshtim me nenin 60 të këtij ligji,
- e njoftojnë klientin ose personin e tretë në pajtim me nenin 61 paragrafi (1) të këtij ligji,
- nuk ndërmer masa të nevojshme për mbrojtje të të dhënave në pajtim me nenin 61 paragrafi (3) të këtij ligji.

(2) Personit i cili kryen autorizim publik ose personit fizik për veprimet nga paragrafi (1) të këtij neni krahas gjobës i shqiptohet edhe sanksion i kundërvajtjes ndalesë për ushtrim të veprimtarisë deri në një vit.

Neni 166

(1) Gjobjë në shumë prej 2.000 deri në 2.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit i cili kryen autorizim publik ose personit fizik, nëse:

- nuk e njofton Drejtorinë në pajtim me nenin 7 paragrafi (2) të këtij ligji,
- nuk e dorëzon programin me kërkesë të organeve kompetente të mbikëqyrjes nga nenin 146 të këtij ligji në pajtim me nenin 11 paragrafi (3) të këtij ligji,
- nuk e njoftojnë organin kompetent për mbikëqyrje nga nenin 146 të këtij ligji se kanë dorëzuar raport te Drejtoria në pajtim me nenin 54 paragrafi (6) të këtij ligji,
- nuk siguron trajnim të rregullt profesional në pajtim me nenin 57 paragrafi (12),
- nuk dorëzon të dhëna te Drejtoria në pajtim me nenin 57 paragrafi (13) të këtij ligji.

(2) Personit i cili kryen autorizim publik ose personit fizik për veprimet nga paragrafi (1) të këtij neni krahas gjobës i shqiptohet edhe sanksion i kundërvajtjes ndalesë për ushtrim të veprimtarisë deri në një vit.

Neni 167

(1) Gjobjë në shumë prej 10.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje subjektit juridik nga neni 25 paragrafi (1) të këtij ligji nëse:

- nuk posedon dhe ruan të dhëna adekuate, të sakta dhe të azhurnuara për pronarin e vërtetë në pajtim me nenin 25 paragrafi (2) dhe
- nuk i fut të dhënat për pronarin/ët e vërtetë, si dhe të dhënat për ndryshimin e pronarit/ëve të vërtetë në regjistrin në pajtim me nenin 26 paragrafi (3) dhe neni 27.

(2) Gjobjë në shumë prej 30% nga gjoba e përcaktuar të subjektit juridik nga nenin 25 paragrafi (1) do t'i shqiptohet për kundërvajtje edhe personit përgjegjës të subjektit juridik nga nenin 25 paragrafi (1) për veprimet nga paragrafi (1) të këtij neni.

Neni 168

Gjobjë në shumë prej 2.500 deri në 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje drejtorit të falimentimit ose drejtorit të likuidimit nëse nuk ndërmer masa dhe veprime në rast kur subjekti është në procedurë të falimentimit dhe likuidimit në pajtim me nenin 9 të këtij ligji.

Neni 169

Gjobjë në shumë prej 1.000 deri në 2.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar, nëse:

- nuk i dorëzojnë të dhënat e kërkuara në pajtim me nenin 115 paragrafi (2) të këtij ligji,
- nuk e informojnë Drejtorinë për rezultatin nga raportet e dorëzuara ose njoftimet në pajtim me nenin 118 paragrafi (5) të këtij ligji,
- nuk dorëzojnë të dhëna statistikore te Drejtoria në pajtim me nenin 124 paragrafi (4) të këtij ligji,

- nuk e evidenton çdo futje dhe nxjerrje të parave ose mjete fizike të bartshme për pagesë nëpërmjet linjës doganore të Republikës së Maqedonisë në pajtim me nenin 126 paragrafi (1) të këtij ligji,
- nuk i grumbullon të dhënat në pajtim me nenin 126 paragrafi (2) të këtij ligji,
- nuk e paraqet te Drejtoria futjen ose nxjerrjen e parave ose mjete fizike të bartshme për pagesë mbi 10.000 euro në kundërvlerë me denarë në pajtim me nenin 126 paragrafi (3) të këtij ligji,
- nuk e paraqet te Drejtoria, dyshimin për pastrim parash dhe/ose financim të terrorizimit në pajtim me nenin 126 paragrafi (4) të këtij ligji,
- nuk i ruan të gjitha të dhënat për futjen dhe nxjerrjen e parave ose mjeteve fizike të bartshme për pagesë, nëpërmjet linjës doganore së paku pesë vjet nga dita e bartjes së realizuar në pajtim me nenin 126 paragrafi (5) të këtij ligji,
- nuk përpilojnë programe vjetore ose plane për kryerje të mbikëqyrjes në zbatimin e masave dhe veprimeve në pajtim me nenin 146 paragrafi (7) të këtij ligji,
- nuk e njoftojnë Drejtorinë kur do të përcaktojnë dyshim për pastrim parash dhe/ose financim të terrorizimit si dhe shkelje të dispozitave të këtij ligji në pajtim me nenin 146 paragrafi (9) të këtij ligji,
- nuk formojnë komisione për kryerje të mbikëqyrjes në pajtim me nenin 153 paragrafi (1) të këtij ligji,
- nuk e njoftojnë Drejtorinë në pajtim me nenin 153 paragrafi (3) të këtij ligji,
- nuk e njoftojnë Drejtorinë për kërkesën e parashtruar për ngritje të procedurës së kundërvajtjes në pajtim me nenin 154 të këtij ligji.

Neni 170

Përcaktimi i lartësisë së gjobës për personin juridik dhe tregtar individual kryhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

Procedura për dhënie të urdhërpagesës për kundërvajtje

Neni 171

(1) Për kundërvajtjet nga ky ligj, organet e mbikëqyrjes nga neni 146 të këtij ligji gjatë konstatimit të kundërvajtjes janë të obliguar t'i propozojnë kryerësit të kundërvajtjes procedurë për barazim me dhënie të urdhërpagesës kundërvajtëse, para se ta parashtrojnë kërkesën për ngritje të procedurës kundërvajtëse.

(2) Nëse organet e mbikëqyrjes nga neni 146 të këtij ligji konstatojnë kundërvajtje, përpilojnë procesverbal në të cilin i shënojnë elementet e kundërvajtjes, kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së kundërvajtjes, përshkrimin e veprimit të kundërvajtjes, personat të cilit janë të përfshirë

dhe japin propozim për barazim me dhënie të urdhërpagesës së kundërvajtjes. Procesverbalin e nënshkruajnë organi i mbikëqyrjes dhe kryerësi.

(3) Nëse kryerësi e pranon kundërvajtjen, organet e mbikëqyrjes nga neni 146 të këtij ligji do të lëshojnë urdhërpagesë të kundërvajtjes.

(4) Kryerësi është i obliguar ta paguajë urdhërpagesën e kundërvajtjes të lëshuar në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni në afat prej tetë ditësh nga pranimi i urdhërpagesës, në llogarinë e shënuar në urdhërpagesë.

(5) Kryerësi i cili do ta paguajë gjobën në afatin nga paragrafi (4) të këtij neni do të paguajë gjysmën e gjobë së shqiptuar, për çka këshillohet në këshillën juridike.

(6) Nëse kryerësi nuk e paguan urdhërpagesën e kundërvajtjes në afatin nga paragrafi (4) të këtij neni, organi i mbikëqyrjes nga neni 146 të këtij ligji parashtron kërkesë për ngritje të procedurës së kundërvajtjes te gjykata kompetente.

(7) Organet e mbikëqyrjes nga neni 146 të këtij ligji janë të obliguar të mbajnë evidencë për urdhërpagesat kundërvajtëse të lëshuara nga paragrafi (1) të këtij neni dhe për rezultatin e procedurave të ngritura.

(8) Në evidencën nga paragrafi (7) të këtij neni grumbullohen, përpunohen dhe ruhen këto të dhëna: emri dhe mbiemri, përkatësisht emërtimi i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës së kundërvajtjes që i jepet dhe rezultati nga procedura.

(9) Të dhënat personale nga paragrafi (8) të këtij neni ruhen dhjetë vjet nga dita e futjes në evidencë.

(10) Ministri i Financave e përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës së kundërvajtjes.

Neni 172

Procedura e kundërvajtjes për kundërvajtje të kryer nga ky ligj nuk mund të ngrihet ose mbahet nëse kalojnë më shumë se gjashtë vjet nga dita kur është kryer kundërvajtja.

Neni 173

Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj vendos gjykata kompetente në procedurë të përcaktuar me ligj.

KAPITULLI VIII.

DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 174

(1) Aktet nënligjore të cilat dalin nga Ligji për parandalim të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 130/14, 192/15, 27/16 dhe 83/18) vazhdojnë të zbatohen deri në ditën e miratimit të akteve nënligjore të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj do të miratohen në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç akteve nënligjore nga neni 28 paragrafi (4) të cilat do të miratohen në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 175

(1) Organet e mbikëqyrjes nga neni 146 të këtij ligji janë të obliguar në afat prej nëntë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji të përpilojnë udhëzim nga neni 10 paragrafi (7) të këtij ligji.

(2) Subjektet nga neni 5 të këtij ligji janë të obliguar të përpilojnë vlerësim të rrezikut nga neni 10 të këtij ligji në afat prej 12 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(3) Subjektet nga neni 5 të këtij ligji janë të obliguar të miratojnë Program nga neni 11 të këtij ligji në afat prej gjashtë muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(4) Subjektet nga neni 5 të këtij ligji janë të obliguar seksionin për parandalimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizimit nga neni 57 të këtij ligji ta formojnë më së voni në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 176

Regjistri nga neni 26 të këtij ligji do të themelohet në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të aktit nënligjor nga neni 28 paragrafi (4) të këtij ligji.

Neni 177

(1) Subjektet juridike nga neni 25 paragrafi (1) të këtij ligji janë të obliguar detyrimin nga neni 25 paragrafi (3) të këtij ligji ta plotësojnë në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Subjektet juridike nga neni 25 paragrafi (1) të këtij ligji janë të obliguar të dhënat nga neni 25 paragrafi (3) të këtij ligji t'i fusin në regjistër në afat prej tre muajsh nga dita e vendosjes së regjistrimit nga neni 26 të këtij ligji.

Neni 178

Odat e avokatëve dhe odat e noterëve janë të obliguar t'i formojnë komisionet nga neni 153 të këtij ligji në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 179

Drejtori i Drejtorisë i emëruar deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdon ta ushtrojë funksionin deri në përfundim të mandatit për të cilin është emëruar.

Neni 180

Drejtorja për Zbulim Financiar nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdon të punojë si Drejtori për Zbulim Financiar në pajtim me kompetencat e përcaktuara me këtë ligj.

Neni 181

Këshilli për luftë kundër larjes së parave dhe financimit të teorizimit i formuar deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdon ta kryejë funksionin në pajtim me kompetencat e përcaktuara me këtë ligj.

Neni 182

(1) Prej 1 janarit 2019, ndalimi për pagesë me para të gatshme të mallrave dhe shërbimeve nga neni 48 të këtij ligji, do t'i referohet pagesave me para të gatshme, në shumë prej 1.000 eurosh ose më shumë në kundërvlerë me denarë në formë të një ose më shumë transaksioneve dukshëm të lidhura, që nuk është kryer nëpërmjet bankës, kursimorese ose nëpërmjet llogarisë në institucion tjetër i cili jep shërbime pagesore.

(2) Prej 1 janarit 2019, ndalimi për pagesë me para të gatshme të mallrave dhe shërbimeve nga neni 48 të këtij ligji, do t'i referohet pagesave me para të gatshme, në shumë prej 500 eurosh ose më shumë në kundërvlerë me denarë në formë të një ose më shumë transaksioneve dukshëm të lidhura, që nuk është kryer nëpërmjet bankës, kursimorës ose nëpërmjet llogarisë në institucion tjetër i cili jep shërbime pagesore.

Neni 183

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për parandalim të larjes së parave dhe financimit të terrorizimit („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ numër 130/14, 192/15, 27/16 dhe 83/18).

Neni 184

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".